

Procesverbal

*Nga Mbledhja II (e dytë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:
28.02.2025*

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00773- 1 ZK Dragash;
3. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00807- 0 ZK Dragash;
4. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604028-00295- 0 ZK Lubovishtë;
5. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-01184- 0 ZK Dragash;
6. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604006-01063- 0 ZK Brodosanë;
7. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604004-00750- 0 ZK Brezne;
8. Shqyrtimi i Kërkesës së përfaqësuesve të Sindikatës së Administratës së Komunës së Dragashit për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve për shujtat e punëtorëve/zyrtarëve publikë të Administratës së Komunës së Dragashit;
9. Miratimi i Raportit dhe Planit të Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit për vitin 2024; dhe
10. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kolegë asambleistë, përfaqësues nga OSCE-ja, media dhe ju të pranishëm! Para se të filloj seancën, ju kisha lut që për nder të jetës dhe veprës së ish-kolegut tonë, z.Naser Myrtezani, të mbajmë një minutë heshtje!... Lavdi!

Atëherë vazhdojmë me Seancën e dytë të rregullt për vitin 2025. Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë. Në këtë seancë kemi nëntë pika të rendit të ditës dhe pikën eventuale, siç e keni pranuar me ftesë. Ju lutem, nëse dikush do me e marrë fjalën rreth rendit të ditës, fjala është për ju.

Nedžmidin Sejdilar: Për sa i përket materialeve, ne ramë dakord që materialet t'i merrnim në formë fizike. Nuk kam marrë një material të tillë as në këtë seancë dhe as në seancën e mëparshme. Meqenëse ne nuk mund t'i përdorim pajisjet në vend, unë insistoq që të na dërgoni materialin në formë fizike.

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Nga kryesuesja dhe kryetari na është premtuar që ditëve të premte të mos ketë seancë, por prapë është e njëjta. Edhe e dyta, kemi shumë pika të rendit të

ditës – nëntë pika – unë kërkoj që edhe një pikë të jetë, pika e dhjetë: Kërkesa e Sindikatës së shëndetësisë dhe QKMF-së Dragash.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Përshëndetje, i nderuar ekzekutiv! Të nderuar kolegë/e asambleistë, qytetarë të nderuar të Dragashit! Më lejoni që në emrin tim dhe të Grupit të PDK-së t'i shpreh ngushëllimet nga thellësia e zemrës familjes së të ndjerit, ish-kolegut Naser Myrtezani. Gjithashtu, lus Zotin që ta mëshirojë dhe ta shpërblejë me Xhenetin Firdeus. Gjithashtu, shfrytëzoj këtë mundësi – pasi që nga nesër jemi në muajin e shenjtë të Ramazanit – t'ju uroj muajin e bekuar të Ramazanit! Agjërim të lehtë, lutje, ibadete të pranuar ishalla! Dhe në fund, dhashtë Zoti, na pranon dhe na shpërblen me atë që na ka premtuar e që e di vetëm Ai. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë, sipas materialit që e keni marrë, janë dhjetë pika të rendit të ditës. Dhe, ishte një kërkesë nga z.Artan Loshaj, kërkesa e QKMF-së për shujta. Siç e dini, unë rendi e ditës e kam bërë pak më herët dhe kjo kërkesë më ka ardhë para disa ditëve, në emër të sindikatës së QKMF-së së Dragashit. Siç e dini, kërkesa që më ka ardhë në emër të administratës, më ka ardhë para tre muajve dhe i kam pas në zyrën time këta të administratës, dhe ju kam thënë që më jepni pak kohë që ta shqyrtoj me kryetarin e Komunës, për mjetet dhe për me e qit në Kuvend. Kjo kërkesë, pas tre muajve ka ardhë në Kuvend. Atëherë, edhe këtë kërkesën e QKMF-së që më është dërgue mu, unë do ta ftoj kryetarin e sindikatës dhe do ta ftoj edhe kryetarin e Komunës, në zyrën time, që ta bëjmë një punë më të mirë dhe ta presim kërkesën e administratës prej MAPL-së, që si po kthehet kjo, dhe kjo kërkesë besoj që do të vjen në muajin tjetër. Unë kisha dashtë prej Asamblesë që të kemi një bashkëpunim të mirë, që mos ta qesim këtë pikë edhe mos të dalim keq na. Unë jam vetë edhe infermiere dhe e mbështes fuqishëm këtë institucion, dhe besoj që në seancën tjetër do të vjen sikur kërkesë. Atëherë, pasi është kërkesa e Artan Loshajt, që kjo kërkesë të futet sot, unë do ta qes kërkesën e Artanit kështu. Por, unë si kryesuese e Kuvendit dua që ligjërisht kjo punë të shkojë nëpër organet kompetente, si kryetari i Komunës, kryetari i sindikatës, që mos të kthehet kjo. Pasi është thirrë edhe kjo seancë, më është drejtuar edhe një kërkesë e kam pranue në datën 22, andaj ju lutem që kjo kërkesë të trajtohet në një seancë të ardhshme, pasi që nuk jemi të përgatitur në këtë seancë për trajtimin kësaj. Të shohim çfarë përgjigje do të marrim prej MAPL-së për vendimin për shujta, dhe pastaj do ta sjellim në Kuvend edhe kërkesën e punëtorëve shëndetësorë që e kanë me meritë dhe të drejtën e tyre. Me sa kam informatë, punëtorët shëndetësorë kanë marrë shujta

deri në muajin shkurt të vitit 2023. Unë nuk do të jem kundër kësaj kërkesës, do të jem shumë pro. Edhe sot e kam diskutue para se me ardhë në seancë, se edhe kryetari i Komunës e ka marrë këtë kërkesë shumë me pozitivitet, dhe kryetari më është drejtuar që edhe ai ka dëshirë që këto shujta t'ju drejtohen. Por, unë me sa po e shoh, që Artani po do me e qit këtë si kërkesë, unë do ta qes kërkesën e Artanit në votim, por unë nuk do të jem pro kësaj kërkesës që sot të futet, por do të jem që në muajin tjetër ta qesim si kërkesë, qysh i takon një organi të lartë legjislativ. Atëherë, kush është pro kërkesës së Artanit që sot të futet në rend të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me Me 13 vota pro, 14 kundër dhe zero abstenim, nuk kalon kjo kërkesa që të futet në rend të ditës. Nexhmidin, ti a shohish edhe mbrapa, a? Po seriozisht, qysh po e shohish që Miralemi ka abstenuë? Unë ju kisha lut që ti mos me folë! Tash e kam njeriun këtu që është duke i përcjellë. Kush është pro që të futet kjo në rendin e ditës? Ngrini duart ma lartë! A ka mundësi mediat me i qit? A ka kundër? A ka abstenim? Me 13 vota pro, 13 kundër dhe zero abstenim, atëherë vota ime është kundër, nuk do ta shti këtë pikë të rendit të ditës, do ta lë në seancën e radhës.

Nedžmidin Sejdilar: Aktualisht janë 26 delegatë të pranishëm në sallë, jo 27, siç keni llogaritur 14/13. Kjo dëshmon se ju po manipuloni funksionin dhe votat tuaja. Nuk mund të numëroje 14/13 kur kishte një delegat më pak në sallë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me rendin e ditës. Kush është pro rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 12 kundër, e miratojmë rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe dy abstenime, e miratojmë pikën e parë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00773- 1 ZK Dragash. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Bexhet Xheladini: E nderuara kryesuese, zv/kryesues, të nderuar asambleistë, i nderuar përfaqësues i OSBE-së, të nderuara media! Ju përshëndes të gjithëve, këtij Kuvendi i dëshiroj punë të mbarë! Pasi janë përfaqësuesit e mediave këtu, shfrytëzoj rastin t'ua uroj muajin e shenjtë të Ramazanit! Unë dua të jap sqarime, jo vetëm për pikën e dytë, por do të jap sqarime nga pika e dytë deri te pika e tetë, në mënyrë që të mos dal disa herë këtu në foltore. Para disa kohe, si kryetar i Komunës kam marrë informatën nga AKP-ja se disa prona të cilat gjenden në territorin e Komunës së Dragashit dhe momentalisht janë në pronësi të AKP-së, ata kanë dashtë që t'i qesin në privatizim. Kështu që ne, në njërën nga mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, kemi marrë qëndrim

që disa prona të cilat AKP-ja ka planifikue t'i privatizojë, ne kemi marrë një qëndrim që t'i drejtohem Asamblesë Komunale, që ajo të shpallë interes të përgjithshëm për këto prona, në mënyrë që këto prona pastaj Komuna e Dragashit t'i shfrytëzojë për të mirën e qytetarëve. Propozimi i parë është Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00773- 1 ZK Dragash. Është fjala për objektin te Shtëpia e Kulturës, objekti i Sharr Prodhimit, ai objekti i vjetër. Ne kemi kërkuar që të shpallet interes i përgjithshëm për prona të cilat janë në pronësi të AKP-së, dhe jo për prona të cilat i kanë katër persona privatë në posedim të tyre. Kështu që, kërkoj nga Asambleja Komunale që ta shpallë interes të përgjithshëm dhe të votojë pro këtij propozimi, vetëm për pronën që është në pronësi të AKP-së. Gjithashtu, unë po i lexoj edhe propozimet tjera, pastaj kryesuesja secilin veç e veç do ta propozojë për marrjen e vendimit. Është fjala për Parkingun publik i cili gjendet përballë xhamisë së re këtu, kah Shajnja që është xhamia - Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00807- 0 ZK Dragash. Aty planifikojmë që ne si Kuvend Komunal për momentin mund ta bëjmë një parking për nevojat e Kuvendit Komunal në Dragash. Te propozimi tjetër, Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604028-00295- 0 ZK Lubovishtë, është fjala për një pronë të vogël, e cila do t'i nevojitet Komunës së Dragashit, gjegjësisht qytezës së Dragashit, për vendosjen e një trafoje, për nevojat e një lagjeje në drejtim të Brodit, sepse kjo lagje momentalisht e ka tensionin shumë të ulët të rrymës elektrike. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-01184- 0 ZK Dragash – është fjala për stacionin e veterinarisë. Edhe këtu propozoj që të shpallet interes i përgjithshëm vetëm për pronën e cila është në pronësi të AKP-së, për arsye se në atë pronë gjendet edhe një ndërtesë ku kanë pronësi edhe disa persona privatë. Tjetri është Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604006-01063- 0 ZK Brodosanë – është fjala për “Agro Qendrën”. Ne propozojmë aty të ndërtohet një park për fëmijë, të cilin do ta shfrytëzojë fshati Bresanë edhe fshati Kuklibeg. Ndërsa, për propozim-vendimin e mëhershëm, aty ne mendojmë që të ndërtojmë një banesë për banim social. Dhe i fundit është Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604004-00750- 0 ZK Brezne. Kjo është pronë e një personi privat, dhe ne këtu do ta shpallim interes të përgjithshëm, sepse në këtë ne kemi bërë shpalljen për ndërtimin e Impiantit për përpunimin e ujërave të zeza në fshatin Brezne. Këtu janë arsyetimet nga ana ime si kryetar i Komunës, tash është në dorën tuaj si asambleistë që të merrni qëndrim lidhur me këto interese publike. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, ne vazhdojmë te pika e dytë: Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00773- 1 ZK Dragash. E hapi diskutimin, kush do me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës për shpalljen e interesit publik, unë edhe në Komitet dje kam kërkuar, po kryetari dje kishte fjalë tjera, e sot na thotë që për ato katër lokalet nuk do të bëhet shpronësimi publik, ndërsa për atë parcelën. Unë nuk di qysh do të mundesh katër lokale me i lënë, e katër tjera me i asi, kur është me një kulm. Është një objekt i ndarë me pjesë-pjesë të lokaleve. Nuk po mundi me të kuptue tash, kur të marrish me e rrënie, qysh gjysmën e kulmit do ta rrënosh, e gjysmën e kulmit do ta lëshë, katër lokale këndej. Është mirë edhe jam për shpronësim, po qëllimi i juaj është shumë jo i arsyeshëm, për ndërtimin e gjelbërimit të qytetit. Nuk mundesh ti lokalet me i prish aty, me i lënë ata njerëz që në Kadastër i kanë të qitme, nuk mundesh me jau prish lokalet, me i thënë unë po e bëj një park, kur e ke veç një park aty. Është mirë ju me qenë ma seriozë, ne do të votojmë për, po me qenë ma seriozë me ato objektet. Duesh me i rrëzue ti, edhe me e bo një park, ose me bo një diçka tjetër, një ndërtesë apo shtëpi të kulturës, apo diçka që ka vlerë aty. Shtatë-tetë lokale janë aty, ti katër po i prish, e katër po jau lëshë atyre. Me një kulm janë. Jo serioze, nuk e di. Por, këtë e keni bo ju me qëllim, se e dini që në MAPL nuk ju kalon, vjen negative, sikur çdo herë qysh ju ka ardhë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush rreth kësaj pike me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 21 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe pikën e dytë. Vazhdojmë me pikën e tretë: Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00807- 0 ZK Dragash. A dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe pikën e tretë. Vazhdojmë me pikën e katërt: Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604028-00295- 0 ZK Lubovishtë. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e pestë: Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-01184- 0 ZK Dragash. Kush do me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Duke qenë se kam marrë informacion se në këtë pronë janë tre shtëpi që janë në pronësi të individëve privatë dhe që kanë të drejta pronësie mbi këtë parcelë, pse nuk na është dhënë në material ky fakt? Si mund të deklarojmë interes publik pa marrëveshje me pronarët? Nuk

mund ta mbështes propozimin sepse nuk më janë siguruar provat ligjore dhe dokumentare, si dhe pëlqimi i pronarëve të parcelës.

Bexhet Xheladini: Si në rastin e ndërtesës që është pranë Shtëpisë së Kulturës, ashtu edhe te stacioni i veterinit, kjo Asamble po bën shpalljen e interesit publik për pronën që është në pronësi të AKP-së, e jo pronat private. Te rasti i fundit, është fjala për atë tokën – më duket është afër 20 ari deri në 23 ari, me sa di unë, kështu që ne nuk po e bëjmë privatizimin e ndërtesës edhe banesave, ato janë në pronësi të njerëzve privatë, edhe ato nuk mundet askush me jau marrë. Një gjë të tillë ka pas me e bo AKP-ja. Ne e kemi lut AKP-në, që ata mos ta bëjnë privatizimin, por ta bëjnë shpalljen sepse kemi nevojë ne si Komunë e Dragashit ta bëjmë një gjë të tillë për nevojat tona. Kështu që, nëse nuk e bëjmë ne, ka pas me e bo AKP-ja këtë, e me e ble ndonjë person privat. Ma mirë është me e ble shteti, me e ble Komuna, dhe pastaj Komuna shumë më mirë merret vesh me pronarët privatë, sesa një person privat i cili mund të ketë edhe reperkusione tjera. Kështu që ne, edhe në vendimin kur a bëjmë, do ta shënojmë që kjo Asamble ka prurë vendim që të shpallet interes i përgjithshëm vetëm ajo pronë e cila është në pronësi të AKP-së, duke i hequr nga kjo pronat që janë në pronësi private.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përsërisht të gjithëve! Ju uroj muajin e shenjtë të Ramazanit, juve dhe të gjithë qytetarëve! Gjithashtu, familjarëve dhe të gjithë të afërmeve, shokëve e miqve ju shpreh ngushëllime për ish-asambleistin Naser Myrtezani! Të nderuar të pranishëm, unë, kur e kam marrë kërkesën, kam qenë shumë i lumtur. Në fakt, një mori kërkesash, që këto parcela të shpallen me interes publik, në bazë të ligjit. Një verpim të tillë, ata që kanë qenë në asambletë e kalume e dinë mirë, neve Komunës na janë marrë me qindra e mijëra hektarë pronë publike. Ish-Kuvendi Komunal i atëhershëm, komunistët kur kanë qenë – kryesues ka qenë Behadin Ahmetoviqi – ai me vendim atëherë e ka marrë pronën e shtetit, ia kanë dhënë një firmës edhe ajo pastaj, pas luftës, u bë pronë e saj. Ne në të kaluarën, edhe ish-kryetari, edhe ish-kryesuesi, edhe asambleistët e kemi votue dy herë që prona publike t'i kthehet Komunës. Dhe AKP-ja, se është organ më i lartë, edhe kryetarin e Komunës edhe kryesuesin i ka çue në gjykatë, pse e kanë marrë një vendim të tillë. E tash na është dhënë mundësia, edhe me u çue këtu me kundërshtue, kjo për mu s'ka asnjë lloj argumenti më të vogël që pronën tonë, që na kanë marrë në mënyrë të padrejtë, me e kthye, tash çohet dikush me kundërshtue. Kjo nuk ka kurrfarë arsytimi hiç. Edhe me të vërtetë është shumë e rëndë, që ne mezi po presim me i kthye pronat, me qindra e mijëra hektarë që na janë marrë Komunës, edhe po kqyrim në krejt format ligjore me i kthye pronat këtu,

i bëhemi argatë të keqes për me diskutue. Këto diskutimet shkojnë edhe në Ministri. Pronën private kërkush kërkujt nuk mund t'ia marrë. Ndërtesa është me pronarë, 100 pronarë ndoshta i ka, secili e ka emrin dhe mbiemrin e vet. Edhe toka dihet e kuja është. Dihet kjo, është e definuar. S'ka këtu amulli e dyshime. Pronën tonë ka mundësi me e kthye, ishalla! Është pikëpyetje, ndoshta edhe nuk na japin. Ndoshta edhe nuk na japin, por na po e bëjmë punën tonë. Ju faleminderit!

Munir Jonuzi: Unë jam në parim që çdo pronë e AKP-së t'i kalojë komunesë. Unë dua vetëm të mbroj interesat e qytetarëve që kanë pronë në atë parcelë. A mund të fusim një nen tjetër, që prona e individëve privatë të mos hyjë në interesin publik?

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 21 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e gjashtë: Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604006-01063- 0 ZK Brodosanë. A do dikush me e marrë fjalën?

Driton Ademi: Nëse bën veç një sqarim, kryetar, te propozimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik. Kryetar, më erdh se thaje pjesën e “Agro Qendrës”. Qeshtu e thaje. A këtu në vendim që e ke shkruar, pasuri shoqërore, Shkolla Fillore “29 Nëntori”. A është pjesa e “Agro Qendrës”, a pjesa nër Domin? Veç një sqarim nëse bën me e ditë. Ose pjesa nër Domin, që është shkolla, apo “Agro Qendra”? Se qetu po thotë Shkolla Fillore “29 Nëntori”. Nëse bën një sqarim pak. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Shpallja e interesit publik, bëhet fjalë vetëm për ndërtesën e “Agro Qendrës”. Ndërtesa e “Agro Qendrës” është pronë e AKP-së. Ndërsa toka, e cila quhet Shkolla Fillore “29 Nëntori”, është në pronësi të Komunës. Domethënë, është ajo toka mes fshatit Kuklibeg edhe Bresanë. Kështu që, ne do ta bëjmë vetëm shpalljen e interesit publik të ndërtesës, se toka është e jona.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro pikës së gjashtë? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe pika e gjashtë. Vazhdojmë te pika e shtatë: Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604004-00750- 0 ZK Brezne. A do dikush me e marrë fjalën?

Shpetim Hajredini: Deshta ta kem edhe unë një sqarim prej kryetarit, pasi që ky Propozim-vendim, në krahasim me këto propozimet e mëhershme, e ka njëfarë dallimi, pasi që kjo pronë i

takon një personi të Breznes, që qenka Hamdi Krasniqi, edhe nuk është pronë shtetërore, as e AKP-së, ose e Kuvendit të Dragashit. A do të bëhet kompenzim për këtë tokë, edhe çfarë shume do të jepet, apo ky personi e ka dhënë për bamirësi, vetë ka desht me e dhënë për fshatin. Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Prona që kërkohet nga Asambleja që ta shpallë interes publik, është pronë private e Hamdi Krasniqit. Hamdi Krasniqi ka pranue që këtë pronë ta japë me pagesë. Ne e shpallim interes publik, siç e kemi shpallë at ëish-ndërtesën e Sharr Prodhimit në Bresanë, edhe pastaj ne e kemi bërë pagesën e saj. Ju e bini vendimin, pastaj vendimi shkon në shqyrtimin e ligjshmërisë, pastaj vazhdojnë procedurat – Ministria e Financave e ka një komision, del në vend të ngjarjes, e vlerëson sa bën ajo toka, na bjer neve dhe pastaj ne si Kuvend Komunal, në marrëveshje me pronarin e tokës, e bëjmë marrëveshjen. Nëse vjen shuma më e madhe, e bëjmë marrëveshjen me bo pagesa me rata për dy vjet, nëse vjen shuma e vogël, e paguajmë me një herë. Por, sigurisht që do ta zgjat kjo procedurë, nuk bëhet aq shpejt, kështu që ne buxhetin e vitit 2026 e bëjmë pagesën. Afër 20 ari është.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e tetë. Të nderuar delegatë të Kuvendit të Komunës, në kuadër të pikës së tetë të rendit të ditës, kemi për shqyrtim Kërkesën e Sindikatës së Administratës së Komunës së Dragashit për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve për shujtën ditore të punëtorëve, funksionarëve publikë të Administratës komunale. Të nderuar delegatë, siç jeni në dijeni përmes materialit që e keni marrë, Sindikata e Administratës së Komunës së Dragashit ka paraqit Kërkesën për të mbështetur punëtorët tanë, të cilët janë shtylla kryesore e funksionimit të shërbimit komunal. Kontributi i tyre i vazhdueshëm siguron që qytetarët tanë të marrin shërbimet e nevojshme në mënyrë efikase dhe të pandërprerë. Duke marrë parasysh rëndësinë e punës që ata kryejnë, sigurisht që është e drejtë dhe e nevojshme që kjo çështje të trajtohet me seriozitetin dhe përgjegjësinë që meriton. Në shumë komuna të tjera tashmë është bërë praktikë kompenzimi i shpenzimeve për shujta ditore, për të siguruar kushte më të mira, punë, dhe për të arritur mirëqenien e zyrtarëve publikë. Prandaj, është e rëndësishme që ne si Kuvend ta shqyrtojmë me kujdes dhe me përgjegjësi këtë Kërkesë, duke pasur parasysh aspektet e saja financiare dhe sociale. Në këtë kuadër, më duhet të theksoj se kjo kërkesë ka të bëjë me mbështetjen materiale për shujta ditore, në shumë prej 4 eurove për ditë në punë, prej vitit 2022, 2023 dhe 2024. Kërkesa bazohet në nivelin e shpenzimeve ditore me të cilat përballen zyrtarët

publikë, dhe sfidat e shumta që ata kanë hasur në këto vite, përfshirë inflacionin dhe nivelin e pagave që ata kanë. Nisur nga kjo, i ftoj të gjithë delegatët e Kuvendit që ta shqyrtojnë me kujdes këtë Kërkesë, të japin mendimin e tyre, në mënyrë që të japin një vendim të drejtë në interes të punëtorëve tanë, por edhe të funksionimit të mirëfilltë të Administratës komunale. Të nderuar delegatë, pas këtij prezantimi, fjalën jua kaloj juve dhe pres me pa durim të ketë diskutim konstruktiv për këtë çështje. Atëherë, vazhdojmë me këtë pikë dhe kush do që ta marrë fjalën, le të urdhërojë.

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë, kryesuesja e lexoi një tekst, unë prita që ta lexoj kërkesën, por e ka përfshirë aty. Por, unë e ndjeva obligative që kërkesa, qysh na ka ardhë, me e lexue, në qoftë se më lejohet. Unë po e lexoj për opinionin, se na e kemi në material:

“Sindikata e Administratës së Komunës së Dragashit

Lënda: Kërkesë për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve të shujtës të punëtorëve/zyrtarëve publikë të Administratës së Komunës së Dragashit.

Ne, anëtarët e Sindikatës së Administratës së Komunës së Dragashit, përmes kësaj Kërkesë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që të shqyrtojë mundësinë buxhetore për miratimin e Kërkesës për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve për shujtën e punëtorëve/zyrtarëve publikë të Administratës së Komunës së Dragashit. Duke pasur parasysh se shumica e zyrtarëve publikë të Administratës kanë paga të ulëta, në krahasim me kategoritë e tjera shfrytëzuese të buxhetit të Kosovës, dhe marrë parasysh rritjen e çmimeve, inflacionin që ka vështirësuar shumë situatën ekonomike të zyrtarëve publikë, duke e bërë të papërballueshëm plotësimin e obligimeve personale, jetësore dhe familjare, ne kërkojmë trajtimin e Kërkesës sonë. Sindikata e Komunës së Dragashit, pas analizimit të situatës së të hyrave zyrtare publike, koston financiare, ka vlerësuar shumën e pagesës së shujtave prej 4 eurove në ditë. Andaj, ne kërkojmë që kjo të ndahet, duke llogaritur koston financiare retroactive për vitin 2022, 2023, dhe vitin buxhetor 2024, ku shpresojmë të kemi përkrahjen dhe miratimin tuaj. Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Dragashit, një numër i komunave të RKS-së tani më kanë realizuar këtë të drejtë, të kësaj natyre zyrtare. Ne besojmë në mbështetjen tuaj, në vlerësimin e Kërkesës sonë. Me respekt, përfaqësuesit e Sindikatës së Administratës së Komunës së Dragashit”

Një prej punëve shumë të mira që po e bën qeveria dhe që është duke e bërë në vazhdimësi – edhe i uroj e i përshëndes – është qeveri që me të vërtet merret me hallet e qytetarëve, edhe të zyrtarëve. Rrogat më të ulëta se Administrata kërkush nuk i ka, dorën në zemër. E pata fjalën për qeverinë e

Kryetarin Bexhet Xheladini. Po dihet, ne jemi të kësaj qeverisë. Po më vjen shumë mirë, edhe kërkesa e Sindikatës së Shëndetësisë është e arsyeshme, edhe për atë jam i bindur – nuk kam bisedue me asnjë zyrtar, as me kryetarin – por edhe ajo ka me u realizue, vetëm duhet a i kemi mundësitë buxhetore. Sot ta kryejmë këtë, mos t’i bëhemi ngarkesë – e t’ua mundësojmë punëtorëve të Administratës që t’i marrin këto të ardhura të cilat i meritojnë. Se e kanë me të vertetë edhe udhëtimin, edhe ushqimin, edhe rrogat më të ulëta në këtë nivel. Se shëndetësia dhe arsimiti kanë marrë. Bile arsimiti ka marrë shumë ma shumë se të tjerët. Faleminderit!

Artan Loshaj: Sa i përket kësaj Kërkese, edhe ne si Grup Parlamentar jemi pro. Por, unë u çudita prej kolegëve – prej teje, kryesuese, edhe prej kolegëve që punojnë në QKMF – kundër vetvetes me shkue, unë për herë të parë kam pa. Krejt kolegët e mi kanë votue kundër për me hi pika e rendit të ditës për Sindikatën e Shëndetësisë. Unë e di që ata kanë me i marrë paret të parit, para meje, po problemi është pse opozita ka lyp, ose pse po lyp Artani, unë jam kundër. Kur thaje që ta shohim a është e ligjshme apo e paligjshme kërkesa e Artanit, kërkesa e Artanit edhe kërkesa e Sindikatës së Administratës është e njëjtë, edhe ne do ta përkrahim. Por, kam qef prej kryetarit me e ditë kur do të fillojë pagesa edhe si do ta bëjmë pagesën. Apo, do t’ia lë kompirin e nxehtë vitin tjetër PDK-së me e marrë, ju veç me votue e PDK me e marrë me e realizue.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Para se me ia dhënë Agronit fjalën, deshta me u lidhë unë – të kërkoj falje Agron, një minutë veç. Artan, edhe dje në KPF ta kërkova një gjë të tillë, që ne të dy me e pas një bashkëpunim. Jo arsyeja që ne jemi si Grup kundër për ato shujta, por ne jemi pro. Unë dje e lypa një bashkëpunim prej teje, që kjo pikë të mos vjen sot në seancë, për arsye se unë nuk due me i shkelë Sindikatën e Administratës, kur një gjë të tillë jau kam bo dy deri në tre muaj, që kam bo shumë kërkesa dhe jam marrë me këtë pjesën e kërkesës. Të njëjtën gjë do t’a bëj edhe Sindikatës së Shëndetësisë. Do t’i shoh të gjitha burimet dhe do të konsultohem me kryetarin e Sindikatës, z.Elvir, që ma ka dërguar, dhe kryetarin. Nuk jemi kundër. Dhe sa për kërkesën tënde, unë nuk jam kundër teje dhe çdo kërkesë tënden disa herë edhe e kam përkrah. Nuk është kjo problem.

Agron Gashi: Ju përsëndes, të pranishëm! Lidhur me këtë pikë, unë deshta të shtoj diçka. Është kërkesë legjitime, normale, të kërkojnë, se vërtet janë me paga të ulëta. Por, po mendoj se do ta has në dy barriera. Barriera e parë është se po kërkohet që të bëhet kompenzimi nga viti 2022, 2023 dhe 2024, gjë që i përket të kaluarës, dhe konsideroj se MAPL-ja assesi nuk do ta kalojë këtë

pikë. Dhe, tjetër që dua të them është se jemi pro kësaj, duhet ta përkrahim këtë pikë, dhe njëkohësisht të stimulohen ata, se vërtet kanë shpenzime të mëdha, udhëtime prej një vendi në vendin tjetër. Kështu që, duhet t'i japim përkrahje. Por, është problem të kalohet në rrethana të tilla, sa i përket të kaluarës. E dyta është se Ministria e Shëndetësisë, nëse ka marrëveshje me sindikatën, për të kaluar kjo, atëherë besoj se përmes përmbartjes apo gjykatës mund t'i përfitojnë këto mjete. Mirëpo, unë po konsideroj deri tash, derisa s'janë paguar, edhe ligjërisht përmes gjykatës, qysh kemi kërkuar, ne edhe i kemi përfituar. Unë po konsideroj kësaj, që nuk mund ta kalojnë. Faleminderit shumë!

Shpetim Hajredini: Unë pata të flas si shef i Grupit, por atë e kreu Artani. E falënderoj! Por, një çështje që dua ta sqaroj pak me kryetarin edhe me kryesuesen. Kjo kërkesë që na ka ardhë, e thanë edhe ma herët kolegët e mi, nuk ka bazë ligjore. Kjo nuk bazohet askund në ligj. Dhe natyrisht që Ministria ka mundësi të na kthejë mbrapa. Por megjithatë, nëse disa komuna e kishin aplikuar, kanë arrit ta fitojnë, edhe ne duhet të ndjekim rrugën e tyre. Sa i përket propozimit tonë edhe propozimit të Sindikatës së Shëndetësisë që ju ka ardhë juve, ata kanë bazë ligjore dhe janë pjesë e kontratës kolektive. Këta i kanë marrë, tregove deri para një viti e gjysmë a dy viteve që i kanë marrë, atyre u takon. Por ne vetëm kemi mund me e bo edhe një shtytje pak më shpejt, mos me ua vonue. Përndryshe, ata këto kanë me i marrë, deshtëm a nuk deshtëm ne, atyre u takon ligjërisht dhe ata i marrin. Por, nuk po më vjen mirë dhe nuk po due tash të dal edhe te kjo çështje, se propozimet tona ju nuk po i mbështetni asnjëherë. Ne gjithmonë po ju mbështesim juve, ju asnjëherë tonit. Sidoqofshin ato, a janë ligjore apo i takojnë etikës, moralit, sjelljes, ju tonat nuk i mbështetni asnjëherë. Ne kërkojmë prej jush që të na vjen materiali fizik, ju nuk e merrni parasysh; ne kërkojmë që të mos mbahet ditën e premtë, ju nuk e merrni parasysh; ne kërkojmë propozim tjetër, ju nuk e merrni parasysh. Ndërsa ju kërkonit prej nesh që gjithmonë t'ju mbështesim, ju kemi thënë në fillim, prapë po ju them, çka ka të bëjë me qytetarët na keni mbrapa. Çka ka të bëjë jashta qytetarëve, nuk do të na keni mbrapa tash e tutje. Se juve asnjëherë nuk po ju kemi ne mbrapa. Ndërsa ne po jemi gjithmonë mbrapa jush. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Shpetim, ne edhe kërkesën tënde të para disa muajve ta kemi mbështet. E dyta, kërkesat e juaja nuk kanë qenë të gjitha që nuk kanë kaluar. Unë e kam lyp një bashkëpunim dje me Artanin, nuk e ka dashtë bashkëpunimin tem. Kontratën kolektive e di që është e ligjshme. Por, unë hala nuk e kam takuar kryetarin e Sindikatës së Shëndetësisë. Kur ta

takoj, atëherë do ta bie. Ne që votuam kundër, nuk ishim kundër Kërkesës, por ishim kundër që të qitet. Se unë për këtë kërkesën e Administratës, jemi takue me disa komuna, që i kemi pa që atyre ua ka kthye pozitive. Të jemi të qartë kështu, ne nuk jemi kundër, por jemi pro, dhe do ta shohësh që muajin tjetër do të jetë kjo pikë e rendit të ditës. Unë kam kërkue bashkëpunim, nuk keni dashtë bashkëpunim. Si tash qysh është kjo kërkesa, edhe muajin tjetër ka me ardhë kjo kërkesa e shëndetësisë.

Shpetim Hajredini: E nderuar kryesuese, unë nuk thashë që jeni kundër ju. Absolutisht! Unë ta dhashë një sqarim, çka është ndasia ndërmjet kësaj kërkesë dhe kërkesës që e bëri kolegu im, Artani. Dhe që jeni kundër ju, unë absolutisht nuk po besoj, se nuk mujsh me qenë kundër vetvetes. Ndërsa, sa i përket asaj që na ke mbështet propozimin tem, unë nuk po e di tash cilin propozim ma keni mbështet, po qeto propozimet unë që i kam bo, unë nuk e di që më kanë kalue, çdo seancë ato janë hedhë poshtë, nuk janë marrë parasysh. Ti i dish kërkesat e mia cilat kanë qenë. Unë gjithmonë kërkesa kur bëj, bëj kërkesë bazike, të bazume diku. Nuk e bëj veç hajt se po dal diçka të them edhe t'ju qes poshtë juve si ekzekutiv. Atë nuk e bëj asnjëherë dhe nuk e kam bërë asnjëherë. Por, kërkesat tona në përgjithësi nuk kanë kalue.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj kërkesë? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës. Pasi sot është edhe ditë e premtë, unë ma herët e kam thënë që nuk do të mbajmë kurrë ditën e premtë, siç e tha edhe asambleisti ma herët. Por, u dashtë dy seanca me i mbajt, për shkak të pagesës së asambleistëve dhe në muajin mars e kam paraparë që të jenë dy seanca. Por, pasi që është Ramazan, kam kërkue që një seancë të mbahet në muajin mars dhe për këtë arsye e kam bo ditën e premtë. Jo që e kam harrue atë premtim që e kam dhënë, por ka qenë e detyrueshme, se ka qenë dita e fundit. Atëherë, para se me kalue te pika e nëntë, Artan Loshaj dje ka kërkuar prej kryetarit të Komunës që të gjithë drejtorët të jenë në sallë në pikën e nëntë, dhe të gjithë të raportojnë për punën e tyre. Atëherë, e lus kryetarin e Komunës që pas pauzës të jenë prezentë drejtorët. Në ora 13:30 kthehemi në sallë!

Atëherë, të dashur asambleistë, besoj që pushimin e keni kryer dhe të gjithë jemi kryer në sallë. Po vazhdojmë te pika e nëntë: Miratimi i Raportit dhe Planit të Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit për vitin 2024. Para se me ia dhënë fjalën kryetarit, a do dikush me e marrë fjalën? Atëherë, e lus Kryetarin që ta marrë fjalën!

Bexhet Xheladini: Faleminderit, kryesuese! Materialin ju e keni marrë, është pak voluminoz, ju kërkoj falje pak, ndoshta do të ju merr kohë derisa ta lexoj krejt, po megjithatë, masi është një herë në vit, do të keni durim. E nderuar kryesuese, zv/kryesues, të nderuar asambleistë, të nderuar qytetarë të Komunës së Dragashit:

Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Dragashit 01nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes Raportin Vjetor janar – dhjetor 2024, për te arriturat, sukseset, angazhimet, por edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur Komuna e Dragashit gjatë vitit 2024.

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mire brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që të kryejmë pjesën më të madhe të objektivave, aktiviteteve si dhe detyrave sipas planifikimeve strategjike dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Që të jetë sa ma transparente për publikun, Komuna e Dragashit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'u dhënë mundësi qytetareve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve Komunale.

Puna e Kryetarit, përkatësisht ekzekutivit të Komunës së Dragashit është zhvilluar përmes 8 drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të Komunës, në harmoni me legjislacionin, udhëzimet dhe Statutin e Komunës.

Synimet tona politike në qeverisje janë:

- *Qeverisje të mirë, të përgjithshme, të qëndrueshme, të hapur me qytetarët, demokratike dhe të suksesshme;*
- *Qeverisje me plane dhe shikim kah e ardhmja;*
- *Qeverisje që gjen zgjidhje, sado sfiduese dhe komplekse të jenë problemet;*
- *Qeverisje me plane të qarta dhe ambicioze;*
- *Qeverisje që përballet me guxim dhe kryen pune me dinamikë të lartë e nuk vonohet;*
- *Qeverisje që vlerëson, motivon dhe mbështet talentin dhe të arriturat e qytetareve tanë të gjitha shtresave;*
- *Qeverisje ndërtuese që promovon gjithëpërfshirjen në vendimmarrje të forcave me ndikim në shoqëri, si: forcat politike, Kuvendin e Komunës, bashkësinë fetare, shoqërinë civile, bizneset, individët, të rinjtë dhe grupet e ndryshme të interesit;*
- *Qeverisje energjike që mobilizon resurse dhe përfshin në veprime investuese e zhvillimore punën në partneritet;*
- *Qeverisje për të gjithë pa dallim.*

Aktivite të rëndësishme

- *Edhe përgjatë këtij viti kemi vazhduar bashkëpunimin me institucionet e Republikës së Turqisë në Kosovë, ku kemi realizuar një sërë kërkesash tona, siç është Ultrazëri modern me tri sonda për nevojat e gjinekologes në QKMF, ndërtimi i Këndit të lojërave për fëmijë*

në oborrin e Shkollës “Fetah Sylejmani” në Dragash, pastrimin e shtretërve të lumenjve të dëmtuar nga vërshimet (në disa zona të caktuara) etj.;

- *Në fushën e Kulturës dhe Sportit kemi shapllur Thirrje publike për financimin e OJQ-ve lokale për organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore dhe sportive të cilat janë organizuar me rastin e shënimit të datave të rëndësishme historike;*
- *Përveç aktiviteteve tashmë tradicionale, sivjet kemi filluar edhe organizimin e Ekspozitës së Qenit Ilir të Sharrit, një aktivitet që synon promovimin dhe mbrojtjen e racës autoktone të Qenit Ilir të Sharrit;*
- *Në kuadër të aktiviteteve kulturore, kemi shpërndarë mirënjohje dhe dhurata simbolike për dhjetëra pensionistë dhe veteranë të luftës, duke shprehur mirënjohjen dhe falënderimin tonë për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në luftë dhe në paqe;*
- *Në vendin ku është rrënuar shtëpia famëkeqe e policisë serbe në fshatin Bresanë, kemi përruruar Parkun e Lirisë, një hapësirë e gjelbër dhe rekreative për banorët e këtij fshati;*
- *Në bashkëpunime me UNDP dhe OJQ-në ‘AVOKO’ kemi lansuar Platformën Visit Dragash (ëëë.visitdragash.com), e cila do të shërbejë si një dritare informative për turistët vendorë dhe të huaj, për t’u njohur me potencialet turistike të Komunës sonë;*
- *Si Qeverisje lokale kemi filluar hartimin e politikave për fillimin e procedurave të një planifikimi më të mirë urban në qytezën e Dragashit, ku fillimisht do të fokusohemi në rregullimin e infrastrukturës ndërtimore te Tregu i Gjelbër dhe pastaj, në bazë të mundësive ligjore do të angazhohemi edhe për investime të tjera në zona të ndryshme të qytezës;*
- *Në bashkëpunim me MKRS-në jemi duke u angazhuar që Komunën tonë ta bëjmë edhe me një Qendër kulturore Multifunktionale, e cila do të jetë një hapësirë ku do të përfshihen Muzeu, Biblioteka, salla të koncerteve, salla sportive, zyra dhe hapësira të tjera për realizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe sportive;*
- *Në fillim të këtij viti, me Ambasadën e Japonisë kemi nënshkruar një Marrëveshje për financimin (71 mijë euro) e ndërtimit të objektit të tipit të mbyllur për grumbullimin e mbeturinave në hyrje të fshatit Restelicë. Ky projekt është në realizim e sipër dhe pritet të përfitojnë 5 mijë banorë nga ky investim që do të ndikojnë drejtpërdrejt në ruajtjen e ambientit. Objekti është ndërtuar kurse është në pritje edhe procedura e prokurimit për 26 kontejnerë;*
- *Komuna e Dragashit edhe këtë vit, për herë të tretë është fituese e Grantit të Performancës për vitin (435,564 euro), ku kemi dyfishuar pikët, duke shënuar një progres të ndjeshëm sa i përket punës dhe angazhimit të qeverisjes lokale në të gjitha fushat;*
- *Me organizatën ASB kemi nënshkruar një Marrëveshje bashkëpunim për implementimin e projektit “Përkrahja e integritit të grave në zonat rurale”. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje kemi themeluar Qendrën për Angazhim të Komunitetit të Grave, një hap tutje drejt mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të grave në Komunën tonë. Kjo qendër tashmë është funksionale dhe aty kanë filluar të mbahen aktivitete të ndryshme;*

- Në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, përgjatë gjithë kohës së organizimit të procesit të Regjistrimit të Popullsisë, kemi bashkëpunuar ngushtë dhe kemi ofruar mbështetjen tonë, si dhe kemi bërë informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për t'u bërë pjesë e regjistrimit të Popullsisë;
- Komuna e Dragashit, në bashkëpunim me Organizatën OPFAKKOS ka organizuar për herë të parë aktivitetet sportive me personat me nevoja të veçanta, në përpjekje që të angazhohemi në drejtim të integritetit të kategorive të ndjeshme të shoqërisë;
- Kemi vazhduar bashkëpunimin me KFOR-in dhe CIMIC-un Italian, ku këtë vit kemi pranuar si donacion disa kompjuterë dhe një printer multifunksional laserik për bibliotekat lokale në Dragash;
- Kemi realizuar një takim me Këshillin Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive, ku përfaqësues nga fusha e sportit në Komunën tonë janë informuar për infrastrukturën ligjore që rregullon fenomenin e dukurive negative në ngjarjet sportive;
- Me Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim kemi krijuar raporte të bashkëpunimit, me qëllim të vendosjes së bazave elementare për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në Komunën tonë;
- Me rastin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas kemi pasur një sërë aktivitetesh për të reflektuar mbi rëndësinë e promovimit të të drejtave të grave dhe hartimit të politikave që synojnë përmirësimin e pozitës së grave në shoqërinë tonë;
- Si Qeverisje lokale, kemi mbajtur disa takime për të diskutuar mbi adresimin e kërkesave dhe vërejtjeve tona që duhet të përfshihen në procesin e hartimit të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”. Duke qenë të vetëdijshëm se gjendja aktuale me PK “Sharri” po na shkakton shumë vështirësi në shfrytëzimin e mundësive për investime të ndryshme në Komunën tonë, ne kemi adresuar disa kërkesa tek autoritetet kompetente, në mënyrë që të krijohen kushtet ligjore për investime dhe të bëhet ridefinimi i disa zonave të Parkut Kombëtar “Sharri”. Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar Sharri tashmë është në fazën e konsultimit publik dhe së shpejti Ministria e Planifikimit Hapësinor do të organizojë edhe një takim konsultativ me qytetarët e Komunës sonë, ku secili prej nesh mund të japë sugjerimet dhe vërejtjet e veta lidhur me përmbajtjen e Planit;
- Gjithashtu, Asambleja Komonale përmes një Vendimi e ka dhënë dritën e gjelbër për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, një dokument shumë i rëndësishëm i cili do të parasheh një sërë objektivash për zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Dragashit brenda një periudhe tetëvjeçare. Ne tashmë kemi nisur procedurat e tenderimit për hartimin e PZhK-së, i cili do të jetë një projekt dyvjeçar dhe do të kushtojë mbi 100 mijë euro;
- Në bashkëpunim me Shoqatën Bëmirëse “Jetimat e Ballkanit”, kemi bërë shpërndarjen e 100 pakove ushqimore dhe 100 pakove higjienike për familjet në nevojë në Opojë dhe në Gorë, me rastin e festës së Fitër Bajramit;

- *Pas procedurave të Ankandit publik, kemi kryer të gjitha obligimet ligjore për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës – sipërfaqeve afariste apo lokale;*
- *Edhe në vitin 2024, në muajin prill kemi marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit dhe Sportit, së bashku me katër biznese lokale private nga sektori i hotelerizmit dhe turizmit, me ç'rast kemi prezantuar vlerat e trashëgimisë kulturore, bukuritë natyrore, ushqimet tradicionale, si dhe kapacitetet e shërbimit hotelier e turistik që ofron Komuna jonë;*
- *Gjithashtu, në tetor të vitit 2024, së bashku me katër biznese lokale kemi marrë pjesë në Panirin e Agrobiznesit, Ushqimit dhe Pijeve “AGROKOS”;*
- *Kemi vazhduar edhe me Edicionin e tretë të Panirit me Produkte Vendore Lokale “EXPO SHARRI”, i cili tashmë është bërë një ngjarje e rëndësishme ekonomike për Komunën tonë, ku biznese të shumta promovojnë produktet e tyre vendore lokale;*
- *Me Ministrinë e Infrastrukturës kemi nënshkruar Memorandum bashkëpunimi për financimin e projektit “Asfaltimi i rrugës Zlipotok-Baçkë-Brod”, në vlerë prej 350 mijë euro;*
- *Kemi hartuar Planin trevjeçar të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës, një dokument i rëndësishëm i cili parasheh aktivitete që do të ndikojnë në parandalimin e fenomenit të braktisjes apo mosregjistrimit të nxënësve në shkollë;*
- *Në maj të këtij viti kemi filluar Programin e vizitave sistematike shëndetësore të nxënësve nëpër shkolla;*
- *Me organizatën japoneze JICA, jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm për ecurinë e përgjithshme të reformës së sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën tonë;*
- *Në vitin 2024, Komuna e Dragashit ka qenë nikoqire e organizmit të Debatit mbi politikat në kuadër të Javës së Gruas, e cila orgaizohet çdo vit nga Instituti Kombëtar Demokratik. Përfaqësues të shumtë nga komunat e Regjionit të Prizrenit kanë marrë pjesë në këtë Debat, për të diskutuar për adresimin e çështjeve gjinore, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe politikat e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor në nivel lokal;*
- *Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, më 1 qershor të vitit për të cilin po raportojmë, në bashkëpunim me organizatën “NEVO KONCEPTI” kemi themeluar Asamblenë e Fëmijëve, një platformë e cila do të shërbejë si një mundësi e mirë që zëri i fëmijëve të dëgjohet në të gjitha nivelet e vendimmarrjes;*
- *Me Vendim të Asamblesë Komunale, një delegacion i Komunës së Dragashit ka realizuar një vizitë studimore në Itali, me ç'rast është vizituar Komuna San Vito al Tagliamento, për t'u njoftuar me funksionimin politk-administrativ të kësaj komune italiane, si dhe për të shkëmbyer praktika dhe shembuj pozitivë të politikave të menaxhimit në nivel lokal;*
- *Në bashkëpunim me Doën Syndrome Kosova, kemi hartuar Planin Komunale të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, një dokument i cili përmban objektiva të rëndësishme*

dhe aktivitete që ndikojnë në mirëqenien e përgjithshme të personave me aftësi të kufizuara në Komunën tonë;

- *Jemi angazhuar edhe në funksionalizimin e Zyrës së HANDIKOS-it në Dragash;*
- *Për të rritur sa më shumë gjithëpërfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, kemi realizuar një sërë dëgjimesh buxhetore dhe konsultimesh publike, si për KAB-n dhe buxhetin final, ashtu edhe për dokumente dhe plane komunale të veprimt;*
- *Me organizatën Tetra Tech ARD kemi nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për zbatimin e përbashkët të Aktivitetit të USAID-it për Qeverisjen e Pronës. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, kemi mbajtur edhe takim konsultativ me qytetarë dhe përfaqësues të bizneseve, për themelimin e Këshillit Publiko-Privat, si një mekanizëm i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat;*
- *Gjatë Muajit Rozë të Ndërgjegjësimit Kundër Kancerit të Gjirit, në bashkëpunim me Grupin e Grave Asambleiste dhe Zyrën për Barazi Gjinore kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme, takime dhe ligjërata vetëdijesuse më gratë dhe vajzat e Komunës sonë, për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e parandalimit të kancerit të gjirit;*
- *Kemi nënshkruar Marrëveshje me Komunën e Studineçanit nga Maqedonia e Veriut, për aplikimin e përbashkët në Programin Ndërkufitar IPA;*
- *Edhe në vitin 2024, mbi 100 (110 studentë) studentë nga Komuna jonë janë përfitues të bursave komunale;*
- *Gjithashtu, kemi vazhduar me transportin falas për të gjithë nxënësit që vijnë në mësimin nëpër shkollat e Komunës së Dragashit;*
- *Sa u përket subvencioneve në bujqësi, 257 fermerë nga Komuna jonë kanë përfituar nga një shumë prej 90 mijë eurosh, nga Projekti për subvencionimin e ushqimeve për kafshë;*
- *Në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëfinancim me OJQ “Advancing Together” planifikojmë të realizojmë disa projekte, siç janë Papa Testi për gratë, ofrimi i shërbimeve dentare për personat me aftësi të kufizuara, vendosja e lëkundëseve në këndet e lojërave për fëmijë dhe dhomat etnologjike në Muzeun Komunal.*

Investimet Kapitale

Sa u përket investimeve kapitale, Komuna e Dragashit përgjatë vitit 2024 e ka realizuar në masë të konsiderueshme Planin e Prokurimit. Kemi nënshkruar mbi 100 kontrata për realizimin e projekteve të ndryshme nëpër të gjithë territorin e Komunës sonë, të cilat lidhen kryesisht me modernizimin e infrastrukturës publike nëpër institucione shëndetësore dhe arsimore, kubëzimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, ndërtimin e infrastrukturës sportive etj. Disa nga projektet e rëndësishme të cilat mund t'i përmendim janë:

- *Ndërtimi i fushës së Stadiumit të Qytetit në Dragash;*
- *Asfaltimi i rrugës Dragash – Stadium i Qytetit;*
- *Nisja e punimeve për ndërtimin e Fabrikës së ujit në Radeshë;*
- *Ndërtimi i sallës së re sportive në oborrin e Shkollës Filllore në fshatin Bresanë;*

- *Ndërtimi i objektit të ri të QMF-së në fshatin Krushevë;*

Etj.

Në bazë të Planit Vjetor të Prokurimit, për vitin 2024 kemi pasur:

- *21 projekte për kubëzim, prej të cilave 13 janë projekte dyvjeçare;*
- *8 projekte për asfaltim, prej të cilave 3 projekte janë dyvjeçare;*
- *7 projekte për mure mbrojtëse, prej të cilave 4 janë dyvjeçare;*
- *3 projekte për ndërtim të urave;*
- *6 projekte të ndriçimit publik, 2 prej të cilëve janë dyvjeçarë;*
- *4 projekte për ndërtim të parqeve, prej të cilave 1 është projekt dyvjeçar;*
- *3 projekte për ndërtimin e fushave sportive;*
- *10 projekte për ndërtim dhe riparim të rrjeteve të ujësjellësit dhe rezervuarëve, 5 prej të cilave janë projekte dyvjeçare;*
- *9 projekte për kanalizime fekale dhe atmosferike, 5 prej të cilave janë projekte dyvjeçare;*
- *14 projekte në infrastrukturën e përgjithshme të institucioneve arsimore;*
- *1 projekt në përmirësimin e infrastrukturës në institucione shëndetësore (Renovimi i QKMF-së).*

Këtu i kam edhe investimet kapitale që janë kryer në këtë vit. Unë nuk do t'i lexoj për mos me ju marrë kohë. Ju i keni këto në material. Po kaloj te subvencionet për projekte kulturore, rinore dhe sportive. Gjatë vitit 2024, Komuna e Dragashit ka mbështetur financiarisht OJQ të ndryshme për organizimin e aktiviteteve të shumta në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare për këto projekte ka qenë 134 mijë euro. Kemi bërë subvencione në fushën e kulturës, në fushën e sportit dhe në fushën e rinisë. Këto sigurisht drejtoresha për Kulturë do t'i përmend, unë nuk po i përmendi, edhe pse i kam në Raport.

Statistika nga Zyra Ligjore

*Sa u përket vendimeve dhe lëndëve të miratuara dhe proceduara nga Zyra Ligjore dhe Zyra e Kryetarit, ajo që vlen të theksohet është se gjatë këtij viti kemi marrë gjithsej **393 vendime për lejmin e mjeteve nga subvencionet** e Zyrës së Kryetarit. Nga mjetet e subvencioneve për shërim kanë përfutuar mbi **370 qytetarë**, ndërsa një pjesë tjetër e subvencioneve nga Zyra e Kryetarit janë dedikuar për raste të ndryshme, si për botime të librave, për aktivitete të OJQ-ve, mbështetje të familjeve strehuese, familjarëve të dëshmorëve, për personat me nevoja të veçanta, organizime të turnireve etj.*

Nga subvencionet e Zyrës së Kryetarit, gjatë vitit 2024 kemi pasur:

- **360** vendime për mjete për shërim, prej të cilave kanë përfituar **157 meshkuj dhe 187 femra**. Nga këta janë **16 fëmijë (11 meshkuj dhe 5 femra)**;
- **11** vendime për mjete për dializë, prej të cilave kanë përfituar **8 meshkuj dhe 3 femra**;
- **3** vendime për mjete për shkollim;
- **2** vendime për mjete për ndihmë momentale;
- **4** vendime për mjete për botim të librave;
- **3** vendime për mjete për OJQ;
- **1** vendim për mjete për mbështetje të familjeve strehuese;
- **6** vendime për mjete për familjet e dëshmorëve;
- **2** vendime për mjete për personat me nevoja të veçanta; dhe
- **1** vendim për mjete për organizim të turnireve.

Bazuar në statistikat e Zyrës Ligjore për vitin 2024, kemi pasur gjithsej **1305 lëndë**, prej të cilave:

- **1245** lëndë të miratuara;
- **25** lëndë të refuzuara;
- **7** lëndë të ceduara;
- **1** lëndë të pezulluar;
- **17** lëndë të anuluar; dhe
- **10** lëndë janë në proces.

Sa i përket Zyrës së Prokurimit, gjatë vitit për të cilin po raportojmë kemi nënshkruar gjithsej **364 vendime**, prej të cilave:

- **119** vendime për caktim të menaxherëve;
- **12** vendime për ricaktim të menaxherëve;
- **82** vendime për caktimin e komisioneve për pranime teknike;
- **126** vendime për shpalljen e tenderëve;
- **7** vendime për ekzekutimin e punimeve shtesë;
- **10** vendime për caktim të zyrtarëve autorizues; dhe
- **8** vendime për formimin e komisionit për shqyrtimin e përmbushjes së punimeve.

Gjatë vitit për të cilin po raportojmë kemi nënshkruar kontrata të ndryshme, memorandume të mirëkuptimit, marrëveshje për bashkëfinancim etj., me organizata dhe institucione të ndryshme, të cilat kanë për qëllim përmirësimin dhe ngritjen e mirëqenies për qytetarët e Komunës sonë.

Gjithashtu, kemi drejtuar edhe kërkesa të ndryshme në adresë të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, si dhe institucione të Qeverisë qendrore, ku kemi paraqitur nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe të Komunës së Dragashit.

Nga këto kemi:

- *Vendime për mjete për maturanët – 1*
- *Vendime për udhëtime zyrtare – 18*
- *Vendime për mjete për dreka zyrtare – 31*
- *Vendime për mjete për komisione për udhëheqje dhe koordinim të punës – 1*
- *Vendime për mjete për kartela telefonike – 6*
- *Vendime për lejminin e mjeteve për TV Opoja – 7*
- *Vendime për lejminin e mjeteve për TV Prizreni – 2*
- *Vendime për lejminin e mjeteve për vizitë studimore – 1*
- *Vendime për ndarjen e bursave – 1*
- *Vendim për pagesën e bursave për student, sipas Listës ku kanë përfituar 112 studentë – 1*
- *Autorizime – 5*
- *Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi – 14*
- *Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve – 6*
- *Kontrata për dhënie në shfrytëzim të tokës – 2*
- *Kontrata të tjera – 15*
- *Njoftime – 19*
- *Njoftime për takim publik – 2*
- *Përkushtim i Komunës për qëndrueshmërinë e projekteve – 2*
- *Njoftim për Kalendarin e dëgjimeve buxhetore – 1*
- *Propozime për formimin e Komisionit për Regjistrimin e Popullsisë – 2*
- *Njoftime për dorëheqje – 2*
- *Pranimi i dorëheqjes – 2*
- *Memorandume bashkëpunimi – 17*
- *Plane të punës – 9*
- *Raporte të punës – 9*
- *Raporte vjetore për sistemin e kontrollit të brendshëm – 3*
- *Raporte gjashtëmujore – 2*
- *Raporte vjetore – 3*
- *Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve – 1*
- *Praktikant në punë sipas marrëveshjes – 4*
- *Urdhëresa – 2*
- *Letër angazhimi – 1*
- *Letër konfirmimi dhe mbështetje – 1*
- *Informime – 1*
- *Formë e autorizimeve për listën e pagesave dhe pagave – 1*
- *Agjenda për debat me qytetarët e fshatrave – 1*
- *Kërkesa të kryetarit dërguar ministrive dhe organizatave të tjera – 26*
- *Ripërsëritje të kërkesave të njëjta – 2*

- *Ankesa – 1*
- *Zotime financiare – 1*
- *Shtojcë programi për bashkëfinancim – 3*
- *Njoftime -3*
- *Dokumentacion i dorëzuar policisë – 1*
- *Letër për shprehje të interesit për grante – 1*
- *Zotim financiar për pagesën në lidhje me shpronësimin e pronës së paluajtshme për AKP-në*
- *Kërkesë për mbështetje të fermerëve të Komunës së Dragashit për TIKA-n*
- *Kërkesë për mbështetje të bletarisë në Komunën e Dragashit për TIKA-n*
- *Kërkesë për renovimin e Kabinetit të SHFMU ‘‘Restelica’’ për CIMIC.KFOR*
- *Kërkesë drejtuar TIKA-s për furnizim me tri trafo*
- *Kërkesë drejtuar LMT-së për furnizim me një autobus për transportin e nxënësve të komuniteteve joshumicë*
- *Kërkesë për pajisje mjekësore (Ultrazë me tri sonda) drejtuar TIKA-s*
- *Ankesë drejtuar Komisionit për Ankesa për Performancën Komunale – MAPL Prishtinë*
- *Kërkesë drejtuar AME-së për hapjen e konkurseve dhe caktimin e U.D. të Njësisë së Zjarrfikësve*
- *Kërkesë drejtuar MPB-AP për pajisje me leje parkimi VIP për veturat zyrtare të Komunës së Dragashit*
- *Kërkesë drejtuar MMPHI-së për financimin e projektit për hapjen dhe asfaltimin e segmentit rrugor Blaç – Rrafshina – Kroi i Shkupit*
- *Kërkesë drejtuar MMPHI-së për asfaltimin e rrugës Zlipotok – Baçkë – Brod*
- *Kërkesë drejtuar MAPL-së për marrjen në shfrytëzim të pronës së menaxhuar nga AKP-ja*
- *Shtojcë programi për bashkëfinancim me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale për MAPL-në*
- *Dokumentacion i dorëzuar kërkuar nga drejtoria e përgjithshme e Policisë - Departamenti i Hetimeve, lidhur me dhënien e pëlqimit për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët*
- *Informim për kryetarin e Komunës nga MMPHI rreth përgatitjes së Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar Sharri në Dragash*
- *Kërkesë drejtuar Ministrisë së Ekonomisë për tërheqje nga kërkesa për ndërtimin e fabrikës së përpunimit të ujt, kërkesë që mjetet e parapara të orientohen në ndërtimin e impiantit për përpunimin e ujërva të zeza në fshatin Brezne*
- *Kërkesë për financimin e restaurimit të objektit të Valavicës për MKRS-në*
- *Kërkesë për listën e emrave të rrugëve për Këshillat lokalë të fshatrave*
- *Kërkesë për financimin e restaurimit të objektit të Valavicës për MKRS-në*
- *Propozimet e komunës së Dragashit për Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar ‘‘Sharri’’- për Institutin për Planifikim Hapësinor*

- *Njoftim lidhur me bashkëfinancimin e projektit “Ndërtimi i shtegut të ecjes Dragash-stadiumi i qytetit” për MAPL-në*
- *Kërkesë emergjente për mbështetje financiare si pasojë e vërshimeve për Qeverinë e Kosovës*
- *Kërkesë drejtuar FFK-së për financimin e tepihut, tribunave e zhveshtoreve në stadiumin e fshatit Blaç dhe financimin e tepihut në stadiumin e fshatit Pllavë*
- *Kërkesë dërguar KFOR-it Turk për rehabilitimin e rrugës së vjetër të fshatit Vraniç*
- *Kërkesë/Njoftim për heqjen nga lista e privatizimit pronat e poshtëshënuara për AKP-në*
- *Kërkesë drejtuar Drejtorisë Rajonale Kufitare të Maqedonisë për hapjen e vendkalimit kufitar Strazimir-Republika e Maqedonisë së Veriut*
- *Njoftim për Stacionin Policor në Dragash për mbajtjen e Festivalit Ballkanik të Folklorit të Valleve “Opoja vallëzon”*
- *Kërkesë për OSHP-në lidhur me aktivitetin e prokurimit për projektin ‘Riparimi dhe kubëzimi rrugës në fshatin Kuk’ pas vërshimeve projekt (dyvjeçar) për shqyrtim të shpejt nga OSHP-ja*
- *Kërkesë për pastrimin e lumenjve të fshatrave të prekura nga vërshimet për KFOR-in Turk*
- *Kërkesë për trasimin e rrugës në fshatin Plavë për KFOR-in Turk Dragash*
- *Letër e shprehjes së interesit drejtuar MMPHI-së për Grant, për projektin e Banimit Social Adekuat*
- *Njoftim për të gjithë kryetarët e fshatrave në tërë territorin e komunës së Dragashit, se Komuna duke filluar nga muaji Shkurt i vitit 2025 do të bëjë pagesën e energjisë elektrike për ndriçim publik nëpër të gjitha fshatrat që e kanë të instaluar ndriçimin publik që dhe që ende nuk janë në sistemin e pagesave nga ana e Komunës*
- *Përgjigje në kërkesa dhe ankesa - 4*
- *Plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve – 1*
- *Rekomandime – 1*
- *Vendime për lejimin e furnizimit me karburante – 6*
- *Deklarata nën betim – 2*
- *Forma të autorizimit për listën e pagave – 1*
- *Kërkesa për rekrutim punësim – 33*
- *Raporte të komisionit për vlerësimin e dëmeve – 2*
- *Ankesa për MAPL-në – 1*
- *Aneks - kontratë për shërbime postare – 1*
- *Formular i raportimit vjetor – 1*
- *Formular për vlerësimin e rrezikshmërisë në punë – 1*
- *Lista e hollësishme e shërbimeve që ofron komuna për qytetaret – 1*
- *Aplikacion për mbështetje të projekteve infrastrukturore për komunitete – 1*
- *Shtojcë e programit për bashkëfinancim me donator sipas performancës – 2*
- *Numri i pagesave për vitin 2023 për grupin punues për raportimin e performancës – 2*
- *Takime publike – 2*

SFIDAT

Vërshimet e muajit qershor

Siç e dini, në muajin qershor të këtij viti që po e lëmë pas, Komuna e Dragashit është ballafaquar me disa vërshime të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme nëpër disa fshatra, si në ekonomi familjare, biznese, infrastrukturë publike dhe sipërfaqe bujqësore. Në bazë të kompetencave ligjore, si kryetar i Komunës dhe si qeverisje lokale kemi ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme qysh në fillim të gjendjes së krijuar nga vërshimet. Kemi bërë vlerësimin e menjëhershëm të dëmeve në infrastrukturë publike, ashtu siç kemi marrë rekomandimin nga organet qendrore. Kemi dorëzuar Raportin për shumën totale të dëmeve të vlerësuara. Mirëpo, pavarësisht kësaj, ne ende nuk kemi marrë ndonjë ndihmë nga Qeveria qendrore për riparimin e infrastrukturës publike. Rrjedhimisht, ne jemi detyruar që të bëjmë anulimin e disa tenderëve të planifikuar për këtë vit, dhe paratë e planifikuara për ato projekte t'i orientojmë në riparimin e infrastrukturës së dëmtuar nga vërshimet. Gjithashtu, ne menjëherë kemi formuar Komisionin Lokal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, i cili ka bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomi familjare, biznese dhe bujqësi. Komisioni ka pranuar gjithsej 227 kërkesa nga qytetarët dhe të gjitha i ka shqyrtuar. Raportin përfundimtar e ka dërguar në Asamble Komunale për miratim dhe pastaj e ka proceduar në Komision Qendror qeveritar për Vlerësimin e Dëmeve.

Vështirësitë me pronën publike

Një tjetër sfidë më të cilën ballafaqohet çdo vit Komuna e Dragashit është largimi i investitorëve potencialë, si pasojë e problemeve të vazhdueshme me çështje pronësore, kur dihet se Komuna jonë pjesën më të madhe të territorit e ka të shpallur park nacional dhe një pjesë tjetër është në kontest gjyqësor me AKP-në. Pavarësisht kësaj, ne si qeverisje lokale jemi vazhdimisht të përkushtuar për të bashkëpunuar me institucionet relevante të nivelit qendror, në mënyrë që të krijojmë kushte sa më të lehta dhe krijim të hapësirave të nevojshme për tërheqjen e investitorëve potencialë, gjë që në të ardhmen mund të na lehtësojë rrugën tonë drejt zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të Komunës së Dragashit.

PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

Gjatë vitit 2024 ka pasur një pjesëmarrje të konsiderueshme të qytetarëve nëpër të gjitha takimet publike, konsultimet publike dhe dëgjimet buxhetore që ka organizuar ekzekutivi lokal. Kjo ka bërë që mundësia e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe planifikim të buxhetit komunal të rritet dukshëm.

Vlen të theksohet se, si kryetar i Komunës gjithashtu kam marrë pjesë në të gjitha seancat e Kuvendit Komunal të mbajtura gjatë vitit 2024, ku kam raportuar për punën dhe u jam përgjigjur në vazhdimësi pyetjeve dhe kërkesave të asambleistëve të Kuvendit.

Të dy takimet publike me qytetarë janë mbajtur bazuar në dispozitat ligjore në fuqi:

Takimi i parë publik me qytetarë është mbajtur më **18.06.2024** dhe kanë marrë pjesë **30 qytetarë**:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Procesverbali-i-Takimit-publik-Scan.pdf>

Takimi i dytë publik me qytetarë është mbajtur më **26.12.2024** dhe kanë marrë pjesë **34 qytetarë**:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Procesverbali-nga-Takimi-i-Dyte-Scan.pdf>

Janë mbajtur gjithsej **3 dëgjime buxhetore** për Kornizën Afatmesme Buxhetor (KAB) 2025-2027:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Raporti-i-degjimeve-per-KAB-2025-2027-Scan.pdf>

Dëgjime buxhetor për Buxhetin e vitit 2025 janë mbajtur **2 nga ekzekutivi dhe 1 nga KPF-ja**:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/10/Raporti-i-degjimeve-2025-Scan.pdf>

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur dy konsultime publike për dokumente apo planë të veprimit:

Konsultimi publik për Draft-Planin e Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-Plani-kunder-braktisjes-se-shkolles-Scan.pdf>

Konsultimi publik për Draft-Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024-2028:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Raporti-i-konsultimit-publik-Scan.pdf>

Prioritetet tona kryesore për Dragashin vazhdojnë të jenë:

- *Administratë efikase, e përgjithshme dhe me shërbime moderne;*
- *Organizim më i mirë i punës dhe efikasitet i plotë i administratës së Komunës;*
- *Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit;*
- *Realizim i planit të të hyrave të Komunës;*
- *Rritja e përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët;*
- *Furnizimi me ujë të pijshëm;*
- *Zhvillimi i turizmit dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse;*
- *Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm;*
- *Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë dhe biçiklistë;*
- *Investime për ndriçim publik;*
- *Rritje e cilësisë dhe investime në arsim;*
- *Investime në nyje sanitare dhe meremetim të shkollave;*
- *Bursa për studentë;*
- *Hartimi i PZhK-së dhe Hartës zonale;*
- *Terrene të reja sportive dhe përkrahje e sportit, aktivitete të planifikuara me të rinjtë;*
- *Krijimi i kushteve të përshtatshme për investime të drejtpërdrejta për të mirën e qytetareve përmes krijimit të vendeve të përhershme të punës si dhe zhvillimit ekonomik;*
- *Bashkëpunimi i vazhdueshëm me kompanitë publike për shtimin e kapaciteteve për ujë të pijes dhe për shërbime më efikase në grumbullimin e mbeturinave për një ambient sa më të pastër dhe futjen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave për fshatrat që ende nuk janë të kyçura në sistem;*
- *Bashkëpunimi me komunitetin fetar, shoqëritë civile OJQ ndërkombëtare, vendore dhe partner të tjerë.*

Ju faleminderit!

Në seancën e kaluar, nga profesori e kam pas një pyetje, kështu që i kam mbet borxh. Më ka pyet se sa mjete financiare janë investue në fshatin Zyme dhe Qollopek. Këtu unë i kam nxjerrë shënimet nga Zyra e Prokurimit, janë dokumente të bazuara në fakte. Në vitin 2023, në fshatin Zym-Qollopek Komuna ka investuar 40,628 euro. Ndërsa, në vitin 2024 - 35,157 euro. Faleminderit!

Resul Fetahu: Të nderuar të pranishëm, më lejoni që para jush të shpalos Raportin Vjetor të Punës të Drejtorisë së Administratës për vitin 2024:

Raporti vjetor i hartuar nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme ka për qëllim që të pasqyrojë aktivitetet dhe punën që është zhvilluar gjatë vitit 2024 në sektorët që i përkasin kësaj drejtorie si dhe informimin e drejtë të qytetarëve, institucioneve komunale, shoqërisë civile dhe të gjitha palëve që janë të interesuara për punën e kryer gjatë këtij viti.

Duke marrë parasyshë faktin se Drejtoria e Administratës është ura lidhëse e shërbimeve të institucioneve lokale me qytetarët dhe institucionet qendrore, shërbimi i Administratës Komunale ka qenë i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore. Kjo drejtori ka bërë ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Dragashit konform ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në fuqi, gjatë vitit 2024. Shërbimet të cilat komuna u ofron qytetarëve të saj bazohen në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve duke qenë në harmoni të plotë me ligjet dhe udhëzimet administrative të Republikës së Kosovës.

Drejtorja për Administratë të Përgjithshme punën e saj e bazon brenda kornizave ligjore të cilat janë në fuqi si:

- *Ligji për Vetëqeverisjen Lokale;*
- *Ligji për Zyrtarët Publik;*
- *Ligjin mbi Librat Amzë;*
- *Statutin e Komunës;*
- *Rregulloret komunale;*
- *Urdhëresat dhe Udhëzimet Administrative;*

Drejtorja për Administratë të përgjithshme është kujdesur që gjatë vitit 2024 të krijojë kushte më të përshtatshme të punës për zyrtarët në mënyrë që shërbimet të jenë në nivel të kënaqur për qytetarët e Komunës së Dragashit.

Nga buxheti i Drejtorisë për Administratë të përgjithshme ashtu siç janë planifikuar mjetet kemi arritur që t'i realizojmë qëllimet duke mbuluar:

- *Pagat për stafin që i përkasin Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme,*
- *Shërbimi i telefonisë mobile,*
- *Shërbimet postare,*
- *Shërbimet e shtypjes (printim dhe skanim),*
- *Shërbimet e ujësjellësit,*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes së veturave zyrtare në kuadër të DAP,*
- *Furnizimi me inventar për nevojat e Komunës së Dragashit,*
- *Furnizim me material hargjues-higjienik për nevojat e Komunës së Dragashit,*
- *Furnizim me derivate për nevojat e automjeteve zyrtare,*
- *Rregullimi dhe mirëmbajtja e autoparkut dhe hapësirave për parking,*
- *Përmbushja e nevojave të tjera rreth objektit të Komunës së Dragashit,*
- *Bashkëpunim me drejtoritë e tjera për realizimin e projekteve.*

Të gjitha shpenzimet e Drejtorisë për Administratë të përgjithshme janë të paraqitura edhe në raportet financiare.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme në aspektin organizativ ndahet në disa sektorë që do të paraqiten si në vijim:

- I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria);***
- II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi;***
- III. Zyra e Prokurimit;***
- IV. Shërbimet Teknike;***
- V. Njësia për IT;***

I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria)

Shërbimi i Gjendjes Civile në Komunën e Dragashit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2024 ka arritur që të jetë shumë efikas dhe ti shërbejë të gjithë qytetarët në kohë optimale. Gjatë kësaj periudhe ky shërbim në kuadër të kompetencave të tij kryen një sërë aktivitete që do të paraqesim në vazhdim të këtij raporti.

Me punën e zyrtarëve të Gjendjes Civile arrihet që të lëshohen një numër i konsiderueshëm i dokumenteve nga ky sektor ku varion nga 40,000 sosh deri në 45,000 sosh brenda një viti. Kjo tregon që shërbimi për marrjen e një dokumenti të nevojshëm për qytetarët është shumë i shpejtë, efikas, i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm me kapacitetet aktuale që kemi.

Ashtu siq edhe e thekson statuti i Komunës sonë, Shërbimi i Gjendjes Civile (Ofiqaria) është i organizuar në pesë lokacione të cilat gjenden si në vijim:

- Dragash,*
- Bresanë,*
- Llapushnik,*
- Krushevë,*
- Brod.*

Këto pesë lokacione janë të vendosura në këtë mënyrë me qëllim që qytetarët ti kenë sa më afër Shërbimet e Gjendjes Civile ku mbulohet i gjithë territori i Komunës sonë.

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar me rritje të kërkesave për shërbimet që ofron Zyra e Gjendjes Civile dhe me ardhjen e bashkatdhetarëve tanë të cilët jetojnë jashtë Republikës së Kosovës, nga

data 21.07.2024 deri me datën 18.08.2024 ky shërbim ka punuar edhe gjatë fundjavës (ditës së shtunë) me orar nga ora 09:00 deri në ora 13:00 ndërsa vlen të theksohet se edhe gjatë ditëve të punës (e hënë-e premte) është punuar me orar të zgjatur nga ora 15:30 deri në ora 17:00.

Drejtoria e Administratës është kujdesur që të sigurojë kushte të punës për të gjithë zyrtarët duke vazhduar pajisjen me mjete moderne të IT në mënyrë që të rritet eficienca e shërbimeve.

Më poshtë do ta paraqesim në mënyrë tabelare punën e Shërbimit të Gjendjes Civile ku në detaje janë të paraqitura statistikat varësisht nga lloji i certifikatës, regjistrimet në regjistrat themeltar dhe regjistrimet në regjistrat e veçantë nga bota e jashtme.

❖ Për periudhën Janar –Dhjetor të vitit 2024 janë lëshuar këto dokumente të Gjendjes Civile:

Nr.	Lloji i certifikates	Brenda vendit	Jashtë vendit	Totali
1.	Certifikate lindje	496	6486	6982
2.	Ekstrakt lindje	13166	1316	14482
3.	Certifikate martese	2318	1880	4198
4.	Deklaratë e bashkësisë familjare	606	362	968
5.	Certifikate vendbanimi	1077	454	1531
6.	Certifikate e shtetësisë	66	179	245
7.	Certifikate e gjendjes martesore	461	202	663
8.	Vertetim nga arkiva	266	121	387
9.	Certifikate vdekje	1565	279	1844
Totali				31300

Dëshmi vdekje (Aktvdekje).....181

❖ Regjistrimet në regjistrat themeltar:

Nr.	Lloji	Sasia
1.	Aktet e Lindjes	7
2.	Aktet e Martesës	143
3.	Akte të Vdekjes	170

❖ Regjistrimet ne regjistrat e veçantë nga bota e jashtme:

Nr.	Lloji	Sasia
------------	--------------	--------------

1.	Aktet e Lindjes	149
2.	Aktet e Martesës	170
3.	Akte të Vdekjes	184

-Kërkesa për lirim nga shtetësia e RKS kanë aplikuar 22 persona.

-Kërkesa për fitimin e shtetësisë se RKS kanë aplikuar 181 persona.

-Në bazë të Nenit 31 dhe Nenit 32 të [LIGJI NR. 04/L-215 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS](#) janë regjistruar 17 persona.

-Shkurorëzime janë regjistruar 40.

Të hyrat e inkasuara nga Shërbimi i Gjendjes Civile në periudhën **01.01.2024** deri **31.12.2024** dhe të dorëzuara tek Zyrtari i Pasurisë së Komunës kanë vlerën prej **35,262.00€**. Sa i përket zbatimit të Platformës Elektronike eKosova, viti 2024 shënon një rritje të përdorimit të kësaj platforme ku në total kemi **12419 dokumente të lëshuara**, dhe të ndara si vijon:

NR.	LLOJI I DOKUMENTIT	SASIA
1.	Certifikata e lindjes	5115
2.	Ekstrakt nga RQGJ	5226
3.	Certifikata e martesës	1796
4.	Certifikata e vdekjes	282
TOTAL:		12419

Po ashtu me qëllim mirëmbajtjen e stokut të formularëve është bërë edhe furnizimi me formular të certifikatave nëpër zyret e Gjendjes Civile në total prej 10 400 sosh.

Të gjitha këto statistika të pasqyruara në këtë raport si dhe tabelat e detajizuara janë përcjellur në baza të rregullta në Entin e Statistikave të Kosovës.

II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi

Zyra për shërbim të Qytetarëve u shërben qytetarëve për t'u informuar me procedurat e nevojshme për kryerjen e punëve administrative në harmoni me dispozitat ligjore për kryerjen e shërbimeve të ndryshme nga organet e administratës komunale. Zhvillimi i procedurave bëhet si në vijim: fillimisht paraqitet kërkesa, protokollohet, skanohet, ruhet në sistemin e INTRANET-it dhe më pas shpërndahet me anë të librave të brendshëm dhe elektronikë deri tek drejtoritë përkatëse nga ana e personit të autorizuar për kryerjen e këtij shërbimi. Protokoli për këtë procedurë administrative mbahet në mënyrë elektronike si dhe me shkrim, njëherit të gjitha kërkesat, dokumentet dhe shkresat të cilat janë të protokolluara, skanohen dhe më pas përcillen në ministri dhe në drejtori përkatëse me anë të sistemit të INTRANET-it. Kështu në çdo moment mund të përcjellim në këtë sistem azhurnimet e shërbimeve përbrenda komunës. Në periudhën kohore 01.01.2024 – 31.12.2024 në këtë zyrë janë regjistruar gjithsej **32787 lëndë**.

Gjatë këtij viti është bërë edhe furnizimi i kësaj zyreje me skanerët portativ të cilët kanë përmirësuar dukshëm shpejtësinë e ofrimit të shërbimeve nga Zyra e Pritjes.

Po ashtu, këtë vit është bërë edhe renovimi i tërësishëm i Zyrës së Pritjes, me qëllimin e vetëm ngritjen e kualitetit të shërbimeve për qytetarët.

Në këtë zyre gjithashtu kryhen edhe pagesat e shërbimeve komunale sipas Rregullores mbi Taksat Komunale për shërbime të caktuara. Gjatë vitit 2024 janë inkasuar gjithsej **14,578.00 €**.

III. Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit funksionon në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës dhe akteve të tjera që janë nxjerrë nga ky Ligj.

Kjo zyrë, edhe pse me mungesë stafi konform nevojave, gjatë vitit 2024 ka qenë mjaftë efikase duke arritur që të kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë me një dinamikë të jashtëzakonshme duke realizuar kështu me sukses buxhetin e planifikuar për këtë vit. Të gjitha projektet, duke përfshirë projektet e investimeve kapitale, projektet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe për nevoja të tjera të të gjitha sektorëve të Komunës së Dragashit kemi arritur t'i realizojmë me sukses dhe në kohë. Në vazhdim do të paraqesim punët që ka kryer kjo zyrë duke pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse në mënyrë që të realizohen të gjitha objektivat e parapara për këtë vit.

Gjatë vitit 2024 kjo zyrë ka zhvilluar gjithsej **120 aktivitete prokurimi** me një vlerë totale të parashikuar të kontratave prej **6,543,769.03€** dhe si rezultat, shuma e kontratave të nënshkruara të projekteve të investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve arrin shumën prej **5,210,732.86€**, shumë kjo e cila iu është bërë në formë pagese Operatorëve Ekonomik (OE) të ndryshëm.

Kjo vlerë e paraqitur në këtë raport është realizuar me një numër të madh operatorësh ekonomik, të cilët kanë marrë pjesë përmes ofertimit në procedurat e iniciuara nga ana e Komunës së Dragashit.

Me qëllim ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies, të gjitha kontratat e nënshkruara me Operatorët Ekonomikë janë publikuar edhe në ëeb faqen e Komunës së Dragashit në mënyrë që të gjithë qytetarët apo grupet e ndryshme të interesuara për aktivitetin e Zyrës së Prokurimit të kenë qasje dhe të përcjellin nga afër punën e kësaj zyreje dhe qeverisjes lokale në përgjithësi.

IV. Shërbimet Teknike

Në kuadër të këtij shërbimi janë të përfshira këto njësi:

- 1. Autoparku i Komunës;**
- 2. Rojet e objekteve Komunale;**
- 3. Shërbimi i pastrimit të objekteve Komunale;**
- 4. Depo e Komunës;**

V. Njësia e Teknologjisë Informative

Njësia për Teknologji Informative është zyrë shumë dinamike dhe konsiderohet si kyçe në punët Administrativo-teknike. Kjo zyrë e ka këtë rëndësi për shkak të vizionit dhe realizimit të përditshëm të një qeverisjeje elektronike, duke u kujdesur që planet të realizohen në vepra me përdorim të teknologjisë moderne softverike dhe hardverike.

Kjo zyrë gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar në baza ditore aktivitetet si në vijim:

- *Intervenime rutinore nëpër kompjuterë të punëtorëve të administratës komunale të cilat kanë pasur nevojë për ruajtjen e shënimeve, formatizimin e tyre, intervenime softëerike, etj;*
- *Mirëmbajtjen e sistemit të INTRANET-it;*
- *Furnizimi dhe konfigurimi i skanerëve në zyrën e pritjes;*
- *Mirëmbajtja e sistemit elektronik të arkivimit;*
- *Mirëmbajtja e sistemit të e-Pasuria;*
- *Kontrollimi dhe mirëmbajtja e përditshme e serverëve komunal;*
- *Puna e përditshme në ëeb faqen e Komunës;*
- *Mirëmbajtja e llogarive të emailit zyrtar për tërë zyrtarët komunal;*
- *Hartimi i Planit detal për mbulimin me pamje audio-vizuele (kamera) të objektit të Komunës dhe objekteve përcjellëse;*
- *Shtirirja e rrjetit qeveritar edhe në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Dragash;*
- *Krijimin e shfrytëzuesve të ndryshëm në sistemin e INTRANETI-it dhe në domenin qeveritar;*
- *Punë të ndryshme sipas kërkesave në fushën e teknologjisë informative;*

- Takime të ndryshme me ftesë nga Ministria dhe Kolegjiumi i IT-ve në kuadër të AKK;
- Asistenca në mbarëvajtjen e mbledhjeve të asamblesë komunale, lidhja direkte në kanal in zyrtar në youtube, dhe plasimi i xhirimeve në ëeb faqen e komunës;
- Intervenime në teren dhe Zyret e Gjendjes Civile;

Ju faleminderit! Ky ishte Raporti i Punës, ndërsa në vijim do t'jua shpalosi Planin e Punës:

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr.03/L-149 mbi Sherbimin Civil, Ligjin Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, Udhëzimeve Administrative, Statutin e Komunës, Rregulloret Komunale, Urdhëresat dhe Udhëzimet komunale që specifikojnë rregullat dhe modalitetet e aplikimit të Ligjit dhe veprimet administrativ, Drejtoria e Administratës Komunale do të ushtrojë aktivitetin në të gjithë sektorët e saj organizativ si në vijim:

- *Spektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria).*
- *Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi.*
- *Zyra e prokurimit.*
- *Shërbimet teknike.*
- *Njësia për IT.*

Për te siguruar një punë efikase Drejtoria e Administratës përgatitë Planin e Punës për vitin 2025, në të cilin plan do të paraqiten objektivat dhe dinamika e arritjes se këtyre objektiveve për këtë vit.

Qëllimi i këtij plani është të përgatisim një plan menagjimi të bazuar në kapacitete organizative dhe teknike, përmirësim të kushteve të punës, performancës së deritashme dhe shfrytëzimit sa më të mirë të kapaciteteve që ka kjo drejtori me qëllim rritjen e nivelit të performancës dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Zbatimi i përvojës që është krijuar nga stafi i sektorëve dhe mundësia e përmirësimit të shërbimit për secilin sektorë do të jetë sfidë dhe objektiv i ynë i përbashkët.

RËNDËSIA DHE HAPAT

Rëndësia e këtij plani qëndron në mundësinë e eliminimit të dobësive që kanë përcjellur Administratën Komunale nga viti paraprak dhe që kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në performancë. Menagjimi i bazuar në performancë është një qasje që në mënyrë sistematike mundëson përmirësimin e performancës përmes një procesi të vazhdueshëm të vendosjes së objektiveve, matjes së performancës përmes grumbullimit, analizimit dhe rishikimit të të dhënave. Vlerësojmë se Plani Vjetor i Punës duhet të bazohet në performancë e jo në numër të aktiviteteve, sepse rezultatet janë ato që flasin.

Dinamika e punës sipas këtij plani duhet të përcillet çdo javë me qëllim që mos të ketë ngecje në përmbushjen e objektiveve, por në mënyrë sistematike të përcillen të arriturat të përcaktuara në

këtë plan.

Problemet sikurse është mungesa e hapësirave të nevojshme dhe kushteve optimale tashmë është përmirësuar dhe jemi në kërkim e sipër edhe të zgjerimit të mëtejshëm të hapësirave ekzistuese. Procesi i filluar tashmë i digjitalizimit të shërbimeve administrative dhe rregullimi i statusit të zgjidhjes së lëndëve mbetet gjithashtu sfidë edhe këtë vit.

Sektori i Gjendjes Civile

❖ Objektivat

1. Regjistrimi i lindjeve, martesave dhe vdekjeve brenda dhe jashtë vendit

1.1 Dhënia e infomatave korrekte dhe informimi për procedurat e regjistrimit të lindjeve, martesave dhe vdekjeve.

1.2 Përpjekja që qytetarët të jenë të kënaqur me kohën dhe shërbimet e mira.

2. Lëshimi i dokumenteve të Gjendjes Civile

2.1 Lëshimi i dokumenteve të GJC në kohë optimale dhe tani me UA të MPB nr.01/2022 lëshohen me QR Code që nënkupton vërtetimin e autenticitetit, duke zbatuar legjislacionin në fuqi të RKS.

3. Përcjellja e punës dhe aktiviteteve të të gjithë zyrtarëve të sektorit të Gjendjes Civile.

3.1. Punë efikase, shërbime dhe rezultate më të mira.

3.2 Përmirësim i kushteve të punës, furnizimi i zyrave me orman metalik, karrige dhe tavolina te punës dhe stol qëndrimi për palët si dhe vendosja e një printeri multifunksional në shërbim të qytetarëve gjatë sezonës kur ka fluks më të madh të qytetarëve.

4. Bashkëpunimi i ngushtë me ministrinë përkatëse MPB, MAPL, MAP si dhe departamentet që operojnë në këto ministri.

4.1 Bashkëpunim me DRGJC –ARC në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4.2 Bashkëpunim me sektorët e Teknologjisë Informative për programet që përcjellin punën dhe veprimtarinë tonë.

4.3. Për vitin 2025 jemi të përgatitur që të zbatojmë çdo direktivë, udhëzim nga ARC-MPB sa i përketë kërkesave që vijnë në kuadër të liberalizimit të vizave dhe realizimit të standardeve europiane.

5. Raportimi i punës në sektorin e Gjendjes Civile

5.1 Raportet javore, mujore dhe vjetore në forma tabelare me statistikat përkatëse për lindjet, martesat dhe vdekjet. Po ashtu me këto të dhëna njoftohet edhe Enti i Statistikës së Republikës së Kosovës.

6. Zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve të reja në sektorin e Gjendjes Civile.

6.1 Përcjellja në kohë e njoftimeve dhe informacioneve tek zyrtarët e Gjendjes Civile.

Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi

❖ Objektivat

- Zyra për shërbimin e qytetarëve do të funksionojë si pjesë e strukturës organizative të administratës së komunës.
- Çdo shërbim publik që ofron komuna, duhet të protokollohet përmes zyrës dhe secila drejtori duhet të jetë e lidhur me këtë zyrë.
- Zyra do të pranohet dhe procedon për shqyrtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në drejtoritë komunale dhe njësitë organizative brenda drejtorive.
- Zyra ofron shërbime tjera si vijon: shërbimet e arkivës, shërbimet e gjendjes civile, tatimin në pronë, shërbimet kadastrale dhe të gjitha shërbimet tjera.
- Zyra duhet të këshillojë dhe të ndihmojë në çështjet teknike-administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave.
- Do të bëjë pranimin dhe regjistrimin e kërkesave.
- Do të bëjë mbajtjen e dosjeve, statistikave të kërkesave të paraqitura nga qytetarët.
- Gjithashtu do të protokollojë të gjitha aktet e nxjerra nga organet e komunës.
- Do të vazhdojë implementimin dhe përditësimin e të dhënave në kohë reale në sistemin e INTRANET-it.

Zyra e Prokurimit Publik

Kjo zyrë përveç realizimit të buxhetit të aprovuar nga Asambleja Komunale për investime kapitale dhe shpenzime të ndryshme që ka komuna gjithashtu do të përkujdeset për ofrimin dhe procesimin e të gjitha kërkesave dhe nevojave që vijnë nga drejtoritë komunale.

Në mënyrë që projektet të realizohen me sukses për t'a arritur një përqindje të konsiderueshme të realizimit të buxhetit që është paraparë për vitin 2025, zyra e Prokurimit do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha drejtoritë komunale si në projektet e investimeve kapitale poashtu edhe me furnizimet e nevojshme për organet e administratës komunale.

Po ashtu, me qëllim ngritjen e transparencës e gjithë veprimtaria e zyrës së prokurimit do të publikohet në ëeb faqen e komunës si dhe në platformën eProkurimi.

Shërbimet Teknike

❖ Njësia e Autoparkut Komunal:

Njësia e autoparkut të komunës është planifikuar në atë mënyrë që:

- *Të gjithë përdoruesit e automjeteve duhet që të përdorin automjetet zyrtare në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase.*
- *Do të bëhet mirëmbajtja e simboleve apo shenjave identifikuese të Komunës së Dragashit tek automjetet zyrtare.*
- *Do të bëhet servisi i rregullt i automjeteve në mënyrë që automjetet të jenë vazhdimisht në dispozicion për kryerjen e detyrave zyrtare.*
- *Varësisht nga kostoja, do të shqyrtohet mundësia e paisjes me GPS e të gjitha automjeteve zyrtare.*

❖ Sigurimi i Objekteve Komunale:

Sigurimi i objektit të Komunës do të kryej punën sipas aktivitetit si në vijim:

- *Do të jetë në gjendje që gjatë natës të kujdeset për objektin e Komunës.*
- *Do të përcjellë sigurinë e objektit.*
- *Do të mundohet që të parandalojë rreziqet që mund të paraqiten gjatë natës.*
- *Do të mbajë evidencë për hyrje-daljen e zyrtarëve gjatë natës.*
- *Do të adresojë problemet eventuale që mund të paraqiten gjatë punës.*

❖ Shërbimi i pastrimit:

Ky shërbim do të kujdeset që hapsirat e objektit të Komunës të jenë të pastërta duke u kujdesur për secilën hapsirë të komunës dhe të objektit të ZGJC-Dragash.

Gjithashtu nevojat për mjete pastrimi do të ju sigurohen në bazë të kërkesave të tyre pranë Depos së Komunës dhe konform kontratave të cilat organizohen nga Zyra e Prokurimit.

Njësia e Teknologjisë Informative

Objektivat apo planet e njësisë së IT-së për vitin 2025 janë si në vijim:

- *Mirëmbajtja e paisjeve teknologjike për të gjithë punëtorët e Administratës.*
- *Zhvendosja e lokacionit të dhomës së serverëve (Server Room) në një hapsirë më të madhe.*
- *Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit, hartimi i planit detal të LAN-it dhe implementimi i projektit.*

- *Instalimi i sistemit të ri të monitorimit të kamerave për objektin e Komunës së Dragashit.*
- *Asistencë në implementimin e sistemit të INTRANET-it për të gjithë punëtorët e Administratës Komunale.*

Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Po ju paraqesim Raportin e Punës për vitin 2025:

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim është i organizuar në këto njësi punuese:

<i>1</i>	<i>Zhvillim ekonomik</i>
<i>2</i>	<i>Buxhet dhe Financa</i>
<i>3</i>	<i>Zyra e Tatimit në Pronë</i>
<i>4</i>	<i>Zyra për Regjistrimin e Bizneseve</i>
<i>5</i>	<i>Njësia e Thesarit- regjistrimit te pasurisë komunale</i>

Drejtoria për zhvillim ekonomik konsiderohet si pikë kyçe në nxitjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja në vend, si promotorë e zhvillimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe si një entitet i fortë stimulues për produktet vendore lokale.

Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim, bazuar në dispozitat e nenit 60 dhe 61 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Qarkoreve Buxhetore 2024/1,2, ka marrë pjesë në përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Projekt-buxhetin për vitin 2024-2026, për periudhën në fjalë, duke i respektuar afatet dhe procedurat e aprovimit të buxhetit.

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka përgatitur Planin e Veprimit për rekomandimet e auditorit për Pasqyrat Financiare 2023 dhe raportet e progresit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e auditimit për vitin 2024. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka përgatitur Rregulloren për Tatimin në Pronë dhe ka raportuar në Asamblenë Komunale për raportet e realizimit të buxhetit. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka marrë pjesë nëpër dëgjime publike të organizuara. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka vazhduar të përmbushë detyrat e saj në promovimin dhe zhvillimin e sektorëve ekonomikë të komunës, duke organizuar dhe marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me qëllim të fuqizimit të bizneseve lokale, turizmit dhe bujqësisë. Ky raport përmbledh aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës raportuese.

1. *Mbajtja e Panairit të Turizmit dhe Sportit*
2. *Pjesëmarrja në Panairin “Agrokos”*

• *Përshkrimi i Aktivitetit: Drejtoria mori pjesë aktive në panairin “Agrokos”, i cili kishte për qëllim promovimin e produkteve vendore bujqësore dhe përkrahjen e fermerëve dhe prodhuesve vendorë.*

3. *Organizimi i Panairit “Expo Sharri”*

• *Përshkrimi i Aktivitetit: Ky panair u organizua në bashkëpunim me Shoqatën e Afaristëve të Komunës së Dragashit, me fokus në promovimin e produkteve dhe shërbimeve lokale të rajonit të Sharrit.*

4. *Takimi me Bizneset Lokale për Formimin e Këshillit Lokal të Bizneseve*
5. *Aplikimi në programin e BE për projekte ndërkufitare IPA për vitin 2025.*

Gjithashtu drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka filluar se punuari strategjinë për zhvillim ekonomik lokal ku janë të përfshira të gjitha pikat kyçe që ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunën e Dragashit.

Njësia Punuese për Buxhet- Financa

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim, bazuar në dispozitat e nenit 60 dhe 61 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Qarkoreve Buxhetore 2024/1,2, ka marrë pjesë në përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Projekt-buxhetin për vitin 2024-2026, për periudhën në fjalë, duke i respektuar afatet dhe procedurat e aprovimit të buxhetit. Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka përgatitur Planin e Veprimit për rekomandimet e auditorit për Pasqyrat Financiare 2023 dhe raportet e progresit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e auditimit për vitin 2024.

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka marrë pjesë nëpër dëgjime publike të organizuara në Asamblenë Komunale dhe nëpër fshatra për propozim-buxhetin e vitit 2025. Ka përgatitur raportet mujore financiare, si dhe raportet tremujore financiare, për raportim në Asamblenë Komunale.

Në vazhdimësi kryen të gjitha pagesat dhe transaksionet për investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe përcakton procedurat për ekzekutimin e pagesave.

Njësia e Tatimit në Pronë

Detyra kryesore e zyrës është që çdo vit të llogarisë dhe të faturojë pronarët dhe përdoruesit e pasurive të paluajtshme, shumën e taksave që duhet të paguajnë për një vit të caktuar, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur sa më shumë tatimin e llogaritur dhe të zbritur të pronës. Gjithashtu, të regjistrojë të gjitha objektet dhe pronat e reja, si dhe të verifikojë të paktën 1/5 e objekteve ekzistuese.

Njësia e Tatimit në Pronë

Në vitin 2024 janë printuar dhe dorëzuar gjithsej 7.673 fatura tatimore në pronë.

Të paguar deri më 10.Dhjetor 2024 (raport final) në total janë 240.060,00 €, nga të cilat 149,560.00 € i referohen ndërtesave dhe 90,500.00€ për tokën.

Janë pranuar 670 ankesa, të cilat kryesisht janë zgjidhur pozitivisht në favor të tatimpaguesve.

Vetëm 5 u refuzuan.

Në total, ZTP ka lëshuar 1488 vërtetime të ndryshme në bazë të kërkesave të qytetarëve dhe mbi 3000 fatura për të njëjtat nevoja.

Janë regjistruar 286 ndërtesa të reja, dhe janë verifikuar 1680 prona ekzistuese.

Te paraqitura edhe me te detajuara mund ti shihni me poshtë:

Numri i pronave(objekteve) ne komune..... 11,435

Numri I pronave (objekteve) te ri-anketuara (ri-vlersimet)..... 1,818

Objektet te reja te regjistruara..... 286

*E shprehur në përqindje *1.818+286=2104/11.435= 18,40%*

Ngarkesa për vitin 2024 për objekte..... 168.167,19

Ngarkesa për vitin 2024 për parcela..... 305.680,20

Total:..... 473.847,39 €

Pagesa e tatimit për vitin 2024 për objekte..... 46.083,40

Pagesa e tatimit për vitin 2024 për parcela..... 55.080,29

Total:..... 101.163,69 €

E shprehur në përqindje është **21,35%**

Vrejtje:Totali i tatimit të arkëtuar mbi pasurinë e paluajtshme në vitin 2024, me interes dhe dhenim është: 250.367,78 €53%

Burimi I te dhënave: baza PROTAX-raport financiar

Njësia e Thesarit

Njësia e thesarit dhe e regjistrimit te pasurisë komunale raporton me këto te dhëna:

Ne arkën kryesore janë pranuar nga Inkasantët Shumat prej **50335.00 €**. Ku te njëjtat te hyra brenda ditës janë dorëzuar ne bankë të ndara në baze të UNIREF-it për çdo pagës edhe janë bërë barazimet me zyrtarin e të hyrave.

Në të njëjtën periudhë kemi tërhequr dy here nga **500 €** për pagesën e faktuarave te imta deri ne **100 €** , dhe i kemi mbyllë në fund te vitit kalendarik.

Gjate kësaj periudhe kemi regjistruar pasurinë mbi 1000€ dhe Investimet Kapitale ne sistemin e **SMFK**,

dhe kemi regjistruar ne sistemin **E PASURIA** edhe pasurin komunale nen **1000 €**.

Njësia - zyrtari përgjegjës në Qendrën Komunale për Regjistrimin e Biznesi

Zyra e Regjistrimit të Bizneseve në Komunën e Dragashit ka funksionuar me orare të plot duke ndihmuar Bizneset lokale në mbështetje dhe lehtësim në qasje dhe pranim të dokumenteve që ndërlidhen me këtë zyre, po ashtu bizneset kanë marrë shërbime dhe këshilla te nevojshme.

Duke u bazuar në statistikat që gjenden në sistem të ARBK – së figurojnë këto të dhëna:

Totali i Bizneseve të regjistruara në Komunën e Dragashit:

Nr.	Llojet e Bizneseve	Numri i Bizneseve
1	Biznese Individuale B.I	1768
2	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara SH.P.K	118
3	Ortakëri të përgjithshme	13
4	Koperativa Bujqësore	6
5	Ndërmarrje shoqërore N.SH	1

Numri i bizneseve te hapura ne katër vitet e fundit:

Viti	Numri i bizneseve të reja
2021	53
2022	54
2023	48
2024	44
Totali	199

Aktivitetet që ofrohen nga bizneset e komunës së Dragashit janë si në vijim:

Nr.	Aktivitetet që shërbejnë më shumë	Numri Bizneseve
1	<i>Tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara</i>	126
2	<i>Aktivitetet shërbyese të pijeve</i>	95
3	<i>Tregti me pakicë në dyqane ku mbizotëron ushqimi, pijet</i>	81
4	<i>Restorante dhe aktivitete shërbyese të ushqimit</i>	79
5	<i>Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave</i>	73
6	<i>Ndërtimi objekteve banesore dhe jo banesore</i>	43
7	<i>Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve</i>	36

Llojet e bizneseve sipas gjinisë në Komunën e Dragashit:

Nr.	Llojet e bizneseve	Meshkuj	Femra
1	<i>Biznese Individuale B.I</i>	688	85
2	<i>Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara SH.P.K</i>	92	21
3	<i>Ortakëri e Përgjithshme O.P</i>	2	1
4	Numri total i bizneseve për meshkuj dhe femra	782	107

Mbajtja e kontratave të shfrytëzuesve të përkohshëm të objekteve komunale me karakter të përkohshëm dhe mbajtja e kontratave të pronës komunale me shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, në bazë të ankandeve të organizuara nga Komisioni Komunal për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, i themeluar nga Asambleja Komunale.

Përfunduar me Raportin. Atëherë, vazhdojmë me Planin e Punës për vitin 2025:

Nr		Afati
-----------	--	--------------

	<i>Përshkrimi i detyrave të planifikuara</i>	
1	<i>Punët përgatitore për fillimin e vitit buxhetor sipas Udhëzimit Administrativ - punimi dhe dorëzimi i planit të rrjedhjes së parasë së gatshme në Ministrinë e Financave-Departamenti i Thesarit-ZKF</i>	<i>Janar 2025</i>
2	<i>Barazimi i të hyrave dhe shpenzimeve me të dhënat në SIMFK Sipas afateve të caktuara nga ana e MEF- it Departamentit të Thesarit. -ZKF</i>	<i>Deri 31 janar 2025</i>
3	<i>Përgatitja dhe dorëzimi i Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më janar-dhjetor 2024 të punuara sipas rregulloreve financiare- ZKF</i>	<i>29.01.2025</i>
4	<i>Regjistrimi dhe raportimi mbi të hyrat vetanake të komunës</i>	<i>Detyrë e përhershme</i>
5	<i>Regjistrimi dhe ekzekutimi i urdhërpagesave në SIMFK</i>	<i>Detyrë e përhershme</i>
6	<i>Regjistrimi dhe tërheqja e avanseve për pagesa me para të gatshme. Pranimi i parave nga inkasimi dhe dorëzimi në llogarinë bankare të komunës dhe përgatitja e raporteve.</i>	<i>Detyrë e përhershme</i>
7	<i>Regjistrimi i pasurisë mbi 1000 euro në SIMFK dhe regjistrimi në e- pasuri nën 1000 euro.</i>	<i>Detyrë e përhershme</i>

8	<i>Regjistrimi i bizneseve, konsulta të ndryshme rreth bizneseve, mbajtja e kontratave pasi qe ato te nënshkruhen për ngarkim te qirasë, pagesa e qirave ne baza mujore.</i>	<i>Detyre e përhershme</i>
9	<i>Përgatitja e nismës për inicimin e shpenzimeve për investime kapitale.</i>	<i>Shkurt 2025</i>
10	<i>Shtypja e faturave, specifikat dhe vlerësimet e tokave për tatimpaguesit te cilët jetojnë në Komunën e Dragashit. Informimi i tatimpaguesve rreth aplikimit te tatimit ne tokë.</i>	<i>Shkurt 2025</i>
11	<i>Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë Lëshuara e aktvendimeve mbi ngarkesën e qirave vjetore për shfrytëzimin e tokës ndërtimore, Barazimi i te hyrave vetanake dhe shpenzimeve me te dhënat nga SIMFK.</i>	<i>Shkurt-Mars Mars Fundi i Marsit</i>
12	<i>Pranimi i ankesave dhe vërejtjeve nga qytetaret për faturat e tatimit ne prone.</i>	<i>Mars</i>
13	<i>Bartja e te hyrave vetanake te pashpenzuara.</i>	<i>Mars-Prill 2025</i>
14	<i>Raporti periodik mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar –mars 2025.</i>	<i>Fundi i prillit 2025</i>
15	<i>Përgatitja dhe hartimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.</i>	<i>Mars-Dhjetor</i>
16	<i>Raporti mbi numrin e bizneseve të regjistruara pranë qendrës për regjistrimin e bizneseve në Dragash.</i>	<i>15 prill 2025</i>

17	<i>Seleksionohen, verifikohen dhe printohen faturat e borxhlinjve më të mëdhenj të tatimit në pronë përsëri tu shpërndahen faturat dhe nëse nuk paguhen borxhet te ndërmerren masa te parapara me ligj për pagese te detyruar.</i>	<i>Maj 2025</i>
18	<i>Regjistrimi i te gjitha objekteve te reja te ndërtuara dhe verifikimi i objekteve tjera ekzistuese lëshuerja e vërtetimeve dhe dokumenteve (vërtetimi për regjistrim te automjetit, për ndihma sociale, për viza etj.)</i>	<i>Detyre e përhershme</i>
19	<i>Bartja e shitblerjeve të kontratave dhe bashkëpunimi me MEF, Departamenti i tatimit ne pronë.</i>	<i>Detyrë e përhershme</i>
20	<i>Raporti mbi inkasimin e mjeteve nga shfrytëzimi i tokës dhe objekteve ne pronësi te komunës me karakter te përkohshëm.</i>	<i>Detyre e përhershme</i>
21	<i>Pagesa e tatimit, lëshuarja e certifikatave të ndryshme për pagesën e tatimit dhe regjistrimi i objekteve të reja.</i>	<i>Detyrë e përhershme</i>

22	<i>Përgatitja dhe procedimi i urdhër zotimeve për pagesë.</i>	<i>Detyrë e përhershme</i>
23	<i>Përgatitja e raportit të shpenzimeve dhe të hyrave për periudhën janar-qershor 2025.</i>	<i>Korrik 2025</i>
24	<i>Debat publik rreth projekt propozimit të Buxhetit për vitin 2025-2027.</i>	<i>Korrik 2025</i>
25	<i>Përgatitja dhe shqyrtimi i Rregullores për vendosjen e tatimit në Pronë për vitin 2025 (varësisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave).</i>	<i>Fundi i Tetorit</i>
	<i>Debati i dytë lidhur me buxhetin 2025-2027 (varësisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave).</i>	<i>Gusht 2025</i>

27	<i>Shqyrtimi i Raportit mbi realizimin e buxhetit për periudhën janar-shtator 2025.</i>	<i>Tetor 2025</i>
28	<i>Punët përgatitorë rreth përmbyllje së UZP sipas afateve të cilat i përcakton MEF-i -Departamenti i Thesarit.</i>	<i>Nentor 2025</i>
29	<i>Punët e përmbylljes së vitit buxhetor 2025.</i>	<i>Dhjetori 2025</i>

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim do të bashkëpunojë ngushte me institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës. Varësisht nga plani dhe programi i Ministrive përkatëse, punëtorët e këtij drejtorati do të jenë pjesëmarrës të aktiviteteve në trajnime dhe ligjërata të cilat do të organizohen nga ministrinë organizatat dhe asociacionet.

Ju faleminderit për durimin që patët!

Liridona Misinaj: Përshëndetje për të gjithë! Urime muaji i shenjtë i Ramazanit! Më lejoni që ta paraqes Raportin e Punës së DKRS-së për vitin 2024, raport i cili është bazuar në Planin e Punës i cili është miratuar nga Asambleja Komunale vitin e kaluar. Kryetari vetëm sa i tha pjesën dërmuese të aktiviteteve. Po i përmendi një nga një, për korrektësi:

Takim me të rinjtë e komunës;

Flaka e Janarit;

17 Shkurti - Dita e Pavarësisë;

Epopeja e UÇK-së;

Festivali “Hasi Jehon”;

5 Maji - Dita e Dëshmorëve të Atdheut;

Trajnim për marketing ne mediat sociale;

1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve (kanë qenë dy aktivitete të mrekullueshme);

Ekspozitë me fotografi;

Sofra Ymer Prizrenit (një aktivitet i cili mbahet në fshatin Zgatar);

Hartimi i Planit të Turizmit;

Festivali Folklorik Mbarëkombëtarë “Hani i Elezit”;

Dita e Çlirimit të Komunës (po në këtë ditë janë organizuar shumë aktivitete);

Festivali Gjithëkombëtar i Folklorit “Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen” (këto aktivitete në të cilat ka qenë pjesëmarrëse SHKA “Bresana”);

Ekspozita e Qenit Ilir të Sharrit;

Festivali Ballkanik i Folklorit të Valleve “Opoja Vallëzon” (një ndër festivalet më të bukur dhe më të veçantë që ka Komuna e Dragashit);

“Ditët e Mërgatës” - Liqeni i Breznës;

“Ditët e Mërgatës” – Bellobrad (përmes një turneu futbolli me pjesëmarrje të ekipeve të ndryshme nga fshatrat tonë);

“Ditët e Mërgatës” – Dragash;

Trajnim me të rinj (me Qendër Rinore AVOKO);

“Ditët e Mërgatës” – Kosce;

“Ditët e Mërgatës” – Restelicë;

“Ditët e Mërgatës” – Dragash;

Dita e Rinisë;

Festivali Ndërkombëtar “Nedelino 2024” Bullgari (ku na ka përfaqësuar SHKA “Bresana”);

Kamping me të rinj në Brod;

Turne në shah “Kupa e Sharrit”;

Festivali Folklorik Kombëtar i Këngëve dhe Valleve “Folk Fest” – Shtime;

Konferenca për bashkëpunim midis Qeverisjeve Lokale dhe Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor – Podgoricë (ku kam pasur kënaqësinë të përfaqësoj Komunën e Dragashit);

Dita ndërkombëtare pa makina (aktivitet i cili është realizuar me Shkollën Filllore “Fetah Sylejmani”);

Festivali Mbarë kombëtar i Folklorit Burimor "DUFLLA" - Saraj , Maqedoni e Veriut;

Lansimi i i platformës <https://visitdragash.com/> (një ndër projektet më të mira që është realizuar, ku mund të qasen direkt vizitorët dhe të gjithë ata të cilët dëshirojnë të shohin Komunën e Dragashit, bukuritë natyrore dhe për gjithçka që janë të interesuar);

Festivali Kombëtar Folklorik "Pushka e Lirisë" – Podujevë;

28 Nëntori – Dita e Flamurit Kombëtar;

Parada Kuq e Zi – Tiranë;

Ndarja e certifikatave për praktikantë (një Memorandum Bashkëpunimi në mes të Komunës dhe Dragashit dhe ReLoad2, të cilët i falënderoj për bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komunën e Dragashit);

Shënimi i 25 vjetorit të SHKA "Bresana".

Po ashtu, rëndësi të veçantë i kemi kushtuar klubeve sportive, organizatave të shoqërisë civile, të cilat i kemi subvencionuar me vendim të kryetarit:

Në fushën e Kulturës:

1.	<i>SHKA "Bresana"</i>
2.	<i>SHKA "Bresana"</i>
3.	<i>OJQ "Kroi i Maces"</i>
4.	<i>OJQ "BISER"</i>
5.	<i>SHKA "OPOJA"</i>
6.	<i>OJQ "EMKACBEND"</i>

Në fushën e Sportit:

1.	<i>Klubi Futbollistik "OPOJA"</i>
2.	<i>Shkolla e Futbollit "Aroma Sport"</i>
3.	<i>Shkolla e Futbollit "Dragash Sport"</i>
4.	<i>Klubi i Kuajve "OPOJA"</i>
5.	<i>Klubi i Shahut "Sharri"</i>
6.	<i>Klubi i Motoristëve "Enduro Sharri"</i>

Në fushën e Rinisë:

1.	<i>OJQ " Demokratska Omladina Gore "</i>
2.	<i>OJQ "AVOKO"</i>

Në kuadër të investimeve kapitale dhe në përmirësimin e kushteve dhe terreneve më të mira sportive, kemi investuar në stadiumin e qytetit të Dragashit, kur pritet që këtë vit të përfundojnë punimet. Komuna e Dragashit ka përfunduar punimet të cilat i ka pas në Memorandum Bashkëpunimi me Federatën. Po presim që pjesë tjetër ta kryejë edhe Federata. Po ashtu, kemi bërë edhe vendosjen e kontenierëve në stadiumin e qytetit të Dragashit. Përveç sektorit të Kulturës e të Rinisë, ne kemi edhe bibliotekat, Bibliotekën Qendrore "Ymridin Qengaj në Dragash" dhe bibliotekat tjera nëpër fshatra. Jemi munduar që në përpikmëri të kryejmë Planin e Punës dhe Rregulloren në bazë të bibliotekës. Në këtë vit, Biblioteka ka pranuar një donacion ngë CIMIC-u Italian, pajisje për zyrë, të cilët i falënderoj për mbështetjen ndaj nesh. Për shkak të rënies së numrit të lexuesve, si pasojë e emigracionit të popullatës, si në vendet tjera po ashtu edhe në Komunë të Dragashit, ne jemi munduar të stimulojmë lexuesit e rinj dhe kemi bërë heqjen e participimit për anëtarësimin e lexuesve.

Krahas realizimit të aktiviteteve të parapara me planin e punës, drejtoresha e DKRS ka pas një bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe shumë organizata të tjera ku janë dorëzuar edhe shumë kërkesa për mbështetje materiale në të gjithë sektorët duke përfshirë edhe bibliotekat, muzeun etnografik dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore e historike.

Dua të falënderoj në veçanti kryetarin e Komunës për mbështetjen e vazhdueshme, dua të falënderoj dhe t'i përsëndes të gjithë ata të cilët kontribuan në realizimin e të gjitha këtyre aktiviteteve, siç janë Policia e Kosovës, QKMF-ja dhe të gjithë të tjerët. Sa i përket Planit të Punës për vitin 2025, është pothuajse i ngjashëm me Raportin e Punës, për efekt të kohës nuk po e lexoj, por nëse doni...është i ngjashëm. Do të mundohemi me përpikmëri dhe përgjegjshmëri të plotë ta realizojmë edhe Planin e Punës dhe për këtë vit kalendarik. Ju faleminderit!

Redzep Ibraimi: E nderuara Kryesuese e Kuvendit, Zëvendës Kryesueses, I nderuar Kryetar, Të nderuar Delegatë.

Dëshiroj të paraqes raportin për punën e Drejtorisë së Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike për vitin fiskal 2024. Drejtoria jonë gjatë vitit të kaluar ka realizuar një sërë aktiviteteve që synojnë përmirësimin e kapaciteteve të reagimit ndaj emergjencave, mbrojtjen e qytetarëve dhe pronës, si dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Aktivitetet tona përfshinin një gamë të gjerë veprimesh, me theks të veçantë në mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin efikas të mbetjeve.

Aktivitetet e ndërmarra nga Drejtoria në vitin 2024 bazohen kryesisht në aktivitetet e planifikuara për vitin 2024, si dhe në rrethana dhe ngjarje të tjera gjatë vitit fiskal, bazuar në dokumentacionin përkatës për funksionimin e Drejtorisë, të gjitha me qëllim të punës efektive në fushën e mbrojtjes së jetës së njerëzve, të mirave materiale, pronës dhe mjedisit.

Drejtorja e zhvilloi veprimtarinë e saj në kuadër të angazhimit të strukturave që zotëron dhe të cilat bashkëpunojnë vazhdimisht në varësi të situatave me të cilat përballen në punën e përditshme.

Drejtorja është e përfshirë në punën e selisë komunale dhe komitetit për siguri në bashkësi dhe merr pjesë aktive në të gjitha diskutimet dhe analizat si dhe në aktivitetet e nevojshme në terren.

Komunikimi me KFOR-in ka vazhduar edhe për çështje të rëndësishme për sigurinë e komunës sonë, e cila është me rëndësi të madhe për sigurinë e qytetarëve të komunës së Dragashit.

Obligim i drejtorisë është edhe përcaktimi i dëmeve të shkaktuara nga faktorët natyrorë. Në këtë drejtim, komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve me kërkesë të palëve ka vizituar me kohë dhe me sukses vendin dhe ka përgatitur një raport për gjendjen aktuale. Gjatë këtij viti fiskal në komisionin e vlerësimit të dëmeve janë dorëzuar 261 kërkesa.

Të gjitha procedurat e brendshme në komunë janë realizuar me sukses dhe bashkëpunimi i drejtorisë me drejtoritë tjera ka qenë në përputhje me nevojat. Pas progresit të madh në vitin 2023, në fushën e menaxhimit të mbetjeve, si rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm të drejtorisë sonë me Agjencinë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar JICA, në vitin 2024 bashkia jonë përfundoi me sukses, siç ishte planifikuar, projektin trevjeçar “Projekti për Përmirësimin e Kapacitetit të Menaxhimit të Mbetjeve drejt një shoqërie të shëndetshme – Faza II”, me synimin

kryesor të bashkëpunimit në Japoni menaxhimi i mbeturinave të ngurta për komunat e vogla dhe të mesme (që përfshin komunën e Dragashit).

Zbatimi i projekteve trevjeçare u dakordua në një takim më 18 shkurt 2022 në mes të autoriteteve përkatëse, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, katër komunat e projektit dhe JICA.

Ky aktivitet është një tjetër kontribut i rëndësishëm i drejtorisë sonë për zgjidhjen e problemit të mbetjeve në territorin e komunës sonë. Gjegjësisht, para së gjithash me iniciativën e Drejtorisë është formuar grupi punues komunal, i cili së bashku me kompaninë "Ekoregion" në Dragash, në bashkëpunim me JICA, kanë marrë pjesë në realizimin e 4 pilot projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë, si dhe trajtimin e tij, dhe në këtë mënyrë Drejtorja ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga "Ekoregion".

Falë angazhimit tonë, komuna jonë ka pranuar edhe një projekt GGP nga Qeveria Japoneze përmes Ambasadës Japoneze në Prishtinë që ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në fshatin Restelicë përmes zbatimit të grumbullimit të mbeturinave në një mënyrë të zhvilluar gjatë zbatimit të pilot projekteve, që përfshin ndërtimin e një pike grumbullimi.

Po ashtu edhe komuna jonë në bashkëpunim me GIZ-in, "Ekoregionin" dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës është përfshirë në procesin e identifikimit të deponive ilegale (mbi 100 pika të zeza). Angazhimi i mëtejshëm është i nevojshëm për zgjidhjen e problemit të deponive ilegale në territorin e komunës sonë.

Kemi hartuar një rregullore të re për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Dragashit, në bashkëpunim me ekipin komunal, drejtorët e sektorëve tjerë komunal, si dhe me partnerët tanë nga Japonia, e cila do të jetë më funksionale dhe do të pasqyrojë gjendjen reale në terren dhe është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Dragashit dhe miratuar nga Ministria përkatëse.

Përmirësimi i kapaciteteve të zjarrfikësve

Një nga synimet kryesore gjatë vitit 2024 ishte forcimi i kapaciteteve të zjarrfikësve. Të gjithë zjarrfikësit i janë nënshtruar trajnimeve të detyrueshme për skenarë dhe lloje të ndryshme ndërhyrjesh, duke përfshirë shuarjen e zjarrit, shpëtimin e njerëzve dhe ofrimin e ndihmës së parë.

Pavarësisht sfidave të mungesës së personelit, njësia jonë ka demonstruar një nivel të lartë profesionalizmi dhe përkushtimi.

Sipas planit të trajnimit të përshkruar nga AME/MPB, zjarrfikësit tanë iu nënshtruan trajnimit që përfshinte simulime të situatave të jetës reale, gjë që i mundësoi ekipit të përmirësonte reagimin e tij në kushte krize.

Reagimi emergjent

Zjarrfikësit gjatë vitit 2024 ka pasur gjithsej 183 ndërhyrje, nga të cilat 103 kanë qenë të lidhura me zjarre në fusha dhe pyje. Përveç kësaj, njësia ka punuar në mënyrë aktive në masat parandaluese për të zvogëluar rrezikun e zjarrit dhe aksidenteve të tjera. Këto aktivitete përfshijnë informimin e qytetarëve, ligjërata dhe patrollime nëpër zonat e rrezikut.

Bashkëpunimi me shoqëritë e shërbimeve

Vazhduam bashkëpunimin me kompanitë "Ekoregion" dhe "Hidroregion" për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve, si dhe furnizimin me ujë dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujërave të zeza. Theks i veçantë u vu në zgjerimin e sistemit të grumbullimit të mbeturinave në të gjitha vendbanimet e komunës, zvogëlimin e numrit të deponive ilegale dhe ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e menaxhimit të përgjegjshëm të mbeturinave. Si përfundim, rezultate të rëndësishme janë arritur në fushën e përmirësimit të shërbimeve publike gjatë vitit 2024. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët ka mundësuar akses në burime dhe ekspertizë shtesë, duke çuar në zbatimin e projekteve kyçe që kanë përmirësuar infrastrukturën, sistemet e menaxhimit të mbetjeve dhe sigurimin social.

Konkluzioni

Në vitin e kaluar, Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike ka bërë përparim të dukshëm në të gjitha fushat kyçe të punës së saj. Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë të gjitha sistemet dhe shërbimet për ta bërë reagimin tonë ndaj emergjencave sa më të shpejtë dhe efikase.

Bazuar në rezultatet e arritura, ne do të vazhdojmë të realizojmë aktivitetet sipas planit të vitit 2025. Faleminderit për vëmendjen dhe mbështetjen tuaj në arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta.

Zeni Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Po paraqes para jush Raportin e Punës së DKAs-së për vitin 2024:

Drejtoria për Arsim në vitin 2024 ka realizuar aktivitetet e veta në kuadër të dinamikës dhe vëllimit të punës të përfshira në planin e veprimit për këtë vit. Realizimi i detyrave të punës është bërë në harmoni të plotë me Statutin e Kuvendit Komunal, Ligjin për arsimin para universitar të Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 dhe Udhëzimeve Administrative të nxjerra nga MASHT-i.

Në komunën tonë funksionale janë 36 objekte shkollore dhe atë:

<i>Shkolla AMË</i>	<i>Shkolla Paralele të ndara</i>	<i>SHML – Mesme e lartë</i>
<i>12</i>	<i>23</i>	<i>1</i>

Të gjitha këto shkolla janë në kuadër të arsimit publik ngase në territorin e komunës së Dragashit nuk funksionon asnjë shkollë private.

Vlen të theksohet se kanë përfunduar punimet e Çerdhes në Dragash dhe pritet të funksionalizohet, procedurat e rekrutimit të dy edukatoreve kane përfunduar .

Procesi arsimor është i organizuar në këto nivele:

- 1. QBK- Qendër me bazë në Komunitet, mosha 3-5*
- 2. Arsim para fillor - organizohet me qëllim të përgatitjes së fëmijëve për vazhdimin e shkollës fillore dhe funksionon në kuadër të objekteve të shkollave fillore, mosha 5-6 vjeç*
- 3. Arsim fillor – në kuadër të këtij niveli përfshihen klasat 1-5 gjegjësisht moshat 6 deri në 10 vjeç*
- 4. Arsimi i mesëm i ulët - përfshin klasat 6-9 gjegjësisht moshat, 11 deri në 14 vjeç*
- 5. Arsimi i mesëm i lartë - është i organizuar në:*
 - Arsimin e përgjithshëm (gjimnaz),*
 - Arsimin profesional.*

Kohëzgjatja e këtij niveli është 3 vjet varësisht nga profilet arsimore të përcaktuara nga MASHT-i dhe përfshin moshat prej 15 deri në 17 vjeç.

Në Drejtorinë për Arsim punojnë 6 punëtorë përfshirë edhe drejtorin e drejtorisë, kurse në të gjitha nivelet arsimore janë të angazhuar 446 punëtorë nga të dy komunitetet. Në këtë vit shkollor numri i nxënësve në institucionet edukative-arsimore të komunës së Dragashit është **2933**.

- QBK (Qendra me bazë në komunitet) **86 nxënës**,

- arsimin parafillor **231** nxënës,

- fillor **2213** nxënës

- të mesëm **403** nxënës.

Vitin shkollor **2023/24** e kanë ndjekur **2933** nxënës, të grupuar në **23** paralele, të shpërndarë në:

6. **12** Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta;
7. **23** Paralele të ndara të Shkollave Fillore;
8. **1** Shkollë të Mesme të Lartë (Mikse);

Gjatë punës një vjeçare janë punuar **1163** lëndë administrative të cilat janë paraqitur sipas kërkesave e nevojave të shkollave, punëtorëve dhe organeve komunale.

- Vendime për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonje,
- Vendim për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Kërkesa, përgjigje, ankesa, pëlqime etj....

Janë realizuar aktivitete kulturo-artistike me rastin e shënimit të ditëve të shkollave.

Drejtoria e Arsimit ka bërë mbikëqyrjen e procesit edukativo-arsimor, mbikëqyrje e cila është duke u realizuar në vazhdimësi nga drejtori dhe zyrtarët komunal të arsimit;

Sipas dinamikës së planifikuar, drejtori së bashku me zyrtarë kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e arsimit, përkatësisht në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe në shkollën fillore të mesme të lartë në komunën e Dragashit. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të

ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Dragashit, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë këtyre muajve, kanë realizuar vizita speciale dhe kontrolluese në institucionet arsimore.

- Është bërë kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHT me qëllim të publikimit të konkursit për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë, në SHML (Shkollën e Mesme të Lartë) dhe përcjelljen e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollën e mesme të lartë.

- Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasave parafillore dhe parashkollore.

- Përgatitja për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.

- Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të lira të punës, mësimdhënës, punëtorë teknik, formimi i komisionit për rekrutim, vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit arsimor në bazë të konkursit të rregullt sipas UA (udhëzimit administrativ). Si dhe janë shpallur edhe konkurse tjera plotësuese,

- Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditarë pune, librat të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor.

- Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve të maturantëve dhe semimaturantëve.

- Furnizimi i të gjitha shkollave me lëndë djegëse dhe materialeve tjera.

- Përgatitja e raportit për suksesin dhe rezultatet e nxënësve të arritura në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/24.

*- Është marrë raporti nga SMIA **për gjendjen fizike të shkollave**, shkollat e pajisura me kamera, rrethoja, laborator, biblioteka, klasa të zakonshme, klasa të pajisura me mjete elektronike; projektor, tabela*

- numrin e të punësuarve në IA në dy komunitete

- Është mbajtur olimpiada e Fizikës dhe olimpiada e Matematikës për 2024.

Testi i Arritshmërisë për vitin 2024

Gjithsej **241** semimaturant të planifikuar nga 11 shkolla fillore, 7 shkolla Shqipe dhe 4 shkolla të komunitetit boshnjak.

Testit iu nënshtruan **233** nxënës. Organizimi i këtij testi është bërë një qendër testimi: në SHML “Ruzhdi Berisha” - Dragash, në dy pjesë :

Pjesa e parë u mbajt me datë: 25.06.2024 dhe pjesa e dytë u mbajt me datë:28.06.2024 në qendrën e njëjtë në SHML” Ruzhdi Berisha “ me gjithsej 18 paralele, 16 në gjuhën shqipe dhe 2 në gjuhën boshnjake.

Prezent kanë qenë organet e sigurisë, mjeku kujdestar, komisionerët nga MASHT: Leotrim Kika dhe Blerim Dalipi dhe stafi nga DKA.

22 Administrues të komunës tonë

Transporti i nxënësve është siguruar nga DKA

Niveli i përgjithshëm i arritshmërisë

Shkolla	Nr i nxënësve që iu nënshtrua testit të arritshmërisë	M	F	% e arritshmërisë	M%	F%
SHML “ Ruzhdi Berisha “ dhe në SHFMU “Fetah Sylejmani”-	233	106	127	56.24 %	45.49 %	54.50 %

Këtu kemi edhe nivelin e arritshmërisë për secilën shkollë, por unë nuk do ‘i lexoj për hir të kohës. Këtë do ta kalojmë.

Matura Shtetërore për vitin 2024

U organizua në SHML “Ruzhdi Berisha”, me gjithsej **129** maturantë. Administrimin e testit e kanë bërë mësime dhënësit e komunës së Prizrenit. Në klasa kanë qenë deri në 15 nxënës për klasë. DKA-ja i ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme teknike me përpikëri. Testi ka filluar dhe ka përfunduar me kohë dhe nuk ka pasur asnjë problem. Përqindja e kalueshmërisë

- Numri i nxënësve që mbaruan klasën e 12-të 129 nxënës
- Nxënësit që e kaluan pragun e kalueshmërisë 79 gjithsej 61.24%
- Nr i nxënësve femra 79 me 53.16 kalueshmëri
- Nr. i nxënësve meshkuj 37 me 46.83
- 12 shkollat kanë dorëzuar raportet dy herë në vit.
- Për këtë vit nuk kemi braktisje të shkollës nga nxënësit.
- Orët e planifikuara për këtë vit shkollor kanë qenë **188328, gjithësej u realizuan, mbajtën 182865 orë mësimore**
- Kemi pas tri kërkesa për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të cilat kemi arrite për herë të parë ti realizojmë brenda afatit ligjor bashkë me Ekipin për Vlerësim Pedagogjik të fëmijëve me nevojë si dhe ekspertë të jashtëm.
- Këtë vit shkollor kemi një nxënës me N.V.A, në klasën e12 -të.
- Kemi kërkesa nga prindërit për pranim të Asistentëve me nevoja të veçanta arsimore në Blaç dhe Kuk.

Me datë: 30.05.2024 është mbajt testi TIMSS, në SHFMU"Ilmi Bahtijari"- Blaç, me nxënës të klasës së V-2.

Me kërkesë të Policisë së Kosovës - Dragash, janë mbajtur ligjërata, për masat dhe sigurimin e një ambienti të sigurt në shkollat e komunës së Dragashit dhe dokumentarë për vetëdijesim mbi rreziqet e lëndëve narkotike dhe pasojat shëndetësore, shoqërore dhe ligjore" dhe "Ruajtja e Ambientit dhe Trashëgimisë Kulturore".

Nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Departamenti i Drejtësisë, Atasheu i Programit Ndërkombëtarë për Asistencë në Trajnime për hetime Penale- ICITAP, znj. Kimberly Riffe mbajti një Ligjëratë me nxënës të klasave:10,11,12. Tema e Ligjëratës ishte" Shantazhimi i nxënësve". Ligjëratu u mbajt me datë:19.04.2024 në SHML "Ruzhdi Berisha" – Dragash, në orën 11:00 në Shqip dhe Boshnjakisht.

Gjithashtu vazhdon bashkëpunim i mirëfilltë me organizata të ndryshme siç janë: UNICEF, Cartiasin Zvicërran, Ambasada Amerikane, JICA si dhe CIMIC-u Italian, Avoko, ECMI dhe Kfori turk.

- Me UNICEFIN ka vazhduar Qendra me Bazë në Komunitet në fshatin Brodosanë, me dy paralele me fëmijë të moshës 3-5 vjeç. Gjithashtu janë angazhuar 3 edukatore, me këtë grup moshë me pagesë deri me 31.12.2024, e më pas bazuar ne marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të kryetarit të komunës, të njëjtat edukatore do të sistemohen si edukatore nëpër shkollat e Dragashit.

Kemi bërë Draft Planin Komunal të Veprimit për EPRBM i cili është përgatit nga Ekipi Komunal për PRBM në bashkëpunim me MASHT, UNICEF, ECMI.

Drejtoria e Arsimit në Dragash po ashtu ka ndarë edhe bursa për studentet të Komunës së Dragashit, 112 bursa studentore.

Në këtë vit janë punësuar 35 punëtor, mësimdhënës, punëtor teknik.

Drejtoria e Arsimit i ka plotësuar këto vende duke i zhvilluar procedurat e rekrutimit duke u bazuar në Ligjet dhe Udhëzimet Administrative që e rregullojnë këtë fushë.

Pjesëmarrja e zyrtarëve për arsim gjithëpërfshirës në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian\ Këshilli i Evropës “Ndërtimi i Kapaciteteve për përfshirjen në Arsim” – INCLUDE, si dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga MASHT-i

SFIDAT PËR VITIN 2024

1. Zëvendësimi i personelit arsimor (procedurat e stërzgjatura), problemet e pagesës
2. Rënia e numrit të nxënësve (rënia e numrit të orëve).
3. Problem i pagesës së shujtave (përmbaruesi)
4. Problem i pagesës së licencës së mësimdhënësve (përmbaruesi)
5. Kërkesat për pushim pa pagesë për mësimdhënës
6. Sistemi paralel.
7. Aktivizimi i Ekipit për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
8. Trajnimi i mësimdhënësve i cili është kusht për Licencë të mësimdhënies

REKOMANDIMET

- Dezinfektimi i shkollave për nxënësit etj.
- Angazhimi i drejtoreve të shkollave për përgatitjet rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025.

Nr.	Investimet kapitale dhe mirëmbajtja
1	Mirëmbajtja e shkollës fillore në fshatin Buqe
2	Meremetimi i oborrit të shkollës në fshatin Xërxe
3	Ndërtimi i dyshemes dhe blerja e paisjeve për sallën e fiskullturës në shkollën “28 Nëntori” në fshatin Bresanë
4	Renovimi i shkollës fillore në fshatin Restelicë (projekt dy vjeçar)
5	Ndërtimi i dyshemes dhe blerja e paisjeve për sallën e fiskullturës në shkollën “28 Nëntori” në fshatin Bresanë (FAZA-2)

6	<i>Mirëmbajtja e shkollës së vjetër në fshatin Bresanë</i>
7	<i>Mirëmbajtja dhe renovimi i çerdhes së fëmijëve në Dragash</i>
8	<i>Instalimi i rrymës për nxemjen qendrore në shkollën “ULINA” në fshatin Kosavë</i>
9	<i>Mirëmbajtja e katër klasave të shkollës së vjetër në shkollën “28 Nëntori” në fshatin Bresane (projekt dy vjeçar)</i>
10	<i>Renovimi i shkollës SHFMU “Ilmi Bahtijari” në fshatin Blaç</i>
11	<i>Mirëmbajtja dhe rregullimi i oborrit të shkollës “Shaban Shabani” - Llopushnik</i>
12	<i>Mirëmbajtja e shkollës “28 Nëntori” - Bresanë</i>
13	<i>Ndërtimi i tereneve sportive në shkollat fillore në Krushev, Zlipotok, Glloboqic (projekt dy vjeçar)</i>
14	<i>Ndërtimi i rrugës dhe oborrit të shkollës fillore “Ulina” në Kosavë</i>

Nr.	Furnizimet
1	<i>Furnizimi me material teknik për mirëmbajtjen e shkollave në Komunën e Dragashit</i>
2	<i>Furnizim me pelet për nevojat e K.K. Dragash (projekt 3 vjeçar – 2024/2025/2026)</i>
3	<i>Furnizimi me gjenerator trofazik 10kË (dizel) në shkollën fillore “Shaban Shabani” - Llopushnik</i>
4	<i>Furnizimi me pompë të ujit në shkollën fillore “Ilmi Bahtijari” Blaç – paralelja e ndarë në Zgatar</i>
5	<i>Furnizimi me kalldaj për ngrohje qendrore në SHFMU “Fetah Sylejmani” në Dragash (projekt dy vjeçar)</i>
6	<i>Furnizimi me material dhe ndarja e një klase në SHFMU “Fetah Sylejmani” Dragash</i>

Nr.	Transporti i nxënësve
1	<i>Transporti i nxënësve për vitin shkollor 2024-2025 Dragash-Restelicë dhe anasjelltas</i>
2	<i>Transporti i nxënësve për vitin shkollor 2024-2025 Dragash-Prizren dhe anasjelltas (Gjimnaz-Dragash=Spital-Prizren)</i>

3	<i>LOT1 - Zaplluxhe - Dragash</i>
4	<i>LOT2 - Bresanë - Dragash</i>
5	<i>LOT3 – Brezne - Dragash</i>
6	<i>LOT 1 – Rrenc (te lapidari) - Dragash</i>
7	<i>LOT 2 – Plavë (te qendra në Pllavë, në Krevecic dhe te kthesa e bathishtes)- Llopushnik</i>
8	<i>LOT 3 - Pllajnik - Kosavë</i>
9	<i>LOT 4 – Xërxe - Dragash</i>
10	<i>LOT 6 – Zym-Bellobrad</i>
11	<i>LOT 7 – Kapre (te xhamia)- Bellobrad</i>
12	<i>LOT 8 – Brrut (te shkolla dhe loma Spahisë)- Bellobrad</i>
13	<i>LOT 9 – Brezne (loma Porkaqit, te shkolla, te trafa, te dan udhet dhe të honi)- Llopushnik</i>
14	<i>LOT 10 - Zgatar- Blaç (te varezat dhe udhekryqi)</i>
15	<i>LOT 11 – Zaplluxhe (te marketi “CAPI” dhe te kryqi) - Blaç</i>
16	<i>LOT12 – Buçe (te xhamia, te shkolla dhe udha e Pllavës)-Llopushnik</i>
17	<i>LOT 5 – Buzez-Bresanë (te xhamia dhe te kthesa e Kukit)</i>
18	<i>Transportimi i nxënësve të shkollave fillore (vizitë monumenteve historike nëpër Kosovë)</i>

ÇËSHTJE TJERA

DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.

Ky ishte Raporti i Punës për vitin 2024. Kemi pas edhe shumë e shumë aktivitete, por për mos me e bo shumë voluminoz këtë raport, besoj që këto janë ato që i kemi krye. Kurse, sa i përket Plani të Punës, kryetar, nëse më lejon mundem t’i lexoj, po kryesisht ky ka të bëjë me këto që i

përmendëm, mirëpo këto i kemi paraqit në formë tabelare, ju i keni. Pra, koha kur do të realizohet, në cilin muaj, dhe kush do të jetë implementues, DKA-ja, MASHTI etj. Duke filluar prej analizës së suksesit në fillim të vitit shkollor, e deri te bashkëpunimi me të gjitha institucionet tjera. Ju falënderoj për vëmendjen!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Pas raporteve dhe planeve të punës të kryetarit dhe disa drejtorëve që ishin këtu, atëherë e hapi diskutimin për ju asambleistë. Kush do me e marrë fjalën?

Afrore Vejseli: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Është hera e tretë që e bëj të njëjtën pyetje dhe asnjëherë nuk kam marrë përgjigje. I nderuar kryetar dhe ju drejtor i DKA-së, pyetja ime ka qenë: Çka po ndodh me çerdhen, nënkuptohet, kur do të funksionalizohet? Në Raportin tuaj për vitin 2024, e theksoni se kanë përfunduar punimet e çerdhes në Sharr dhe pritet të funksionalizohet. Po ashtu, kanë përfunduar edhe procedurat e rekrutimit të dy edukatoreve. Me dy muaj e gjysmë vonesë, keni filluar të ashtuquajturën Qendër me Bazë në Komunitet, me qëndrim tri orësh, në mungesë të çerdhes. Më pas, në tetor të vitit të kaluar, pra 2024, në mënyrë publike keni gënjyer se do të hapet, por nuk ndodhi. Tash, Qendra me Bazë në Komunitet me qëndrim tri orësh, është kthyer në 1 orë e 30 minuta. Kjo ka qenë kërkesë e edukatores, arsyeja ka qenë numri i madh i fëmijëve dhe mosmundësia e menaxhimit. Z.Kryetar, krejt gjërat fillojnë duke u zhvilluar, ju po shkoni mbrapshtë. Kjo s'ka logjikë. Si është e mundur që edukatorët janë të punësuar dhe nuk e bëjnë punën e tyre? Të paktën të kthehet qëndrimi triorësh që ka qenë më herët. Nëse deri sot kam folur si asambleiste, sot po ju flas edhe si prind. Ju lutem, dua ta marr një përgjigje, edhe një shpjegim t'u jepet qytetarëve dhe atyre prindërve që fëmijët e tyre nuk e meritojnë këtë që po ju bëni. Ju faleminderit!

Munir Jonuzi: Kam disa pyetje për pushtetin ekzekutiv. Për Drejtorinë e Administratës: thotë shërbimet e ujësjellësit, më intereson se si lidhen këto shërbime të ujësjellësit me Drejtorinë e Administratës. Faqe 3, ju thoni se janë lëshuar një numër i konsiderueshëm dokumentesh, nga 40.000 në 45.000, por nëse shikojmë tabelën kemi vetëm 31.300 dokumente që janë lëshuar në vitin 2024, cila nga këto të dhëna është e saktë? Në faqen nr. 5, numri i të ardhurave është ulur, vitin e kaluar 39,000 dhe tani rreth 36,000. Sa i përket zyrës së pritjes, thotë se është bërë një renovim i plotë e zyrës, mendoj se është bërë në vitin 2023. Më tej thotë se gjatë vitit 2023 kanë grumbulluar rreth 17 mijë euro, të dhëna këto janë të njëjta si në raportin e vitit 2023. Mua më intereson se sa të ardhura fitohen realisht nga taksat komunale. Ju thoni se po përballeni me

mungesë të stafit në zyrën e prokurimit publik, a keni bërë ndonjë kërkesë në ministrinë kompetente për rritjen e numrit të të punësuarve në atë zyrë? Faqe 8, prokurimi i skanerëve në zyrën e pritjes, njësoj si në vitin 2023, njësoj si këtë vit, nëse janë blerë një apo dy skanerë. Në planin e punës ju përmendni një printer multifunksional, e njëjta gjë ka qenë edhe për vitin 2024, a është instaluar fare ai printer dhe ku do të vendoset që qytetarët tanë të dinë ta përdorin. Një sugjerim, automjetet tuaja zyrtare nuk kanë shenja dhe tabela dhe disa prej tyre kanë rënë, si për shembull Passat 387, po mendoni të futni GPS dhe kjo varet gjithmonë nga burimet financiare, ju lutemi ta bëni këtë dhe të dini se ku janë drejtorët dhe punonjësit tuaj sepse këto automjete përdoren shpesh dhe kalojnë kufijtë e vendit tonë. E njëjta gjë vlen edhe për vendosjen e kamerave vëzhguese, i njëjti projekt po përsëritet. Drejtoria e Financës, nga ana tjetër, aplikimi për programin L për projektet IPA, nëse keni aplikuar atje, më intereson sa janë gjasat që ne të përfshihemi në këtë projekt IPA. Faqe 3, ju thoni se keni bërë diskutime publike nëpër fshatra, nuk më kujtohet që kemi shkuar nëpër fshatra, mendoj se vizita të tilla nëpër fshatra nuk janë bërë. Ulja e taksave është e dukshme, vetëm 53% deri tani, shpresoj që në vitin 2025 të ketë një mbledhje më të lartë. Nuk e keni përfshirë ExpoSharrin në planin tuaj, nuk ka asnjë pjesëmarrje në AgroKoss. Në bujqësi thotë që programi i granteve nuk është zbatuar, pra çfarë do të ndodhë në vitin 2025 ka një fjali që thotë, në 6 muajt e fundit kemi pasur rritje, pse nuk ka pasur rritje gjatë gjithë vitit? Në faqen 8 thuhet se problemet kanë mbetur të njëjta si vitin e kaluar dhe një vit më parë, ndaj pse nuk po zgjidhen këto probleme nëse janë identifikuar? Ne kemi subvencione për fermerët, a ka mundësi që këto subvencione të rriten, nga 30 në 35, p.sh. është rritur edhe çmimi i ushqimit të kafshëve. Nga 363 fermerë aktivë, vetëm 275 fermerë aplikuan për përfitime nga Granti. Cila është arsyeja pse të tjerët nuk kanë aplikuar për subvencione? Nuk kemi asnjë aktivitet për sektorin e pylltarisë. Në material thuhet se do të vizitojnë ambasadat, më intereson se cilat ambasada kanë vizituar anëtarët e drejtorisë. Sa i përket objektivave, nuk kanë asnjë synim apo plan në sektorin e pylltarisë, shpyllëzimi, mbrojtjen e pyjeve etj. Unë mendoj se dokumenti është shkruar në mënyrë të pamjaftueshme. Kultura dhe Rinia, në faqen 6 thua se është organizuar një ngjarje kulturore në fshatin Brod nga OJQ Zaeno za Brod dhe OJQ Rinia Demokratike e Gorës, ke shkruar sa është paguar për OJQ Rinia Demokratike e Gorës, më intereson sa është paguar për OJQ Zaeno za Brod. Mirënjohje drejtoreshes që punoi për të inkurajuar lexuesit e rinj dhe për heqjen e tarifës së pjesëmarrjes për të gjithë anëtarët e bibliotekës. Kjo është një gjë e mirë sepse nëse krahasojmë të dhënat me vitin e kaluar, vërehet se numri i përdoruesve të bibliotekës këtë vit është 287 dhe vitin

e kaluar 687, që është 70% më pak. Tani kemi një fond librash prej 59.794 librash dhe vitin e kaluar kemi pasur 65.760, jam kurioz ku shkuan ato 5.000 libra. Sa i përket planit të punës, këtu nuk shoh askund që të organizohet një ditë gorane apo një ditë boshnjake. Kemi një ditë ndërkombëtare të sportit që do ta organizojë kjo drejtori, por nuk kemi as ditën e goranëve e as të boshnjakëve. Kryetar, ju thatë në kuvendin e kaluar se unë po krijoj përçarje në mes të komuniteteve, jo unë por anëtarët e qeverisë suaj. Kemi 47 ngjarje të tjera. Mua më intereson nëse Trokani ka marrë rrymë, a funksionojnë peshoret që u vendosën dy vite më parë dhe në këtë raport ju deklaroni se mbi 100 pika të zeza janë deponi ilegale, më intereson se si është e mundur të pakësohen të gjitha këto pika të zeza. Prej disa vitesh lexoj raporte se janë 8 zjarrfikës më pak, kur do ta zgjidhim përfundimisht atë problem? Çfarë duhet bërë për t'i punësuar ata? Ju thoni se keni punuar për të parandaluar zjarrvënien e qëllimshme, si? Ju thoni se zonat që po monitorohen me kujdes, Plavë, Buqe, Brezne, kanë qenë ato ku ka rënë zjarr në përmasa të mëdha. Ju thoni se duhet të blini makineri, është mirë që ta bëni këtë nëse e përfshini në buxhetin e vitit të ardhshëm. Sa i përket investimeve kapitale, ju thoni, ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Kukuljanë, 18430, kontrata është lidhur para dy vitesh për 48430 euro, kemi shtuar edhe 14.000 të tjera nga fondet e pashpenzuara dhe 14.000 të tjera nga viti 2023, në bazë të Vendimit, dalim në përfundim se duheshin vetëm 2,000 uro. Po 28 mijë eurot e mbetura? Në faqen 12 ju thoni që të gjitha fshatrat duhet të përfshihen në sistemin e grumbullimit të mbetjeve, a ka një plan se si të përfshihen të gjitha fshatrat? Sa i përket planit, më intereson kush vendos për punësimin e zjarrfikësve, komuna apo niveli më i lartë. A kemi nevojë për leje për të shpallur një konkurs? Faqe 3, bashkëpunimi me KEK-un, Kesco-n, etj., ju lutemi të krijoni këtë bashkëpunim që qytetarët tanë të marrin energji elektrike pa asnjë problem. Ju thoni që duhet të siguroni një automjet që do të kontrollohet nga drejtoria juaj, ky është i njëjti synim prej tre vitesh. Shpresoj se do ta realizoni. Për mirëmbajtjen e rrugëve verore dhe dimërore shpresoj të punësohen punëtorë shtesë dhe jo vetëm në rrugët kryesore. Në Urbanizëm kemi faqen e parë ku shkruhet kush dhe kur, kemi dy zotërinj dhe dy nuk e di si deklarohen, për mendimin tim ky është një mbishkrim autoshovinist. Sa i përket investimeve kapitale, shohim se është realizuar pothuajse gjithçka, përveç asfaltimit të rrugës dhe kanalizimit në fshatin Zlipotok të Jarelicës, drejtori thotë se mjetet janë tërhequr me vendim të Gjykatës dhe përmbaruesit privat. Dhe kemi një projekt tjetër që është realizuar pjesërisht në fshatin Radeshë për shkak të kushteve atmosferike. Nëse projektet do të shpallehin në kohë dhe jo në nëntor, nuk do të ishim në këtë situatë. Se ky është një raport copy-paste vërtetohet me këtë fjali - Detajet e

plota për realizimin e buxhetit të vitit 2024 në programin e Investimeve Kapitale do të paraqiten në raportin financiar për periudhën janar-dhjetor 2024. Në bazë të kësaj fjalie, konstatojmë se ende nuk kemi marrë raportin financiar dhe të gjithë e dimë se raportin financiar vjetor e kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar. Kjo është dërguar më 18/02 dhe ne e kemi pasur kuvendin më 10/02. Objektivat e vitit 2025 thonë se projektet e investimeve kapitale do të realizohen në kohë, po, vetëm nëse fillojmë ta shkruajmë projektin tani. Po ashtu kemi një plan për hartimin e një Rregulloreje për punën efikase të drejtorisë, e cila duhet të hartohet nga AKK-ja. Shpresoj që AKK-ja ta hartojë atë Rregullore sa më shpejt që të jetë e mundur. Drejtoria e Shëndetësisë thotë se kemi rritje të mjekëve, por e mohon këtë, kemi vetëm 14 mjekë dhe vitin e kaluar kemi pasur 16. Kur shikoj këtë faqe, nuk mund të mos pyes veten se si është situata me Covid. Gjatë vitit 2024 (janar-dhjetor) janë kryer 26.483 ndërhyrje (vaksinime), nga të cilat 4.437 janë vaksinime të rregullta, 1.374 janë vakcina kundër gripit sezonal dhe 20.672 janë vakcina kundër COVID-19. Pra, unë pyes President, si është situata, këto janë shifra serioze, kjo do të thotë se çdo qytetar merr një vaksinë në dorën e djathtë dhe të majtë? Kemi një rënie të shërbimeve në të gjithë sektorët. Nga 88,000 shërbime tani 62,000. Shtëpi e sigurt për gra dhe fëmijë në Prizren, i kemi sponsorizuar sërish me 1200 euro, atë informacion nuk e kam gjetur në raportin financiar. Shuma e tarifave për shërbimet e ofruara nga SCR në 2023 ishte 495 euro, më intereson sa ka qenë në 2024. Është normale që disa aktivitete të përsëriten, por këtu kemi gjëra që kanë të bëjnë me investime kapitale dhe të cilat vazhdimisht përsëriten si aktivitete të kësaj drejtorie. Për shembull, ne patëm të njëjtin rinovim dhe instalim të dyshemeve në CSR në 2023. Projekti për përkrahje të komunitetit, ndërtimi i shtëpive për banim social i implementuar nga MPMS. Kam vizituar faqen e tyre, njoftimi i fundit i tyre ka qenë nga marsi i vitit 2022, që nga ardhja e Albin Kurtit, kjo ministri nuk ekziston. Thotë sërish se puna për kopshtin ka përfunduar. Çfarë aktivitete planifikoni për Javën e Gjelbër në shkollë?

Bexhet Xheladini: Sa u përket pyetjeve që i ka bërë zv/kryesuesi, edhe dje në mbledhjen e KPF-së i ka bërë dhjetë pyetje, unë nuk kam qenë në gjendje me iu përgjigj për shkak të kohës, i kam kërkuar që t'i drejtojë këto pyetje me shkrim – m'i ka dërgue, unë i kam, tash i kam ato përgjigje. Unë e kisha lut Munirin – se ky përveç që ka bërë pyetje, ka bërë edhe analizë, ka bërë edhe propozime, konstatime – kështu që, mirë është që z.Munir t'i bëjë këto pyetje me shkrim, në mënyrë që në seancën e ardhshme me mujt me iu përgjigj. Sot është pak problem me iu përgjigj të gjitha këtyre, sigurisht mbi 100 pyetje i keni bërë. Iu propozoj drejtorëve që mos të dalin me iu

përgjigj sot këtyre pyetjeve, por t'i kërkojmë me shkrim të gjitha pyetjet që i ka bërë – këtë na e lejon edhe Rregullorja e Punës – dhe pastaj ne do t'u përgjigjemi në Asamblenë e ardhshme të gjitha pyetjeve që i ka bërë. Faleminderit!

Artan Loshaj: E dëgjova pak, kryetar, fjalimin tënd – se kesh i zonët – edhe thaje që në një vendim për lejimin e mjeteve financiare për Tv Prizrenin dhe Tv Opojën. Po më intereson arsyeja e pagesës edhe shuma sa ka qenë pagesa e Tv Prizrenit dhe Tv Opojës. Tv Prizreni e di që nuk është nga Komuna jonë, ndërsa Tv Opoja – unë sa e di, se s'kam personale kurgjo me ta – unë e di që nuk ka liçencë, edhe s'di a e ke pague si media apo si produksion. Pyetja e dytë – mos të dal në eventuale edhe një herë, masi është për Tv Opojën – seancën e parë të kam pyet, pse me 18 dhjetor pjesa e dytë e seancës, edhe pse ka qenë live, nuk figuron në rrjete sociale. Më ke premtue publikisht këtu që do të bisedosh me ta edhe do të na japësh një informacion. Dje në Komitet më ke thënë kam bisedue, do të dalë së shpejti në rrjetet sociale. Deri në këtë moment nuk ka qenë – nashta edhe janë këta këtu, me e kqyrë si është puna, a ka mundësi me qenë në rrjete sociale. Po vazhdojmë me Planin e Punës, drjetorin e famshën – superdrejtorin e Shëndetësisë s'po e shoh këtu, atë që e kam marak unë me e ditë. Kjo është një neglizhencë e tij ndaj juve, kryetar, se ke premtue dje që do të jenë krejt drejtorët këtu. Edhe neglizhencë ndaj delegatëve, ndaj përfaqësuesve të popullit dhe ndaj të gjithë qytetarëve. Kjo dihet për arsye pse: sepse ai nuk di, qaq ka aftësi. Edhe e dyta është që, bashkë me drejtorin e Urbanizmit, i kanë projektet – se ju kam thënë edhe ma herët unë, ai nuk merret me shëndetësinë. Krejt sendet i ka, drejtor i Shëndetësisë nuk është. Ai tash e ka vitin e zgjedhjeve, ai me drejtorin e Urbanizmit shkon bën projekte të kanalizimit, të ujësjellësit, të rrugëve. Është e pakapshme, por prapë unë po due me t'i bo do pyetje. Është mirë me m'dhënë përgjigje, në qoftë se jo, në seancën tjetër besoj që drejtori na jep. Deshta me u kyç me Munirin, edhe unë jam punëtor i shëndetësisë, ofrimi i shërbimeve – te aktivitetet – 5 mijë pacient me testim serologjik, edhe 2 mijë me testime të shpejta. Me siguri ky këtë raport, ka qenë i zënë edhe e ka pru të 2019-tës ose të 2020-tës. Se unë nuk po e di që ka Covid qetash edhe me i pas 7 mijë teste. Në rregull jemi. E dyta, është ma poshtë – gjatë vitit 2024 janë kryer 26 mijë vizita, veç e tha, mos ta përsëriti, janë krye 20 mijë vaksina kundër Covid-19. S'po e kuptoj. Po 2 mijë, hajt një zero, se ai me shifra e ka marak me lujt te urbanizmi, po shumë është kjo. Afër 21 mijë vaksina kundër Covid-it. Nuk e kam të kjtartë, kryetar. Në pjesën tjetër ka shkruar që gjatë vitit 2024, përmes kësaj OJQ-së Human Care, oftamologu ka pas 627 vizita – po më vjen shumë mirë – neuropsikiatri 555; internisti 834. Të falënderoj, kryetar, në emër të qytetarëve, se

jam punëtor aty, ka pas bajagi vizita. Gjinekologia ka pas 2257 vizita. Pse nuk figuron puna e Repartit të Pediatriisë? Pediatri deri muajin e parë ka qenë punëtor i QKMF-së. Unë e di që ai ka pas mbi 3 mijë vizita. Pse nuk figuron në këtë listë puna e Repartit të Pediatriisë? Shkojmë më posht. Një tabelë që është zyrtare. Tabela e parë: QKMF Dragash gjithsej vizita ka pas 20324; Emergjencia ka pas 20571; Stomatologjia ka pas 5477. Në qoftë se figuron këtu, atëherë... mu po më intereson kështu, se është e juaja, kryetar, se ju thoni e manipuloni qytetarin, po jo. Është ky raporti i juve edhe i punës suaj. Këtu thotë që në Emergjencë ka 20571 vizita, ka vetëm 3328 infuzione dhe 3780 injeksione. Është shumë pak, në krahasim me QMF-në e Brodosanës që i ka – me statistikën e juaja, prapë po të them – 919 vizita, ndërsa ka 7974 infuzione dhe 5280 injeksione. Mu po më intereson në QMF-në e Bresanës – e di që i keni dy stomatologë, e di që ma herët ka punë njëri paradite e njëri masdite, tash punojnë të dytë me një zyrë – nuk ka asnjë shërbim për vitin 2024. Dy stomatologë me asnjë shërbim ndaj qytetarëve. Shkojmë në QMF – Bresanë, Laboratoria, asnjë shërbim ndaj qytetarëve për vitin 2024. Kjo është statistikë e juaja. Asnjë shërbim. Nuk e kam të kurtë, pse ndodh kjo? Shkojmë te Plani i Punës, është copy-paste, është shumë i varfër, as një faqe e gjysmë. Veç i kam rrit pak shkronjat, prej 14 i kam bo 18, për me ju dalë dy faqe. Në Planin e Punës nuk e vërejtta unë që drejtori yt – katër vite me ne dhe tri vite me ju, shtatë vite – nuk e brengos brenga e qytetarëve se pediatër nuk keni. Mbi 3000-4000 vizita në vit i ka bo shërbim qytetarëve, këtë vit nuk ka pediatër. Gojën plot e keni pas me gjinekologin, ka qenë deri sot – shkova me e përshëndet, se sot e ka krye – edhe ajo ju shkoi. E di që më thoni menjëherë e kemi gjinekologin – e respektojmë shumë, ka dhënë shumë kontribut Dr.Femija – është i moshuar. Unë po kërkoj një plan afatgjatë për Repartin e Pediatriisë edhe Repartin e Gjinekologjisë, si do të bëni zgjidhje. Ky drejtori yt nuk mund me bo zgjidhje, kryetar. Se qaq e ka aftësinë edhe nuk merret me këto. Masi jam këtu, për të dy këta doktorët unë duhet me e shpreh një falënderim personal, në emër të punëtorëve dhe në emër të të gjithë pacientëve, që e kanë krye një shërbim shumë të mirë. Më vjen keq që ka shkue.Pediatri ka shkue, edhe më nuk është, edhe gjinekologia sot shkoi. Ajo ka bo një shërbim të jashtëzakonshëm, u socializue aq shumë me qytetarët tanë, aq shumë me punëtorët, më ka ardhë keq, kemi dalë krejt e kemi përcjellë, edhe prej ditës së hënë unë nuk e di qysh – edhe po më vjen keq se edhe në Plan nuk e keni. As në Plan nuk e ka për vitin 2025, çfarë zgjidhje do t'i bëjë qytetarëve të Komunës së Dragashit. Edhe, te aktivitetet për vitin 2025 – nuk po due shumë me u kyç, veç po më intereson te aktivitetet – e para është kontrollimi dhe menaxhimi i buxhetit. Aty i kondet, aty e menaxhon shumë mirë, se i kondet,

buxhetin e ka marak. E dyta, renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore në trevën e Gorës. Unë sa e di, ky është drejtor i Shëndetësisë i Komunës së Dragashit. Në qoftë se kanë nis negociatat me Dudën për me e nda Komunën edhe ka pa ëndërr syçelë, me qenë veç drejtor i pjesës së Gorës, unë e di që ky drejtor është edhe për Opojën. Edhe në Plan nuk e ka pjesën e Opojës, kërkund. Asnjë troh! Veç e kje renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore në trevën e Gorës. Kurrë nuk ka ndodhë, që tri mandate jam këtu, me pas drejtor me nda Gorë dhe Opojë. Edhe një herë po ta them, është drejtor i Shëndetësisë të Komunës së Dragashit, nuk është drejtor i komunës së Gorës. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore, te kujdesi primar shëndetësor, nëse e ke lexue, Komuna e Dragashit e zë vendin e dytë në Kosovë. Edhe për nga numri, edhe për nga cilësia, edhe për kualitet edhe të gjitha. Këtë matje nuk e kam bo unë, por e kanë bërë institucionet e Kosovës. Kështu që, këtu sa i përket shëndetësisë, unë mburrem me punën që e bën edhe drejtori, edhe drejtori i QKMF-së, edhe stafi, edhe mjekët, infermierët, stafi ndihmës etj. Kujdesi primar shëndetësor është shembull në Kosovë. Kush fol, mund të fol për inat, mund të fol për teke personale, për inate personale që i ka ndaj drejtorit etj., mirëpo unë të tregova një realitet që, vendin e parë e ka zënë Mamusha – normal se Mamushës i ndihmon shumë Turqia – mirëpo vendin e dytë në Kosovë e kemi ne. Sa i përket pediatri, ne nuk kemi parë ëndërr që po e lë punën pediatri. Ne e kemi pas pediatri në këtu si mjek të përhershëm, mirëpo në moment ai e ka kqyr interesin personal edhe e ka lënë punën. Nuk na ka tregue ai para një viti, dy apo tre, që do ta lë punën më datën kaq. Më duket që ai një javë ditë përpara, ose dy ditë përpara, e ka njoftue drejtorin që po e lë punën, ka gjet punë në Prizren edhe ka shkue. Mirëpo ne nuk kemi ndejt duarkryq, ne menjëherë kemi kërkuar nga Ministria që të na lejojë specializimin nga pediatria, Ministria e ka hap konkursin. Me sa e di unë, një doktor prej QKMF-së ka konkurue, do të shkojë në specializim dhe do ta kryejë. Sa i përket gjinekologes, unë e falënderoj për punën që e ka bo, ajo e ka bo një punë të jashtëzakonshme. Po na vjen keq që i ka ardhë koha edhe ajo, për çështje personale, se është e Prizrenit, do të shkojë. Mirëpo, gjinekolog do të ketë shërbimi në QKMF. Pavarësisht se është i vjetër, po personat të cilët janë të vjetër kanë përvojë shumë më të madhe. Dr. Femia është një prej mjekve më të mirë, prej gjinekologëve më të mirë në Kosovë. Është mjek i cili ka krye me mijëra e mijëra lindje jashtëspitalore, edhe nuk e ka pas asnjë komplikim edhe asnjë rast vdekje. Kjo, falë Zotit normal, por edhe falë aftësive të tij profesionale, që për fat të mirë, në lindoren jashtëspitalore, gjatë kohës sa ka punue Dr. Femia, nuk ka pas asnjë vdekje. Drejtori i Drejtoratit

për Shëndetësi është drejtor i Komunës së Dragashit, nuk është i pjesës së Gorës. Nuk bëjmë ne ndasi Gorë-Opojë. Por, në Planin e tij të Punës për këtë vit, me buxhetin e vitit 2025 janë paraparë mjete me u renovue ambulatat edhe QMF-të në pjesën e Gorës. Në pjesën e Opojës ne i kemi renovuar, nuk kemi nevojë. Ju e dini që mjetet e investimeve kapitale ndahen në bazë të ndarjes së drejtë financiare, edhe ata mjetet e veta i kanë orientue në shëndetësi, me i renovue disa AMF dhe QMF në pjesën e Gorës. Ndërsa, ne në pjesën e Opojës i kemi renovue vjet edhe parvjet. Ndërsa, sa i përket atyre statistikave, mund të ketë gabime copy-paste, nuk po them që janë të vërteta apo jo. Mund të kesh të drejtë, mirëpo në seancën e ardhshme, kur të vjen drejtori këtu, do t'i sqarojë këto statistika, se edhe mu po më duken ato ... ose ka gabue me zero, ose diçka. Pastaj, këto të dhënat në QMF Bresanë, ndoshta edhe nuk kanë mund me i qit, por Samidini më duket që do me e marrë fjalën edhe mund të japë sqarime. Për televizionet, Tv Prizreni – këtë pyetje na ka bërë edhe Muniri – ne dy herë e kemi thirrë me ardhë me xhirue. Ndërsa, Tv Opojën ne tani e thirrëm për çdo seancë. Pagesa është nën 100 euro, kemi të drejtë ligjore me bo pagesa nën 100 euro, pa procedura të prokurimit, vetëm me kërkesë. Një herë ka qenë kur e kemi pas një aktivitet të Muajit Rozë nga Grupi i Grave, dhe herën tjetër ka qenë kur n aka vizituar ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, bile edhe Muniri ka qenë aty nëse i kujtohet. Kështu që, këto dy herët e kemi thirrë dhe e kemi paguar nën 100 euro. Sa i përket pjesës së dytë që nuk është, unë kam thënë të njëjtën ditë kam bisedue – para një muaji – edhe ata të njëjtën ditë e kanë qit edhe është në Youtube. Prapë kam bisedue dje ose pardje në telefon, thanë që e kemi qit në të njëjtën ditë, është në Youtube.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Para se me ia dhënë replikën Artanit, kam edhe unë diçka për Tv Opoja. Arsyeja pse Tv Opoja ndodhet këtu, sepse e qet live çdo seancë. Radio Sharri, a jeni tash live? Veç në Youtube. Për këtë arsye, se unë kam dashtë që çdo seancë të përcillet live, pasi edhe kur jam zgjedhë si kryesuese, Radio Sharri nuk ka qenë live, edhe për atë arsye jam detyrue që ta thirri edhe Tv Opoja, që veçanërisht e falënderoj për të gjitha seancat m'u përgjigj dhe asnjëherë nuk ka pasur as edhe më të keqen gjë, që mos të jetë prezent këtu.

Artan Loshaj: Për vendin e dytë që e kemi zënë në Kosovë, më vjen mirë, kryetar, se edhe unë jam pjesë e stafit. Për inati nuk foli kurrë, se po shkoj kundër vetvetit, nashta edhe qaq naiv nuk jam. Edhe unë nuk fola për krejt QKMF-në, fola vetëm për drejtorin edhe fola për pediatri, edhe gjinekologun. Edhe një herë të thashë, unë i falënderova parëz, prapë i falënderoj. Bëra një pyetje: A keni një plan afatgjatë – drejtori yt a ka plan afatgjatë? Sa për te Dr.Femia, mos e bën politike,

se Dr.Femia – kam punue me Dr.Femiun, e kam pas drejtor, e kam mik të shpisë – unë nuk thashë që është mjek i keq, është njëri prej më të shquarve dhe më me zë në trevën e Opojës, Prizren edhe krejt Kosovën. Por, shkak i moshës unë të thashë, ai munden me punue dhe një vit, dy, tre, po është pensioner, 72-73 vjet. Unë nuk jam kundër tij, unë e kam mik të shpisë, edhe më vjen turp me folë për të, se dy fëmijë që i kam sot unë, shërbimet m'i ka krye Dr.Femia. Unë të thashë, e kam mik të shpisë. Nuk fola për inate, unë fola për një plan afatgjatë, një pediatër edhe një gjinekolog. A, sa për Tv Opojën, në qoftë se e ka kthye në Youtube, ju kërkoj falje, se nuk e kam pa. Edhe është mirë, personale s'e kam, tjera herë, masi është live, mos ta fshijnë, e masnej me presionin e juaj me e qit prapë. Le të bëhen transparentë këta me kohë, jo me presion. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Jo, nuk i është bërë asnjë presion Tv Opojës, dje ta shpjegova që ka pas probleme me rrjetin, edhe për atë është fshi apo çka është bo nuk e di. Unë po të them kështu: Nesër gjeje një pediatër edhe një gjinekolog që nuk është pensionist, bjere, e hapim konkursin edhe menjëherë i pranojmë. Problemi është që po i marrim pensionistët, sepse nuk ka gjinekolog i cili vjen e punon këtu, nuk ka pediatër i cili vjen punon, këtu është problemi. Unë të tregova, planifikimin e kemi bërë, kemi kërkuë Ministria me e hap konkursin për pediatër, e ka hap. Edhe gjinekologu është në specializim, vitin e ardhshëm vjen. E kemi, është gjinekologe që e financojmë ne.

Samidin Xheladini: Falënderoj kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për punën voluminoze, raport të shkëlqyer dhe me një buxhet të varfër, me një goditje të rëndë nga qeveria qendrore, kur na janë marrë rreth 1 milion euro. Qytetari duhet ta dijë të vërtetën. Me një buxhet të varfër ka arrit të bëjë punë voluminoze dhe të paparë më herët. Ka bërë investime në infrastrukturë, në rrugë, në arsim, shëndetësi, urbanizëm, turizëm, ujësjellës, kanalizim, sport, kulturë etj. Jemi edhe përfitues të Grantit të Performancës. Nëse vazhdon kështu Komuna jonë, me këtë dinamikë, do të arrijë edhe vendet më të zhvilluara të Evropës. Sepse – e dini mirë, ju edhe para sysh nuk shihni – bashkatdhetarët tanë na kanë thënë, në Zvicër komunat jau çojnë fermerëve rrugët deri në bjeshkë. Komuna jonë e ka mbrii Zvicrën. Të gjitha fshatrat i kanë rrugët deri në bjeshkë. Gjithashtu, falënderoj drejtorin e QKMF-së për punën që po e bën. Unë kam qenë në pushim vjetor, me 1 janar kam shkue, raportet nuk kam mund me i dorëzue, se kam qenë në pushim. Kështu, më brejti diçka, unë do të foli personalisht për vete, mos e lidhni me çështjet e të tjerëve. E dëgjova zv/kryesuesin, që janë cënue disa të drejta të boshnjakëve dhe goranëve. Unë mendoj dhe gjithnjë kam menduar,

se ju duhet të mburreni me këtë qeveri, sepse nuk po ju dallon nga komuniteti shumicë. Kjo është një e arritur e madhe, përkundër tentativave për ndarje. Ata të cilët lansojnë dezinformata në baza etnike, janë ndohta të ngarkuar vetë më këso lloj gjërash. Komuniteti joshumicë është i privilegjuar vetëm në shtetin e Kosovës. Kërkund në botë nuk ka të drejta komuniteti joshumicë, përveç të drejtave që i kanë në Kosovë, na si shumicë që i kemi, kanë të drejta shtesë. Dhe në Dragash në veçanti, dhe nuk diskriminohen në baza etnike. Për këtë jam i bindur, unë s'kam parë ende asnjë rast. Nëse ka dikush rast, le të më kallxoj mu, ta di, se nuk e di. Duhet të mendojmë, ta kthejmë pak kokën prapa të shohim, se ne nuk bëjmë diskriminim si komunitet, sepse vetë kemi qenë të diskriminuar me decenie e vite të tëra. Jemi larguar nga puna, jemi vrarë, jemi torturuar. Të jeni të bindur që komuniteti shumicë – individë mund të ketë – nuk bën diskriminim. Edhe këtë e bën vetëm Kosova. Kqyrni vendet e botës, a i kanë të drejtat komuniteti joshumicë, përveç të drejtave që i kemi na me Kushtetutë, edhe të drejta shtesë kanë. Mburremi me atë edhe jemi shumë të kënaqur, edhe duhet me iu dhënë të drejta shtesë, aspak s'na pengon. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Kur flasim për çfarë të drejtash kemi. Nuk mund të mos pyes veten se në cilën komunë jetojmë. Më jep argumente për gjithçka që ke thënë. Sa punonjës ka në sektorin publik? A është plotësuar kuota prej 39 deri në 41 për qind? Nëse nuk i kemi të drejtat që na garanton Kushtetuta, nuk kemi arritur ende atë që na lejon Kushtetuta. Nuk kemi ardhur akoma. Një nga kushtet për pavarësinë e Kosovës ishte edhe pranimi i disa konventave. Ashtu si Lubjanës, evropiane, sa i përket mënyrës sesi duhet të trajtohen minoritetet. Unë pajtohem me ju, gjatë viteve të 90-ta ju janë bërë lloj-lloj gjërash dhe pastaj që të mos ndodhë më, të mos ketë revanshizëm, atëherë Kosova ka miratuar disa konventa si shtet dhe ky shtet bazohet në këtë. Kështu u arrit pavarësia e Kosovës. Në institucionet publike në këtë komunë duhet të kemi 39% të të punësuarve nga komunitetet joshumicë. Të flasim për këtë? Sa përqind është rritur, sa është numri, kur erdhët ju Kryetar në pushtet ishte 29%, sa janë të punësuar tani? Ne nuk llogarisim arsimin. Ne numërojmë administratën komunale, shëndetësinë, sa janë në ndërmarrjet publike dhe postën.

Driton Ademi: Samidin, para se me dalë me folë, ti mundesh me dalë me folë për dy çështje që i fole për në Bresanë. Pse s'po dalish me folë për nxemjen në QMF Bresanë? Qe sa kohë jeni pa nxemje. Pse s'po dalish me e thënë realitetin edhe me i thënë kryetarit, me e ditë nxemja që u prish. Nuk janë gjëra të vogla, qe një muaj ditë keni mbet pa nxemje. Po e thuesh gjë të vogël, unë po i shoh me xhupa ata po rrinë, mjekët dhe teknikët. Valla nja dy herë jam konë, nëse nuk është e

vërtetë, shkojmë e i marrim qetash fotot edhe t'i kallxoj. Pjesa e dytë, thajë asfaltimin fermerëve, një fermerit ia ka bo asfaltimin në Bresanë, edhe atë nuk e ka krye rrugën kah e ka fillue ish-kryetari Shaban Shabani. Ia ka çue një fermerit edhe pronave të shokëve të vet e të vetat. Një fermeri, qaj asfalti i ri që u bo. Nuk e ka krye kah e ka fillue Shaban Shabani. Një pyetje për kryetarin, edhe pse e kemi diskutue, për një pikë vitin e kaluar, siguria në trafik. Kryetar, nuk pashë kurgjo, as te raporti 2024, as për 2025-tën, te siguria në trafik, që e kemi kërkue sidomos prej pjesës së Zymit deri në pjesën e Zaplluxhes. Është mirë që këtu me e parapa këtë, te rruga kryesore, rruga magjistrale prej Tyrbes deri në Zaplluxhe. Drejtor, te Shkolla Fillore "28 Nëntori", a je në dijeni që një muaj ditë shkolla ka mbet pa dru, edhe kanë shkue kanë marrë, iu ka dhënë dru Shkolla Fillore e Blaçit. Ju ia keni marrë buxhetin, jeni duke i çue dru sa ju vetë po doni, të gjithë shkollave. Shkolla e Bresanës ka mbet pa dru. Nuk e di saktë, ka ndoshta mbi dy javë ditë që shkolla e Bresanës ka mbet pa dru. Kryetar, po thuesh që dy herë mos rrej, fotografitë janë që punëtori juaj ka shkue me kerrin e vet, ka shkue ka marrë në shkollën e Blaçit, ka marrë dru edhe ka pru. Tash mundesh me thënë prapë mos rrej. Vjen seanca tjetër, të trëgoj faktet, e shohish. Edhe një pyetje, drejtor. Te orët shtesë, pse nuk po jau boni orët shtesë të gjithë mësimdhënësve, por i keni nda në baza politike. A ka mundësi me e ditë, pse veç "simpatizantëve", mësuesave të juaj jeni duke ua paguar orët shtesë, kurse mësuesave tjerë ka që disa muaj që nuk jeni duke ua pague. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: E di që jena lodhë mjaft, por mirë që për herë të parë pas shumë seancave, kemi mbet deri në ora 16:00 po diskutojmë, po më vjen shumë mirë. Sa i përket raportit që e dha kryetari, nuk due të diskutoj fare me të, e tregoi atë çka mendon që është krye. Por, unë dua të lidhem pak te drejtori i Ekonomisë dhe Financave, se i kam thënë edhe në raportin e vitit të kaluar. Drejtor, raportin periodik fshije prej aty, se nuk e kena pas, ndërsa planin e veprimit po. A raportin periodik nuk e kena pas na asnjëherë, nuk e kena diskutue. Ta kam thënë edhe vitin e kaluar kur e kemi pas, por e ke lënë prapë, të ka mbet aty. Ndoshta nuk çon shumë rëndësi, po nuk është në rregull, se e di mjaft mirë që raport periodik nuk kemi pas. Tjetra, do të jam shumë i shkurtë, se shumë u diskutua, sidomos nga Muniri, i preki të gjitha pikat që mendoj kanë qenë të arsyeshme, për dikënd ndoshta s'është në rregull, tek urbanizmi. Dua të diskutoj tek paraqitja tabelare që e ka bo, të projekteve të finalizuara, të përfunduara në vitin 2024. Nuk e di a ka qenë ai zotnia këtu, por unë këtë problematikë e kam ngrit vetëm, kur e kemi pas tek raporti përfundimtar, me drejtorin e Financave e kam diskutue. Ai ma ka dhënë një sqarim, ky zotnia prapë e ka bart edhe ma ka shënuar mu si projekt i përfunduar çështjen e ujit në fshatin Kuk. Tregoi atij zotnisë, thuj hiqe aty,

bone X, se ai nuk është përfundue, ato paret ju kanë shkue diku tjetër. Edhe shënoje aty – thuaj – në tabelë, në anën tjetër, “i ka marrë përmbaruesi”. Tregoji drejtorit, thuj qeshtu, herën tjetër mos na gënje. Tjetra, tek Drejtorja e Bujqësisë, zakonisht kam dëshirë shumë të diskutoj për këtë drejtori, por fatkeqësisht sot edhe drejtori këtu nuk është. Në rregull, kryetar, ti je, por ti je për do çështje tjera, për bujqësi s’po e di sa po i rrumbullakëson krejt gjërat. Por, edhe ky e ka bo një lëshim të cilin unë vetëm e kam ngrit më herët si problematikë: çështjen e subvencioneve. Ky e ka bërë si të përfunduar. Nuk është e përfunduar, tregoi kryetar, bartja atij informacionin, thuj që do i kemi pague në rregull, ata kanë aplikue fermerët, dokumentacioni në rregull, por paret s’i kemi pas, dove jau kemi lëshue, dove nuk jau kemi lëshue, tash kemi me jau lëshue. Kështu që, duhet me raportue në mënyrë të rregullt dhe në mënyrë reale. Edhe sa i përket shëndetësisë, diskutuan ata shumë, po aty më bëri përshtypje mu shumë qekjo çështja e AMF-së. Kish pas bajagi aty të dhëna, sidomos në fshatin Kuk, unë kam informacione të sakta, qaty nuk shoh njerëz unë që shkojnë, rrallë ndonjë. E di që tekniku i cili punon aty është perfekt, fenomenal, por ai shumicën i kryen nëpër shtëpi, ndërsa në AMF s’kam pa njerëz qaty që e frekuentojnë najkush. Nuk e di ato të dhëna sa qëndrojnë edhe sa janë reale. Edhe një çështje – edhe pse këtë pyetje po më duket, kryetar, e ke pas edhe më herët – për QMF-në e Brodosanës, pse është bo qekjo dita, e shtunë e diel pushim. Njëri më tha, po duhet tash sëmundjes me i thënë kqyre, mundësisht, virus, sëmundje, çkado që të jetë, ditët pushim kur e kanë doktorët, infermierët, ti duhet me pazue. Se na s’kemi ku me shkue me u trajtue. Çka ta merr mendja, çka kishe mujt me bo në këtë drejtim, që me funksionue 7 ditë të javës. 365 ditë të vitit duhet me funksionue, se sëmundja s’po na vet, kryetar. Këtë e din edhe ti mirë, je i këtij profesioni, i këtij drejtimi. Edhe këta qytetarë të paktë të cilët kanë mbet, s’paku të kenë QMF-në e Brodosanës funksionale, 7 ditë në javë. Sa i përket DKA-së, deshta edhe pak, një pyetje t’ia parashtroj drejtorit të Arsimit. Unë kam respekt të madh për të. Drejtor, ti e dish këtë çështjen e doracakut që u bo shumë e madhe, këtë problemin madhor, shqetësimin e madh të qytetarëve, rrezikimin e familjes. Pse nuk keni bërë kurrfarë reagimi. E dish ti, një pjesë e mirë e disa komunave kanë marrë vendim direkt që ajo të mos përfilllet, ajo kurrikulë, ato dokumente shkatërruese – po e them kështu, sinqerisht – për familjen edhe për fëmijët. As nuk e kam lexue në raport që keni ndërmarrë diçka, por edhe përmes mediave nuk kam pa diçka të tillë. Çka ka ndodhë, pse, t’u ka dok naj problem i vogël apo çka është arsyeja, pse nuk keni ndërmarrë masa si komunat tjera? Tjetra, kam dëgjue që po ka edhe sulme të arsimtarëve nga nxënësit. A e ke ti këtë informacion, drejtor, apo jo, dhe a planifikon diçka me ndërmarrë ndaj atyre nxënësve

të cilët i sulmojnë profesorët? Dhe problemi tjetër, i fundit, e preku pak edhe kolega Driton, e din mirë që furnizimi me lëndë djegëse këtë vit, 2024, është bërë shumë vonë. Këtë vit, a keni planifikuar që të bëhet më herët, apo njëjtë? Tash zgjedhjet janë, ndoshta këtë vit e bëni pak më herët, po s'ka rëndësi. Me rëndësi është që ju me e planifikue me kohë që fëmijët, nxënësit, arsimtarët, së paku ta kenë të siguruar edhe nxemjen, mos ta kenë problem që të përballen me të ftohtin dimëror. Ju faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Sa shkolla keni ndërtuar në Gorë, që mburreni se këtu jetojmë njëlloj dhe vëllazërore dhe se nuk na mungon asgjë. Kishte një shkollë në fshatin Brod që e hoqët çatinë, ajo objekt 8 muaj mbeti pa çati, nga shiu dhe bora ndërtesa u mbyt, kështu e ruajtët, derisa u ankua në KFOR-in italian që ta rinovonte çatinë dhe menjëherë shkuat atje për një burger dhe një foto. Ju keni marrë një ambulancë në Restelicë në çfarë gjendje është? Keni ndërtuar edhe një klinikë, si është gjendja e klinikës? A e dini se kjo klinikë furnizohet kryesisht me barna nga donacionet e Shoqatës Humanitare të Restelicës me seli në Cyrih? Keni një informacion të tillë? Dhe këtu shpenzojmë shuma të mëdha parash përmes drejtorisë së shëndetësisë. A është kjo një mënyrë e barabartë e trajtimit të komuniteteve joshumicë? Sa herë kam tërhequr vëmendjen për rrëshqitjen e dheut midis Globoçicës dhe Krushevës? Ndoshta kemi ende disa rrënoja atje. Ndërsa drejtori juaj tha se është rrugë rajonale dhe nuk është obligim i komunës së Dragashit. A do ta lejonit një situatë të tillë në Opolje? Kryetar, ju keni urdhëruar të parakalojnë autoambulancat, të blera në vitin 2022 dhe thatë se do të formoni një komision për të ekzaminuar vjetërsinë e këtyre automjeteve, sa duhet të presim për këtë. Me iniciativën time ju thatë se do të hetoni. A keni hetuar një problem me një automjet që nuk ishte më i vjetër se një vit dhe nuk punonte siç duhet? Pse nuk e bëre? Ne kemi në dispozicion paratë e taksapaguesve dhe çdo cent duhet të shpenzohet siç duhet. Diskriminimi ndaj komuniteteve pakicë është i dukshëm. Për shembull, a janë kryer punët e infrastrukturës në të njëjtën cilësi në Opoje dhe Gorë? A keni kryer ndonjëherë një inspektim? A keni parë se çfarë lloj blloqesh janë vendosur në rrugën Lubovishtë-Dragash? E vetmja gjë që të justifikon dhe pas së cilës fshihesh me mjeshtëri janë këta tradhtarët tanë. Për punën e ndonjë interesi personal, ndonjë emërim të vajzës së zonjës Esati. Njerëzit janë gati të tradhtojnë dhe të qëndrojnë në sallë, edhe pse ne insistuam që posti i zv.drejtorit të QKMF-së të përfshihej në Statut, të ishte detyrim ligjor. Unë jam mirënjohës për këtë, por a do të bëjë të njëjtën gjë pasardhësi juaj? Çfarë do të ndodhë pas sundimit tuaj? Ju e shtytë Statutin duke i detyruar këshilltarët tanë të qëndrojnë në sallë dhe të votojnë, prandaj dikujt iu dha posti i Zëvendësdrejtorit të QKMF -së. Një person që kishte

vetëm 37 ditë shërbim për të qenë shefi i mjekëve që i kanë kushtuar gjithë jetën atij institucioni më lart, është poshtëruese për ta. Nuk mund të më bësh asgjë, unë jam i armatosur me të vërtetën. Edhe ju, zonja Brenoli, jeni në listën e pagave si Kadri. Shpjegojuni njerëzve këtë. Jeni në ato ulyse vetëm për të fituar disa privilegje.

Arijeta Skeraj: z.Sejdilar, a ka mundësi me u marrë me rendin e ditës, mos me u marrë me personat që janë këtu. Ju kisha lut, në rend të ditës nuk është as znj.Brenoli, as Ventaza. Pak më herët thaje mbaje rendin e ditës, z.Munirti ia ke dhënë 50 minuta, po edhe 100 me ia pas dhënë, Muniri nuk i ka prek asnjë prej delegatëve, krejt është përqendruar te rendi i ditës. I vetmi je që e provokon çdo asambleist. Të lutem, hera e fundit, përndryshe, në qoftë se vazhdon jashtë rendit të ditës, jam e detyruar me ta ndalë flaën. Nuk dua asnjë me e përmend me emër e me mbiemër. Të lutem!

Nedžmidin Sejdilar: Pyetje për Kryetarin. Unë dhe njerëzit jemi kureshtarë pse drejtorët nga komunitetet joshumicë nuk janë të pranishëm sot në sallë. Për lumin Radeshka Reka keni marrë përgjigje negative nga qytetarët. Ju ende vazhdoni të punoni. Keni premtuar kundërpeticion dhe nuk e keni sjellë kurrë. Nuk dyshoj në cilësitë e vajzës suaj Esati. Problemi im i vetëm është se ju përdorët autoritetin tuaj dhe justifikuat qeverinë në diskriminimin e tyre ndaj komunitetit joshumicë. Problemi i vetëm është përdorimi i autoritetit për përfitime personale. Hoqa dorë edhe nga përfitimet që u takojnë familjarëve të mi. Ndërsa unë jam këtu ata nuk do të marrin asgjë, sepse unë besoj në atë që po bëj. Dhe unë mendoj se njerëzit që janë më mirë jashtë se ata vetë, kjo është arsyeja pse ne u votuam jashtë. Jo se ne fitojmë përfitime personale nga autoriteti ynë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Unë po ndihem shumë keq, se gjithmonë flitet nga asambleistët që gratë veç kanë ardhë me ndejt. Ndonjëherë gruaja di të heshtë, po di ma mirë se ai që fol. Unë nuk e toleroj, kjo është hera e fundit, një burri asambleist që u drejtohet asambleisteve.

Ventaza Esati: Fillimisht dua të përshëndes të gjithë të pranishmit, duke filluar nga kryetari i komunës, kryesuese i Kuvendit, zevendes kryesuese dhe të gjithë delegatët. Ju kërktoj zoti Sejdilar të përmbaheni nga pretendimet e pabaza dhe fjalet boshe. Pres diskutime të arsyetuara dhe propozime konkrete, jo kritika të pabaza. Kuvendi nuk është vend për fjalet te mahalles, por për punë serioze në interes të qytetarëve. Në seancën e kaluar e keni prekur temën në mungesën time, për emërimin e zv/drejtoreshës së QKMF-së, duke e pyetur pse në veçanti ajo. Është interesante se si kontestohet suksesi i dikujt, sikur përpjekjet, njohuritë dhe aftësitë të mos jenë arsye të

mjaftueshme. Në vend që të njihni dhe të mbështesni punën dhe kompetencën, ju zgjidhni të insinuooni dhe vini në dyshim diçka që është plotësisht legjitime. Ajo që është edhe më interesante është se ju kërkuat postin e yv.drejtori por padyshim nuk e deshtet. Pra, cili ishte qëllimi atëherë? Kritika për hir të kritikës? Nëse tashmë jeni duke marrë përsipër opinionet dhe qëndrimet e njerëzve të tjerë, më e pakta që mund të bëni është të kontrolloni së pari faktet. Por sigurisht, është më e lehtë të thuhet sesa të bëhet, apo jo? Prandaj ju bëj thirrje që më në fund të dëgjojm një propozim konkret në vend të sulmeve të pabaza. Sepse fjalët boshe nuk i sjell dobi askujt, as neve këtu dhe as qytetarëve që na kanë besuar.

Nedžmidin Sejdilar: Nuk dyshoj në cilësitë e vajzës suaj Esati. Problemi im i vetëm është se ju përdorët autoritetin tuaj dhe justifikuat qeverinë në diskriminimin e tyre ndaj komunitetit joshumicë. Problemi i vetëm është përdorimi i autoritetit për përfitime personale. Hoqa dorë edhe nga përfitimet që u takojnë familjarëve të mi. Ndërsa unë jam këtu ata nuk do të marrin asgjë, sepse unë besoj në atë që po bëj. Dhe unë mendoj se njerëzit që janë më mirë jashtë se ata vetë, kjo është arsyeja pse ne u votuam jashtë. Jo se ne fitojmë përfitime personale nga autoriteti ynë.

Qamil Kolloni: Unë mendova kësa radhe që të mos hyj shumë në detale, të mos hyjmë në diskutime politike, për vetë faktin se jemi në vitin zgjedhor. Unë po e shoh një pjesë të delegatëve që po duan të bëjnë politikë, mirëpo politikën e demanton fakti. Nga raporti për investime kapitale, të cilin e kemi marrë e që është i përgatitur nga Bashkimi Evropian në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane dhe atë të Suedisë, kemi një performancë shumë të bukur sa i përket investimeve kapitale. Komuna e Dragashit radhitet si komunë e dytë me qasjen dhe pranimitë të gjitha kërkesave të qytetarëve. Gjithashtu, Komuna e Dragashit hyn në mesin e katër komunave me investime më të mëdha për kokë banori. Ju lutem, në qoftë se ka mundëi Nexhmidini me m'dëgjue, këto janë faktet që mund të ju ofroj. Çka është me rëndësi, për investime kapitale, për kokë banori në Komunën e Dragashit, në bazë të raportit të Ministrisë, në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa, për kokë banori del Restelica. Unë kam mundësi me ua bë një dokument të mirë këtyre delegatëve dhe të gjitha partive opozitare, me ia nda secilit, me e pa vetveten edhe me e pa se është bërë një punë e mirë dhe po lihet një punë e mirë. Janë 1,232,000 euro që i janë ndarë komunitetit në Restelicë. Gjithashtu, prin fshati tjetër që prapë vjen Gora: Leshtani, Krusheva dhe pastaj vjen Breznja, prej komunitetit shqiptar. Kur ia shtojmë edhe 2,400,000 investime kapitale të rrugës që lidh komunitetet pakicë. Komuna e Dragashit del me

standardin më të lartë në aspektin financiar për mbështetjen e komuniteteve joshumicë. Prandaj, kur i marrish të gjitha këto raporte financiare, delegati, demagogjinë që po e përdor dhe presionin denigrues ndaj delegatëve, qoftë të komunitetit goran apo atij boshnjak, por jo po bjer një gjuhë fyese edhe ndaj delegatëve të komunitetit shumicë, këtë duhet ta përfundoni ju si delegatë. Se këtë e përfundojnë shifrat, nuk keni nevojë për fjalim. Është në gjendje me e shfrytëzue Muniri edhe Nexha për demagogji edhe për politikë. Por, politikën e zhvesh fakti. Prandaj edhe unë po ju ofroj fakte. Nuk po dua kurgjo tjetër t'i them. Po nisem prej Drejtoratit të Zhvillimit Ekonomik. Ju e dini se kemi punue në tri projekte IPA gjatë vitit 2024, dhe tash në vitin 2025 prapë kemi aplikue në projektet IPA. I kanë kaluar të gjitha Concept Notet, kanë qenë në prag të ekzekutimit, për shkaqe të shkurtimeve buxhetore dhe të izolimit të qeverisë, kanë ndodhë këto që kanë ndodhë. Sa i përket dëgjimeve buxhetore, tregova Munir se ne renditemi si komuna e dytë në Kosovë, sa i përket kërkesave të qytetarëve të cilat janë të implikuara në buxhet. Ke mundësi këtë edhe në uebfaqe me e gjet, ti dish mirë me e gjet në uebfaqe, e ke publike, dje është bërë publik komplet për opinion dhe mund ta gesh atë. Uljen e pagesave të tatimit në pronë, e kemi sqarue në raportet buxhetore se pse kemi ardhë, kemi qenë me vendime të përbashkëta, kemi ulë vlerën nominale, nga kjo na është paraqit që mbi 3000 objekte nuk kanë bazë për tatim, dhe në mënyrë automatike kemi pas zvogëlim të të hyrave. Kur keni thënë si delegatë po ua ulim nga 100 euro dhe unë kam kërkuë mos t'ua ulim, për faktin se ne kemi ulë që në fillim edhe bazën, edhe përqindjen e tatimit në pronë, dhe qytetarët e Komunës së Dragashit në përgjithësi fitojnë nga 20% çdo vit nga ulja e tatimit në pronë, dhe ky është rezultat i përbashkët i këtij Kuvendit edhe i këtij drejtorati. Unë nuk i kam marrë lëvdatat për vete – dhe kemi ardhë këtu që kemi një rënie të të hyrave në tatim. Mirëpo, meqenëse Ligji për tatimin është progresiv, ka mundësi që në vitet tjera kjo të ngrihet, dhe ne ato 3000 objekte të cilat janë për momentin të pa bazë tatimore, do të paguajnë edhe ata tatime, ose do të marrim një vendim tjetër – në qoftë se e shohim që rrezikohet buxheti komunal, marrim një vendim tjetër, e rritim bazën nominale, dhe në mënyrë automatike ato 3000 objekte fillojnë tatimohen. Në qoftë se jo në 17.50 euro, mund të tatimohen me 9 euro dhe kështu krijojmë një të hyrë komunale. Munir, derisa jeni delegatë, ju duhet të përcillni në vazhdimësi vendimet të cilat merren. Panairi “EXPO SHARRI” shpallet për çdo vit me vendim të kryetarit. Drejtorati nuk mund ta planifikojë, por e mbështet, sepse nuk mund të paragjykojmë a do të jetë “EXPO SHARRI”, se ky realizohet nën patronatin e kryetarit me thirrje. Dhe, a do të jetë përfitues i këtij projektit Shoqata e Afaristëve SHARRI dhe do të quhet “EXPO SHARRI”, apo do ta bjer dikush një plan

më të mirë që do ta mbështet komisioni, ne nuk mund të paragjykojmë a do të jetë “EXPO SHARRI” apo si. Panairi i Produkteve Vendore me dekret të kryetarit, për çdo vjet e ka shpallë kryetari. Nuk mund të përdoret në Drejtoratin e Ekonomisë si një punë, vetëm si një mbështetje logjistike që i bëhet këtij Panairi. Shpetim, Raportin periodik financiar çdo tre muaj e kemi. Bile këtë vit e kemi dhënë edhe TM4-shin, për arsye se një pikë e kemi pas te Granti i Performancës, na u shtue një pikë për vetë faktin se nuk e kemi dhënë TM4-shin, kemi shkue me Raportin Vjetor, tash e kemi shti edhe TM4-shin. Këtë vit, para kësaj seance e ke pa që e kemi pas edhe TM4-shin. Kërkoj falje, unë për raportin financiar e paskam pas, tash e kam të kjartë. Sa i përket ujësjellësit të fshatit Kuk, Shpetim, nuk është realizue projekti. E kemi sqarue këtë. Edhe një çështje për Nexhmidinin që po e keqpërdor këtë foltore, edhe ju delegatët e komunitetit joshumicë, edhe ju shqiptar. Sa i përket zv/drejtorit në statutin komunal, është plotësisht i ligjshëm nga qeveria që e ka hedhë poshtë, për arsye se po t’ju pranojë në statut që zv/drejtori duhet të jetë detyrimisht nga komuniteti, ia merr të drejtën që mos me qenë drejtor. Ju e keni të drejtën e hapur dhe nuk jeni të diskriminuar, për arsye se keni të drejtë, në qoftë se keni kuadër profesional, në një të ardhme të zgjidhet edhe drejtori i spitalit, pse jo. Kur duash të jesh i barabartë, ligji të lejon të barabartë. Qeveria ka marrë një vendim shumë të mirë dhe jua ka sqarue që ta interpretoni drejt. Është e drejtë e Nexhmidin Sejdlarit që mundohet ta përvetësojë për vota politike, duke u munduar gjithmonë të thotë se po i shkilet e drejta e komunitetit. Por, ju si delegatë duhet t’i tregoni këtij djalit se kjo shkelje e të drejtave ka përfundue në Komunën e Dragashit, e sidomos me qeverisjen e Bexhet Xheladinit. Përpos asaj, me vullnetin e tij e keni edhe zv/drejtoreshën, për me i tregue Nexhmidinit se në çfarëdo rrethane jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me komunitetin goran. Në qoftë se të duhen një grusht vota, është mirë më mos me përdor gjuhë ndarëse, se për këso racizëm ti duhet me u përgjigj para ligjit. Ne kemi luftue me Slllobodan Millosheviqin për këtë gjuhë. Mos na e sill Kuvendin e Komunës së Dragashit me të njëjtën gjuhë përsëri. Ne i kemi dhënë kapak kësaj punës, unë kam dhënë gjak për këtë. E s’mundi ty me të lejue unë me dalë sa herë të t’teket ty komuniteti shumicë, e komuniteti shumicë, me e marrë nëpër këmbë. Se unë ty po ta mbroj komunitetin pakicë, a ti po mundohesh duke të mbrojt unë, me m’dalë me m’sulmue ti. Nexho, përfundoje këtë, se pas kësaj herës kam me të çue drejtpërdrejt me avokat, se ky Kuvend ka etikë të fjalorit, jo çka të teket ty me folë. Kjo është ma tepër se pyetje, kryesuese, se gjuha të cilën po e përdorë ky, e ke shërbimin ligjor që duhet t’ia ngresh padinë, se nuk guxon të bëjë diskriminim.

Munir Jonuzi: Vetë Qamili ka paraqitur arsyet se pse ne kemi paraqitur arsyet që zëvendësdrejtori i QKMF-së të jetë nga komuniteti jo-shumicë dhe që kjo të përfshihet në Statut. Kjo temë do të vazhdojë me Gjykatën Kushtetuese. Zoti Kolloni po përpiqeni të mashtroni opinionin, nuk keni qenë në dijeni se çfarë donim ne. Në nenin kontestues thuhej se nëse drejtori është nga komuniteti shumicë, zëvendësi i tij duhet të jetë nga komuniteti joshumicë dhe anasjelltas. Nuk po humbasim të drejtën që nesër të kemi drejtor. Mos e mashtroni publikun kështu. Këtu ju paraqisni të dhëna se fshati Restelicë ka investimin më të lartë për kokë banori, zotëri, nuk po na jepni asgjë, ajo na takon. Ju duhet ta kuptoni këtë, prandaj duam ta përfshijmë në Statut. Na takon me ligj. Këtë aktivitet ExpoSharri, unë e ndoqa raportin tuaj të vitit të kaluar. Më dukej e çuditshme pse u hoq ky aktivitet.

Nedžmidin Sejdilar: I nderum z.Kolloni, po pajtohem me ju, e keni luftuar Millosheviqin. Faleminderit, shyqyr prej Zotit jemi çliru krejt. I jam falënderues secilit që ka kontribu. Por, në liri e keni pranuar lluksin me e formu qeverinë me dorën e Millosheviqit. Kë e keni në koalicion? Shefi i këtyre haptas në televizione të Kosovës tha: unë pa lejen e Radoiqiqit nuk bëj asnjë koalicion. Prandaj, patriotizëm mos më shitni mu, ju lutem, se unë jam barabart si ju, jam taksapagues, derisa jeni ju taksaharxhues. Faleminderit!

Agron Gashi: z.Sejdilar, unë po ju përmendi edhe emrin kësaj here, por unë vetëm me dy pika të shkurta do të lidhem me të kaluarën. Në vitet e '90-ta kam qenë nxënës i shkollës së mesme 'Qamo Emin Duraku' Dragash. Vitin e parë e kreu në këtë shkollë. Vitin e dytë, me organet e dhunës dhe depresionit më dëbuan mu, mësimdhënësit dhe të gjithë personalitetin që ekzistonte shqiptar me 93 % në këtë Kosovës. Na dëbuan dhe na larguan, për katër vite kam marrur shkollën në Kapre, kam shkuar në këmbë. Tash të lutem, sulmove Asamblenë Komunale, sulmove kryetarin e Komunës, sulmove që të gjithë. Por, nganjëherë kalon mbi ato parametrat. Mos harro, është mirë edhe ndonjëherë t'u tregosh për komunitetin tuaj, se çfarë planprogramesh zhvillimore janë duke punuar në arsim, nga i marrin pagat ata personel arsimor. Edhe vetë ke qenë dëshmitar i kohës kur nga kjo Asamble i ke thënë ish-drejtorit të DKA-së, kur ju drejtove se a i ke pru drutë, tha që për shkak të përsëritjes së tenderit drutë nuk erdhën, por ti i tha: z.Selimi, drutë të kanë ardhur nga Vuqiqi në Brod. Dhe shumçka që ka në shpërputhje me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, asnjëherë nuk dole me folë se çka ekziston e vërteta në këtë Komunë. Ky komunitet është shquar për transparencë, për të drejtën e për të gjitha këto, dhe ne, qysh tha drejtori më herët, i kemi vu kapak

të kaluarës. Për e tëra në terren është tërësisht ndryshe. Del tregoj se çfarë strukturash janë duke punue, çfarë ligje, çfarë programe arsimore, 1-4, 5-8, edhe sot e kësaj dite e dish fort mirë nga marrin paga. Dhe, të lutem, mos z.Sejdilar, se vërtet ke kaluar çdo parametër në këtë foltore dhe të kesh respekt dhe të jesh më transparent lidhur me të drejtën që jeni duke e gëzuar. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: I nderum z.Gashi, mu më vjen keq për çka ju ka ndodhë. Kurrë nuk e kam mohuar që komuniteti shqiptar para luftës ka qenë në pozitë të keqe. E di, e di bile ma mirë se ju, i di sakrificat, e respektoj çdo çlirimtar, e respektoj çdo shehid. Secili njeri që ka rënë për këtë liri, për mu është shehid. E pranoj. Kurrë nuk kam mbet pa i respektu ligjet e Republikës së Kosovës. Unë asnjë nënshtetësi tjetër s'e kam, përveç dokumenteve të Kosovës. Asnjë nënshtetësi tjetër s'e kam. Tash, z.Kolloni hapi diskutimin me patriotizëm ndaj meje, me m'thënë që unë jam i keq për Republikën, po ai është i ulur me dorën e djathtë të Millosheviqit. Qata njerëz që janë këtu, janë familje 30 e kusur vjet, me direktiva të Beogradit. Këtë kam desht me ju thënë unë. Për patriotizëm, asnjërit nuk ju mohoj këtu. Por, ju lutem, mos më tregoni mu që unë nuk jam patriot. Në çdo aspekt të patriotizmit në këtë shtet jam i kyçur. Jam taksapagues, e respektoj çdo ligj, jam kandidu këti në Republikën e Kosovës për delegat, e kam fitu mandatin. Këtu e respektoj komunitetin tim, e prezentoj Komunën, i prezantoj qytetarët. Kurrë nuk kam thënë diçka antikushtetuese. Për drutë, i nderum z.Gashi, unë e kam thënë të vërtetën. Atëherë qashtu ka qenë, drutë i kanë pru prej Beogradit në shkollat e Republikës së Kosovës. Nuk e mohoj asnjë rrogë që mësuesit marrin prej buxhetit të Republikës së Kosovës, nuk e mohoj asnjë nxënës që shkon në shkollë, krejta i respektoj. E respektoj secilin nxënës. Por, një informatë me ju dhënë, z.Gashi: njerëz, kolegë të mi, delegatë edhe politikanë nga Gora kanë ardhë me mu me listë, thanë po dojna me e hek qato për shkak të politikës, a na mbështetitsh. I kam thënë jo, kurrë, edhe jam krenar. Faleminderit!

Qamil Kolloni: z.Sejdilar, me sa më kuptove, unë thashë që koha e patriotizmit ka kalue. Kur ka pas nevojë me bo patriotizëm, unë kam bo. Sot jam duke bo patriotizëm qytetar. Çdo delegat këtu që është i është nënshtetësi kushtetutës dhe rregullave ligjore, dhe po flasim për ligj. Kur po thuesh ne jemi të barabartë dhe po ju bëjsh presion delegatëve, po ju thuesh jemi të barabartë para ligjit. Dhe këtu në Kuvend diskutohet me ligj. Kurse, në anën tjetër ti po dalish demagog, se po bëjsh presion politik. Këta delegatë u i njoh si qeveri lokale, delegatë që i janë nënshtetuar ligjit të zgjedhjeve të Republikës së Kosovës. E njohin kushtetutën e RKS-së dhe janë të barabartë si ti, si këta. Kualifikimi yt politik se janë të Millosheviqit e atij tjetrit, kie debate tjera ku i bësh në

televizion. Në qoftë se diskutosh këtu me ligj dhe je delegatë që duhet të mbrosh ligjin, duhet të kesh respekt ndaj kolegëve tu, dhe jo të ju bësh rregullisht presion. Prandaj, për këtë arsye po të tregoj se unë e kam krye patriotizmin, unë po flas me ligj dhe unë i kam bashkëpunëtorët, përmes ligjit jam duke e bo një korrektësi, një bashkëpunim shumë korrekt që ndoshta ty po të vret, pse jemi në vit zgjedhor edhe ke pretendime për me i marrë një grusht vota, por unë nuk jam i interesuar për atë. Unë jam i interesuar me të tregue se edhe atëherë e kam mbrojt ligjin, edhe sot e mbroj ligjin. Për këtë arsye kam dallue edhe në atë kohë, dalloj edhe sot. Dhe të lutem, mos i bën këtij Kuvendi më presion! Të lutem shoqërisht, mos i bën presion, duke u mundue me i nda në komunitete. Kaq!

Nedžmidin Sejdilar: Unë as që kam dashur të replikoj, por zotnia ma ka përmend emrin, çka kam faj unë. Unë s'kam faj, unë kam nejt atje, ma kanë përmend emrin. Për Millosheviqin, unë nuk e kam përmend në Kuvend, veç jam mbrojt nga akuzat të cilat më kanë etiketuar me Millosheviqin. Veç atë e kam bërë, unë nuk e kam përmend kurrë Millosheviqin edhe s'kam nijet me e përmend, se Millosheviqi kur ka qenë në pushtet unë i kam pas 7 vjet.

Arijeta Skeraj: Të lutem, mos me e përmend Millosheviqin, kur e dish që kemi ushtri çlirimtare. Të isha lut, ose ta ndërpres! Këtu nuk je përveç Asamblesë, që ke me thënë. Ju lutem, këtu nuk është politikë, këtu na ka çue populli të merremi me çështje që na takojnë neve. Të lutem, mos bën ma shumë se politika!

Nedžmidin Sejdilar: znj.Kryesuese, edhe parëz të kam thënë, unë e dua këtë shtet, edhe parës ka thënë unë e respektoj këtë shtet, edhe kushtetutën, edhe ligjet e këtij shteti. Edhe parëz kam thënë, çdo luftëtar për lirinë, çdo njeri që ka sakrifikuar jetën, çdo send që ka sakrifikuar, e respektoj. Çdo luftëtar që ka ra për liri, për mu është shehid. Kurrë nuk e kam mohu edhe s'kam nijet me mohu, se ajo është njerëzisht brenda meje, jo politikisht. Edhe unë kurrë s'jam kap në politikë me këto gjëra. Unë veç kam repliku për etiketat të cilat keni desht ju me m'ngjit mu këtu. Kurgjo tjetër. Kur ngjitni etiketat, kqyrni mos e keni naj etiketë ju, se kur është puna te patriotizmi, nuk bën patriotizmi veç te kundërshtari me kqyr. Duhet me kqyr edhe në skuadrën e vet. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Pasi që u zgjat me orë të tëra, kryetari i Komunës ka lyp shumë shkurt disa pyetjeve me iu përgjigj. Drejtorët tjerë, për shkak që u zgjat shumë seanca, kanë kërkuar që t'jua dërgojnë përgjigjet nëpërmes emailit, ose në seancën tjetër. Ju faleminderit shumë, Grupit

Parlamentar të PDK-së që po e bëni këtë punë. E kisha lut kryetarin e Komunës, shumë shkurt, që ta qesim në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, duke marrë parasysh se kjo seancë zgjati shumë, unë pata ndërmend që t'ju përgjigjem shumicës dërmuese të pyetjeve, përveç atyre pyetjeve të cilat kanë qenë të paargumentuara, pyetjeve të cilat kanë nxit urrejtje dhe ndasi nuk kam pas mendje me iu përgjigj. Por megjithatë, pasi delegatët e PDK-së kanë kërkuar që mujm edhe në seancën e ardhshme me iu përgjigj, edhe unë po tërhiqem nga ajo. Po e lëmë që në seancën e ardhshme t'u përgjigjem pyetjeve të cilat kanë pas nevojë për përgjigje. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, e qesim këtë pikë në votim. Kush është pro këtij Raporti të kryetarit dhe ekzekutivit? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë, siç e dini, pika e dhjetë është pika eventuale. Besoj që krejt i kemi krye. Atëherë, të dashur qytetarë të Komunës së Dragashit, të dashur besimtarë myslimanë, nesër po hyjmë në muajin e shenjtë të Ramazanit. Uroj që ky muaj i bekuar t'ju sjellë paqe, shëndet dhe mbarësi në jetën tuaj! Qoftë një muaj i mbushur me reflektimin, lutjet dhe faljet, të mund të përfitojmë nga çdo moment që ofron ky muaj i shenjtë! Allahu ju bekoftë dhe ua pranofte agjërimin dhe lutjet! Atëherë, a do dikush me e marrë fjalën në pikën eventuale?

Shpetim Hajredini: Po ju kërkoj falje, por e kam të patjetërsueshme këto dy problematika të fshatit t'i paraqes para kryetarit, se përndryshe nuk e kisha bo një gjë të tillë, nuk do ju kisha vonuar. E para ka të bëjë, i nderuar kryetar, kjo është vazhdimësi e çdo viti, e kam përjetue edhe unë, po ju pak po e lini ma gjatë, po ju vazhdon shumë keq kjo punë. Kanalizmi është në gjendje të mjerueshme, ka prek një pjesë të madhe të tokave që i përket asaj pjesës nga ana e fshatit Kosavë. Është tmerr, erë, tmerr është aty, nuk e di, aso erë nuk kam përjetue qe një kohë të gjatë. Ju lutem, që sa paku brenda javës, dhjetë ditë, nëse ju nuk e përfundoni, unë e marr personalisht edhe e përfundoj vetë. Atë ju premtoj sot edhe bashkëfshatarëve të mi që unë jau kryj, nëse ju nuk e kryni brenda dhjetë ditëve. Tjetra, vërshimet, u bënë nëntë muaj a dhjetë, çka po di sa janë bo, prej se janë përfundue vërshimet dhe një ankesë më ka ardhë nga një fermer i fshatit Kuk. Është shumë i nderuar, jo nga ana ime, por edhe shumë i respektuar nga komplet fshati, ky fermer më paraqiti para meje fotot, videot, të cilat – unë personalisht kam qenë në fillim dhe kam mendue që është intervenue në atë pjesë dhe është pastru ajo pjesë, po ajo qëndron ashtu, edhe ma zi ish bile tash se që ka qenë. Nuk keni prek fare. Ju kisha lut që të gjeni opsionin e juaj, formën e juaj si të

mundeni, dhe të shkoni t'ia pastroni edhe këtij fermeri atë pjesë, ato mbetje që kanë ardhur nga vërshimet. Nuk po due me e përmend me emër, unë jam i bindur se kryetari i fshatit, por edhe nënkryetari e di për kënd e kam fjalën. Nëse nuk e di, atëherë munden me u paraqit te unë dhe unë ia tregoj me emër e me mbiemër. Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Kemi bërë përpjekje me e hap kanalizimin, me e zhbllokue, por nuk kemi mundur. Kanë me ardhë prapë edhe një herë nesër. Për atë fermerin tjetër nuk po e di, është këtu nënkryetari i Komunës dhe i të njëjtit fshat, besoj qe duhet të merret me këtë punë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Faleminderit media dhe të gjithë ju të pranishëm! Para se me e mbyllë seancën, ju kisha lut mediave dhe ekzekutivit me dalë jashtë, ne asambleistët duhet të qëndrojmë për një punë të Kuvendit. Ju kisha lut mediave dhe ekzekutivit që të na lirojnë sallën!

Atëherë, pasi dolën mediat, në seancën e fundit e kemi bo për vizitën studimore, por atë ditë ka qenë shumë e ngarkuar dhe nuk ka mund me u bo procesverbali. Për arsye ligjore, edhe sot ju kam ftue. Atë ditë është marrë që destinacioni do të jetë në Vjenë. Siç e dini, kanë qenë dy propozime: për në Itali – Sicili, edhe në Vjenë. Kemi vendos bashkë me shefin e Grupit të PDK-së. Ti Driton i përkasish asaj partisë. Sipas shefit të PDK-së, e ka bo një përpjekje që atje të takohemi me një Komunë, për me qenë tamam vizitë studimore. E dyta, shuma e kësaj vizitës ka me qenë 20 – 22 mijë euro. Edhe, prej delegatëve është kërkue që e gjithë Asambleja me shkue, Zyra e Kuvendit, dhe kryetari me dy nënkryetarët, pa zëvendësues. A jeni të pajtimit për këto që i thashë, që t'u hyjmë procedurave? Me aeroplan kemi me shkue. Besojmë që do të jemi 4 netë e 5 ditë. A jeni për, a po doni dikush ndonjë propozim tjetër?

Shpetim Hajredini: Është problematika që tash Grupi im ka ndryshue tash, kanë dhënë një propozim pak më ndryshe. Ne u morëm vesh atë ditë, u kuptuam që në Vjenë me shkue. Edhe unë kam kontaktue, ti e din, edhe me personin në Ambasadë me shkue takim me pas. Ai më ka thënë veç më lajmëroni 5-6 ditë më herët që unë ta caktoj orarin kur. Kjo po hidhet poshtë tash, po e japin si propozim Zvicrën. Edhe tash, nëse janë edhe pjesa tjetër e pozitës për Zvicër, atëherë jemi të gjithë për Zvicër edhe le të vendosim. Përsipër për takim je ti, po më vjen keq, propozimi është qeky. Keni mundësi, ndryshone, bëni çka të doni.

Arijeta Skeraj: Atëherë, propozim tjetër a keni? A po ia bëjmë kështu: të gjithë janë të disponimit për me shkue në Zvicër. Në qoftë se nuk do të kemi kontakt, atëherë e kemi Vjenën. A bën kështu?

Një herë destinacioni është Zvicra, në qoftë se kemi ndonjë numër kontaktues, atëherë e lëmë Zvicrën.

Shpetim Hajredini: Vetëm një minutë, se kam harrue, po e kemi Kujtimin, me Kujtimin mujm me diskutue edhe besoj që e kryen Kujtimi.

Arijeta Skeraj: Atëherë, e qesim në votim. Kush është për në Zvicër? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, vendosim për Zvicrën. Mirë u pafshim në seancat e radhës!